ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 3 KORRIK 2021. NUMËR 137 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

"SHUHET NJË FANAR NDRIÇUES NË EUROPË, NJË TJETËR FANAR NGRIHET NË HESHTJE" – VEPRA E KADARESË E BOTUAR NË KINË

Iljaz Spahiu (Sinolog)



"Të lë një gjurmë të pashlyeshme" – a ka një gjurmë tonën në këtë botë të sotme? Mbi përmbledhjen me tregime të Zija Çelës "Thika pa gjak", botim i Onufrit dhe të esesë së Maruice Blanchot "From Dread to Language".

"THIKAT" E ZIJA ÇELËS NË LOJËN E ARTIT

Nga Ballsor Hoxha (fq.14)

MBI NJË SHEKULL NGA THEMELIMI I STUDIMEVE TË LARTA PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE NË PARIS

Intervistë e gazetares Mimoza Hasani Pllana me shkrimtarin, skenaristin, përkthyesin letrar, publicistin, diplomatin LUAN RAMA (fq. 5)

Këndvështrim përmes mesazheve, personazheve fiction apo real në veprat e Ridvan Dibrës

Nga Valbona Bërdica (fq.12)

Mbi romanin "Mos harro të më kujtosh" të Liridon Mulajt

KUJTESA, MASA E DASHURISË PËR TË AFËRMIN

Nga Oana Glasu (fq.11)

Persiatje mbi romanin "Varret" të shkrimtarit Erjon Muça

MBI "VARRET" DHE RRËNOJAT TONA AUTOKTONE

Nga Pol Milo (fq.9)

Moikom Zeqo - Një jetë e pazakontë e një njeriu të madh

nga Vllasova Musta (fq.10)

Vëllimi "Djalit larg" i Mimoza Pulajt

ÇELESAT E NJË POEZIE

Nga Jolanda Cmeta (fq.13)

REFLEKTIME MBI "SI TË RREGULLOSH NJË BIBLIOTEKË" NGA ROBERTO CALASSO

Nga Damian Alia (fq.23)

ELIF SHAFAK

mbi çfarë do të thotë t'u përkasësh njëkohësisht shumë vendeve (fq. 22)

BIBLIOTEKË

Feride Papleka (fq. 16)
Dy tregime retrospektivë

Afrim Demiri (fq. 17)
Katër poezi

Shqiponja Axhami (fq. 18)
Një natë për burrin

Istref Haxhillari (fq. 19)
Kuajt e natës

Natalia Ginzburg (fq. 20)
Dielli dhe hëna

Roland Gjoza (fq. 21)
Dasma

GJUHA ROMANORE E PETRIT PALUSHIT - DASHURI, TRADHTI, DHEMBJE DHE VETMI

Nga Kosovare Krasniqi (fq. 8)

Studimi "*Proza e Petrit Palushit*", i studiueses Ermelinda, është një e arritur dhe me vlerë studimore, studim për një autor, i cili fuqishëm jep mesazhin e veprave të tij, në të cilat temë mbi temat mbetet liria e individit dhe dashuria e tij ndaj njeriut.

""SHUHET NJË FANAR NDRIÇUES NË EUROPË„ NJË TJETËR FANAR NGRIHET NË HESHTJE" – VEPRA E KADARESË E BOTUAR NË KINË

Iljaz Spahiu (Sinolog)

"Shqipëria, ky vend që sot shumë të rinj as që e kanë dëgjuar, dikur në kohën tonë, ka qenë "Fanar ndriçues në Europë". Një vend i vogël, me popullsi rreth dy milion banorë, por që në sytë dhe zemrat e popullit kinez në atë kohë ishte një hero i fuqishëm, vëllai ynë më i ngushtë ndër gjithë vëllezërit". Kështu e fillon shkrimin e tij "Bota e Trillimit (ose Romanet e Ismail Kadaresë)" Zhang Ning, botuar në një gazetat më mëdha kineze "Nanfang zhoumo-South Weekend". Por, vazhdon shkrimi, në mesin e viteve 70-të, këto ndjenja vëllazërore sikur u zhdukën pa kuptuar, deri sa një ditë dy vendet u prishën me njëri-tjetrin. Por megjithatë, si në atë kohë apo tani, lexuesi kinez shumë pak ishte njohur me letërsinë shqiptare. Deri sa befas "Shqipëria nxori Kadarenë". Lajmi u përhap vrullshëm si flakët e zjarrit e vuri menjëherë në lëvizje botuesit. Fillimisht ishte shtëpia botues Chongqing e cila botoi njërin pas tjetrit tre vepra të tij "Prilli i Thyer", "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur" dhe "Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave". Më pas në vitin 2012, një tjetër shtëpi botuese në Guangzhou botoi "Darka e gabuar", "Kronikë në gur" dhe "Kush e solli Doruntinën".

Nuk ka dyshim se Kadare është shkrimtari më i njohur dhe më i vlerësuar shqiptar në Kinë. Deri tani janë rreth 15 vepra të tij të përkthyera dhe botuara në Kinë, dhe për më tepër botimi i çdo libri shoqërohet me kritika letrare profesionale dhe shkrime reaguese të admiruesve të shumtë të Kadaresë në këtë vend.

Në fakt, siç thuhet edhe në shkrimin e "Nanfang zhoumo", lexuesit kinezë janë takuar me Kadarenë shumë më herët. Në vitin 1963 kur ai botoi romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", në Kinë, atëherë një vend i lidhur me miqësi vëllazërore me Shqipërinë, u fol shumë për Kadarenë, vetëm se "propaganda jonë për të anonte më shumë nga lirikat e tij politike, kështu që kur emri i tij kishte arritur në zenit, nga dy identitetet e tij – atë të romancierit që eksploron historinë kombëtare dhe të poetit – gjuha kineze zgjodhi njërin prej tyre".

Romani i parë i Kadaresë u botua në Kinë në fillim të viteve 90-të, i përkthyer direkt nga gjuha shqipe nga albanologu dhe përkthyesi i njohur Zhen Enbo. Por Kadare fitoi famë sidomos pas vitit 2005 kur ai meritoi Çmimin Ndërkombëtar Man Booker, duke ngjallur interesimin e shtëpive botuese në Kinë, njëra prej të cilave, Shtëpia Botuese Chongqing mori të drejtat e botimit të disa veprave të Kadaresë nga frëngjishtja.



Kritika letrare kineze i vlerëson romanet e Kadaresë si të një lloji tjetër, ku secila prej tyre sjell për lexuesit një botë surreale, të çuditshme. "Është diçka", thuhet në shkrimin e gazetes kineze, "që nuk e gjejmë tek shkrimtarët modern kinezë si Yang Qing, Yang Mo apo Liangbin, por që gjithashtu nuk ka të bëjë as me imagjinatën krijuese të shkrimtarëve të Europës Lindore, me të cilën është mësuar lexuesi kinez".

Autori i shkrimit ndalet tek romani "Kush e solli Doruntinën", duke theksuar se, kjo vepër u botua në vitet '80-të, periudhë kur Shqipëria ishte ndarë tashmë nga Kina dhe kishte zgjedhur të izolohej përfundimisht nga bota. Është ndoshta kjo arsyeja që kritikët perëndimorë nëpërmjet saj lexuan mendimin e Kadaresë për të kundërshtuar gjendjen aktuale të vendit me anë të legjendave të moçme. Ndërsa për lexuesit kinezë me një eksperiencë historike të ngjashme, natyra politike e këtij romani sigurisht që nuk është ballafaqimi politik, nuk është po ashtu konfrontimi politik mes individualizmit dhe kolektivizmit, por është përplasja mes "besëtytnisë" (fantazmës) dhe "arsyes". Sigurisht shkruan autori, Kadare qëndron në anën e "besëtytnisë", që do të thotë në anën e partisë, pasi "arsyeja" përfaqësohet nga Bizanti, nga ai Klan ndërkombëtar që lakmon Shqipërinë.

Kina dhe Shqipëria, shkruan më tej autori, gjatë

Albanologu Zhen Enbo, përkthyesi i "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"



historisë së tyre kanë përqafuar rrugën e vetme të "realizmit socialist" , si e vetmja mënyrë krijuese. Ndërsa në Kinë u arrit që nëpërmjet lëvizjes së "Letërsisë avangardë" të përdorej dhe legalizohej teknika e përshkrimit të tipit "labirint artistik", tek Kadareja kjo teknikë ishte e lindur, madje ishte e tejet e thjeshtë dhe tërheqëse, ndryshe nga shumica e letërsisë avangardë në Kinë e mbushur me gjurmë artificial dhe thirrje hipokrite ankuese. Kjo sigurisht krijoi hapësira të gjëra për Kadarenë për të nxjerrë në pah panoramën historike të Shqipërisë dhe historinë e shpirtit kombëtar.

Ndërsa "Wenxuebao (Gazeta Letrare)", një nga botimet më serioze në fushën letërsisë, me rastin e botimit të "Murit të Madh" të Kadaresë, boton shkrimin me titull "Ai është një nga më të nominuarit për Çmimin Nobel".

Shkrimi evidenton faktin se Kadare është fitues i Çmimit të parë Ndërkombëtar për Letërsinë Booker, në një listë konkurruese me autorë të famshëm botërorë, si Garsia Markez, Gunter Glas, Milan Kundera, Kensaburo Oe, etj., si dhe thekson se Kadare është kandidati më i nominuar për Çmimin Nobel si dhe një nga emrat më të ndritur të Shqipërisë së sotme. Gazeta citon kryetarin e Komisionit të Çmimit Booker, profesorin e Universitetit të Kembrixhit, John Carey, i cili thotë se, Kadare është "Një shkrimtar i rangut botëror, i cili ndjek traditën narrative që mund të gjurmohet që nga Homeri".

Kadare, vazhdon shkrimi "Wenxuebao", është mjeshtër i temave të historisë, veprat e tij mbështeten tek historia antike për të treguar të sotmen. Shkrimi merr si shembull veprat e tij , si "Daullet e shiut", "Ura me tri harqe", "Prilli i Thyer" dhe "Piramida", në të cilët autori gjithmonë rrëfen ngjarje të kaluara duke aluduar për ngjarje aktuale.

"Muri i Madh" që ne po rekomandojmë për lexuesit, thuhet më tej në shkrim, është një volum me tre novela të Kadaresë, "Muri i Madh", "Qorrfermani" dhe "Vajza e Agamemnonit". Novela e parë zhvillohet rreth një nëpunësi të Dinastisë Ming dhe një ushtari mongolez në dy anët e Murit të Madh; sfondi i novelës së dytë zhvendoset tek reformat e Perandorisë Osmane, ndërsa "Vajza e Agamemnonit" përshkruan Shqipërinë reale të viteve 80-të të shekullit 20-të. Fabula e gjithë librit sillet e mbështillet në një labirint fin e unik, dhe ngjan me një përrallë të zezë të mbushur me absurdin dhe metaforën. Gazeta ka zgjedhur edhe një fragment nga ky libër, të cilin e boton në faqet e saj.

Ndërkoh gazeta "Xinjingbao", boton shkrimin "Kamarja e Turpit: Vendosmëria për të rikthyer Shqipërinë e vërtetë", në të cilin vë në dukje se veprat e shkrimtarit shqiptar, të njohura në të gjithë botën, dallohen për ironinë e hollë dhe vështrimin kritik, madje shumë prej tyre për periudha të ndryshme kanë qenë edhe të ndaluara. Më tej, duke u ndaluar tek marrëdhëniet e Kadaresë me vendin e tij, thekson se Kadare në vazhdimësi e ka ngritur zërin dhe ka punuar për një Shqipëri të sigurt e të begatë. Kështu në vitin 1999, gjatë bombardimeve në Kosovë, u angazhua personalisht duke marrë një tur vizitash, duke i shkruar letra presidentit amerikan, duke bërë thirrje për të shpëtuar kombin shqiptar. Por edhe ai nuk i ka shpëtuar lidhjes me politikën, që shpesh e ka detyruar atë të përballojë një peshë të madhe dhe lexuesit të lexojnë mes rreshtave. Kjo sigurisht që bie ndesh me pritjet e një shkrimtari të mirë për veprat e tij, por shton artikulli, nuk çudi që Kadare ashtu si Kundera e urrente politikën – A mund të flisni për anën artistike të veprave të mia!

Ndërsa Faqja zyrtare e shkrimtarëve kinezë boton një shkrim të Shi Xuebao me titull "Ura me tri harqe e Kadaresë: Ndryshimet në botë paralajmërohen nga kjo urë".

Nëse kjo urë prej guri në këtë roman është e vërtetë, shkruan artikulli, atëherë çfarë përfaqëson ajo? Çfarë ka dashur të shpreh ky roman? Përgjigjen për këtë pyetje të hapur, autori e jep nëpërmjet gojës së personazhit kryesor fratit Gjon: "Gjithçka e bëj nga dashuria për këtë tokë". Me shumë gjasa kjo urë i referohet Shqipërisë, këtij vendi mes Lindjes e Perëndimit që po përjeton ndryshime historike. Ashtu si ura, edhe Shqipëria ka nevojë për një flijim,

Li Yumin përktheu librin "Kronikë në gur"

Kadare në Murin e Madh Kinez, 1968



në mënyrë që historia të mos fshihet dhe e vërteta të mos shtrembërohet. Kadare me shumë mund e dhimbje rimbjell në truallin modern legjendat e lashta, dhe qëllimi i tij ndoshta është të përshkruajë një Shqipëri të vërtetë, të zhveshë popullin dhe historinë e tij nga vello e miteve dhe t'u kthejë fytyrën origjinale. Koha rrjedh, bota ndryshon, por është kjo urë që i paralajmëron ato. Kadare me penën e tij ndërton këtë urë dhe regjistron historinë e Shqipërisë, thuhet në shkrimin e botuar në Faqen zyrtare të shkrimtarëve kinezë.

Faqja e Shanghai Mediao Group i kushton një album me fotografi 80 vjetorit të lindjes së Ismail Kadaresë. Një përshkrim mjaft interesant i kushton ajo stilit artistik të shkrimtarit. Kur Kadare rrëmben penën, shkruan artikulli i saj, duket sikur ndjen erën e ftohtë të veriut. Ai shquhet sidomos për përshkrimin e atmosferës vdekatare. Në ato kohë të lashta dhe jo shumë të lashta, kur vetëdija ende nuk kishte lëshuar embrion tek njerëzit dhe sa here që ngrinin kokën shikonin perënditë që endeshin në qiell. Kur lexon romanet e Kadaresë nganjëherë të duket sikur po lexon Dhjatën e Vjetër, dhe ke parandjenjë se diçka e keqe do të ndodhë. Përshkrime e tij janë si pikturat e impresionistëve, produkte të ndjenjave personale, shpesh shtypëse. Në romanin "Kronik në gur", Kadare flet për Gjirokastrën, këtë qytet me shtëpi të vjetra prej guri, ku rrugët, shatërvanët e deri çatitë e shtëpive janë të veshura me pllaka guri ngjyrë gri, si luspa gjigande. "Vështirë të imagjinohet se poshtë këtyre pllakave të rënda ekziston jeta e brishtë dhe rriten brezat e ardhshëm".

Përkthimi dhe botimi i veprave të Kadaresë në Kinë vazhdon të ngjallë interes gjithnjë e në rritje tek lexuesit e këtij vendi të madh. Për fat keq për shkak të të drejtave të autorit, shumica e romaneve të tij janë përkthyer nga frëngjishtja apo anglishtja dhe vetëm dy vepra janë përkthyer nga origjinali, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", nga albanologu Zhen Enbo dhe "Aksidenti" nga Chen Fenghua, shefe e Katedrës së Gjuhës Shqipe në Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit. Sidoqoftë shkrimtari i madh shqiptar Ismail Kadare ka zënë tashmë vendin e merituar në bibliotekat e lexuesve kinezë, krahas shkrimtarëve më të mëdhenj botërorë.

Yu Zhongxian përktheu librin "Darka e gabuar"

MBI NJË SHEKULL NGA THEMELIMI I STUDIMEVE TË LARTA PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE NË PARIS

Intervistë e gazetares Mimoza Hasani Pllana me shkrimtarin, skenaristin, përkthyesin letrar, publicistin, diplomatin Luan Rama.



Mimoza Hasani Pllana: I nderuar profesor Luan Rama, arsimin e lartë e keni mbaruar në Tiranë dhe në Paris, në fushat që lidhen për komunikimin me publikun. Studiuat për gazetari, në kuadër të Shkencave Politike në Universitetin e Tiranës, pastaj, studimet Audiovizuale për Komunikim dhe Kinematografi i mbaruat në Universitetin Parisi VII, "Denis Diderot" në Paris. Në secilën fushën keni dhënë kontribut të çmuar. Si është e mundur të punoni në studime shumëdimensionale edhe pse në kohë të ndryshme?

Luan Rama: Ishte dëshira për të njohur botën, atë që s'mund ta shikonim gjatë shumë dekadave në një Shqipëri të mbyllur nga bota përreth. Ishte një etje e vazhdueshme për kulturën, historinë, botën në tërësi dhe kjo gjë vazhdon. Në fëmijëri kam qenë filatelist dhe dashuria për pullat, koleksionet e ndryshme, pjesëmarrja në klube të ndryshme filatelistësh, më ka çuar në botë të tjera duke më ngacmuar imagjinatën për kulturën, gjeografinë dhe historinë e popujve, për vendet që dikur kishin qenë koloni, për vendet e mëdha dhe të vogla, për Evropën e botën mbarë. Në fillim, në rininë time ishte poezia ajo çka më tërhiqte pa masë: Lorka, Ricos, Neruda, Whitman, duke përfshirë këtu poetët francezë që më pëlqenin shumë si Paul Eluard, Jacques Prevert, Louis Aragon. Ishte dashuria për poezinë që më shtyu të mësoja frëngjishten. Më kujtohet si tani kur në Bibliotekën Kombëtare më ra në dorë një libër i rezervuar (d.m.th. që nuk ishte për publikun e gjerë, por që unë e gjeta përmes miqve të mi) një libër i botimeve Gallimard mbi poezinë e plotë të Eluard, ku një nga përmbledhjet poetike në të ishte ilustruar nga fotografi dhe piktori amerikan Man Ray, i cili jetonte në Paris. Ishte diçka moderne, ku ishte përfshirë dhe epoka surealiste e këtij poeti revolucionar gjatë viteve '30-'40. Pikërisht atëherë i thashë vetes se duhej ta mësoja frëngjishten që ta kuptoja më gjerësisht dhe në origjinal këtë poet të madh. Dhe ashtu bëra: fillova ta mësoj si audidakt gjuhën frënge. Studimet universitare në gazetari nuk më dhanë ndonjë bagazh në kuadrin e kulturës, meqë atëherë mbizotëronin lëndët ideologjike. Pra kulturën duhej ta përftoja vetë përmes leximeve. Ajo që më ndihmoi ishte kinematografia. Pas mbarimit të universitetit unë kërkova të punoja në studiot kinematografike «Kinostudio e Re», ku pata fatin të njoh shumë kineastë të shquar, pionierët e kinematografisë shqiptare e njëkohësisht fondin e pasur kinemtografik që ekzistonte në arkivat e Kinostudios që me filmat e viteve '20-'30 (të sallave të dikurshme private) me filmat e autorëve të mëdhenj si Ernst Lubitch, George Pabst, David Grifith, Jean Renoir, René Claire, De Sica, De Santis, etj., pra me rrymat dhe shkollat e mëdha kinematografike botërore si «ekspresionizmi gjerman», «neorealizmi italian», «romantizmi poetik francez» apo «Vala e Re» («La Nouvelle Vague») e viteve '60-'70 të shekullit XX në Francë. Në fillim u angazhova si redaktor, pastaj skenarist i filmave dokumentarë, vizatimorë, e më vonë i filmave artistikë. Nga filmat artistikë kam realizuar skenarët e filmave «Vajzat me kordele të kuqe» të regjisorit Gëzim Erebara, «Dëshmorët e monumenteve» të Fehmi Hoshafi, «Pranverë e hidhur» e Muharrem Fejzos apo «Një jetë më shumë» e Gëzim Erebarës dhe Gavrosh Haxhihyseni. Ishte një eksperiencë e bukur, pasionante çka do më ndihmonte më vonë kur do të merresha gjerësisht me letërsinë, tregimin apo romanin, por dhe poezinë. Po kështu, në filmat vizatimorë, në rreth 15 prej tyre kam trajtuar përrallat e legjendat shqiptare, apo temat shkencore. Ishte koha kur kisha fëmijët e vegjël dhe bota e tyre më shtynte drejt këtyre lloj filmave. Dua të shtoj këtu se një periudhë ishim të detyruar të lexonim letërsinë e ndaluar fshehurazi, duke kaluar tek njëri-tjetri, midis miqsh, librat e Orwell, Kafka, Ionesco, Duras. Megjithatë, nga fundi i viteve '80, patëm mundësinë që të porosisnim botime të huaja kinematografike në Kinostudio si «Cahiers du cinema», «Sight and Sound», «Bianco e Nero», etj, apo të përkthenim dhe shpërndanim ndër kineastët e rinj libra të studiuesve të huaj rreth kinemasë për gjuhën e filmit, lojën e aktorëve, historinë e kinemasë, siç ishin André Bazin, Stanislavski, Georges Sadoul, etj. Pikërisht në këtë kohë përktheva dhe një tekst të filmit «Hiroshima mon amour» («Hiroshima, dashuria ime») të Marguerite Duras, film ky i regjisorit Anain Resnais, i cili nuk mund të shfaqej atë kohë në Shqipëri meqë trajtonte temën e dashurisë mes një francezeje dhe një ushtari gjerman në fundin e luftës, pra një film humanist dhe një akuzë kundër luftës.

M.: Në fund të viteve `90, të shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI, keni qenë pjesë e përfaqësimit diplomatik të Shqipërisë në disa qendra të njohura kulturore të Evropës. Funksioni i ambasadorit të shtetit sigurisht është nder, por edhe përgjegjësi. A ju kujtohen ngjarjet 191 kulturore dhe letrare përmes të cilave keni sjellë pjesë të Shqipërisë në Francë, Monako dhe Portugali, vende në të cilat keni përfaqësuar Shqipërinë gjatë asaj kohe?

L.R.: Vitet '90 me ndryshimet politike në Shqipëri ishin sa entusiazte e shpresëdhënëse aq dhe kaotike si shkak i mungesës së një kulture politike por dhe i kulturës në përgjithësi si dhe i trashëgimisë që la epoka totalitare, ku një pjesë e popullsisë provoi burgjet dhe kampet e internimit si në gjithë Evropën Lindore me gulagët e tmerrshëm, të ngjashëm me ata të Siberisë ruse. Pra për herë të parë duhej të bënim tonën konceptet e lirisë, të shtetit të së drejtës, pluralizmit politik dhe të sistemit demokratik në përgjithësi, pra të një shoqërie të lirë, të hapur, humaniste, progresiste dhe të shoqërisë civile. Unë erdha në Paris në mars të vitit 1991, pas shembjes së statujës së Enver hoxhës që e përjetova nga afër në Tiranë. Erdha si diplomat në fushën e kulturës në një ambasadë ku nuk kishte ambasador dhe shpejt u emërova i ngarkuar me punë a.i. pra të përfaqësoja Shqipërinë në Francë e më pas në Portugali dhe në Monako. Por, në fillimet e mia si diplomat duhej të isha dhe një interlokutor i ri në marrëdhëniet e Shqipërisë me Këshillin e Evropës në Strasburg si dhe me Bashkimin Evropian në Bruksel. Duke shtuar këtu dhe detyrën e përfaqësuesit të Shqipërisë pranë Unesco-s, kjo padyshim ishte një ngarkesë e jashtëzakonshme për një diplomat të ri që i mungonte eksperienca dhe përvoja diplomatike për të përballuar një mision tepër të rëndësishëm në metropolet e Evropës si në Paris, Bruksel dhe Strasburg. Isha si ai fëmija që e hedhin në liqen ku duhet të mësojë notin. P.sh. në Strasburg duhej të shkoja vazhdimisht për formacionet e reja të ekipeve shqiptare lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut, lirisë së shtypit, gruas, sistemeve zgjedhore, çështjeve konstitucionale, reformimit të drejtësisë, shoqërisë civile, etj., platforma të reja këto perëndimore për një vend që sapo kishte dalë nga totalitarizmi. Pas kësaj etape të parë diplomatike, gjatë dy viteve u angazhova me revistën prestigjioze «Le Courrier International» duke ndjekur ngjarjet tronditëse të Shqipërisë dhe Ballkanit siç ishte ajo e viteve të "piramidave financiare" të mbrojtur dëshpërimisht nga ish presidenti Berisha apo grushti i shtetit më 1998 i stopuar nga Evropa, kohë kur nga Berisha në krye të Partisë Demokratike, pushtohej me antitanke kryeministria dhe televizioni. Kjo periudhë tregoi se Shqipëria ishte shndërruar në një demokraturë, një përzierje e demokracisë me diktaturën e "njëshit". Por me rotacionin politik në Shqipëri në vitin 1997 më caktuan ambasador në Francë, duke mbuluar dhe marrëdhëniet diplomatike me Portugalinë dhe Monakon. Një ngjarje e veçantë me Portugalinë ishte vizita e parë e një kryeministri shqiptar dhe pjesëmarrja e Shqipërisë në "Ekspozitën Universale të Lisbonës" organizuar në vitin 1998. Padyshim, veprimtaritë kanë qenë të shumta: i bindur se s'do të bënim "politikën e madhe", përmes veprimtarive të shumta kam punuar shumë në drejtim të sjelljes së vlerave kulturore, historike, kontributeve shqiptare në hapësirën evropiane, paraqitjen e trashëgimisë së kulturës së vjetër, etj., duke ftuar në Paris dhe qytete të tjera të Francës piktorë, artiste, etj. Vazhdimisht kam organizuar ekspozita pikturash, të fotografisë, dhe arteve të ndryshme, takime letrare e artistike, koncerte, takime në kuadrin ballkanik etj., për të treguar gjithnjë përkatësinë evropiane të një vendi të lashtë si ai i shqiptarëve. Të jesh diplomat në një vend, kudo qoftë, duhet ta çmosh atë vend, ta duash, të njohësh historinë, 193 kulturën, personalitetet e tij historike, politike, kulturore. Kjo dije enciklopedike të afron me interlokutorët jo vetëm kulturorë por dhe ata politikë e diplomatikë të cilët atëherë të shohin me simpati, si një dashamirës të vendit të tyre si një njeri që kërkon të punosh në drejtim të frymës së miqësisë dhe bashkëpunimit mes dy popujve. Kjo gjë e ndihmon diplomatin dhe në zgjidhjen e problemeve të vështira diplomatike që mund të lindin. Ishte një fat që isha caktuar në Francë, një vend i cili, me revolucionin e tij më 1789 kishte qenë një frymëzim i gjallë për Rilindjen shqiptare aq sa në atë kohë të zgjimit për pavarësi ekzistonte dhe ai himn që nga shqiptarët quhej "Marsejeza shqiptare". Dua të shtoj se diplomati duhet të jetë dhe një lloj mesazheri midis dy vendeve, aq më tepër

kur ai është njeri i kulturës. Pjesa më e madhe e veprimtarisë time krijuese përfshin pikëtakimet franko-shqiptare, historia e përbashkët është mishëruar në vepra letrare.

M.: Ju keni ligjëruar për Gjeopolitikën, Historinë e Shqipërisë dhe Mbi traditën dhe modernitetin, në Institutin e Gjuhëve dhe të Qytetërimeve Orientale në Paris (INALCO). Si pranohet dhe sa është e njohur gjuha, kultura dhe historia shqiptare nga studentët e huaj dhe si janë vendosur studimet shqiptare në Institutin e Gjuhëve dhe Qytetërimeve Orientale kur dihet se gjuha dhe kultura jonë nuk i përket Orientit?

L.R.: Është e vërtetë që më pëlqen shumë historia dhe qytetërimet e vjetra. Madje sapo kam përfunduar një libër mbi ngjarje dhe histori të para dhe pas erës sonë, ku shumë ngjarje prekin historinë shqiptare dhe Ilirinë, pra bëhet fjalë për figura e ngjarje deri në vitet 1200 me vendosjen e anzhuinëve në trojet shqiptare kur princat shqiptarë nën kërcënimet bizantine u bashkuan me Charles I d'Anjou, i cili u shpall "Mbret i Napolit dhe i regnum Albaniae". Historia e gjeolopolitika janë padyshim fusha që lidhen ngushtë me njëra tjetrën, pa përjashtuar gjeografinë apo demografinë, veçanërisht me zhvendosjet e popullsive gjatë shekullit XX e deri sot. Unë kam dhënë lëndën e historisë shqiptare dhe të gjeopolitikës, në kuadrin e fuqive ballkanike dhe evropiane gjatë gjithë kohëve apo një lëndë tjetër interesante si «Midis traditës e modernitetit», ku më shumë është një lloj sociologjie e lidhur me politikën ku flitet për evolucionin shoqëror nga kohët e hershme mesjetare deri në ditët tona. Një fushë mjaft interesante kur duhet të flasësh nga kuadri e jetës klanore, Kanunit, etj., e tek moderniteti i njeriut të sotëm, i femrës në veçanti, i riteve zakonore, ideologjike, politike, i raporteve të medias me politikën, i lirisë dhe i të drejtave të njeriut, censurës, kompromisit të artistit me pushtetin, sistemet politike dhe rolit të letërsisë e artit etj.

Inalco është një nga shkollat më të vjetra të specializuara të Francës, një shkollë e krijuar afro 270 vjet më përpara, e cila nxori shumë diplomatë që i shërbyen politikës së Francës në kohën e perandorisë në të gjithë botën. Pikërisht në këtë shkollë studioi dhe poeti i madh Baudelaire. Historia e gjuhës shqiptare që nisi të mësohet këtu që në vitin 1905 lidhet veçanërisht me shekullin e XX, pra në vitet '20-'30 kur Mario Roques por edhe studiues shqiptarë që mbaruan studimet në universitet franceze, u angazhuan si lektorë të gjuhës shqipe. Mario Roques analizoi dhe bëri jehonë veprës së Frang Bardhit në librin e tij " Le dictionnaire albanais de 1635", apo siç titullohet ne origjinalin e Bardhit, "Dictionarum Latino - Epiroticum par R.D. Franciscum Blanchum". Që nga ajo kohë, kur dhe qeveria shqiptare u interesua për përhapjen e kulturës shqiptare në Evropë kanë rrjedhur shumë ngjarje, duke vazhduar pas luftës së Dytë Botërore me personalitete të ndryshme shqiptare, duke ardhur në vitet 60-70 me profesor Henri Boissin e më pas kur Christian Gut një nga dashamirësit e mëdhenj të gjuhës dhe historisë shqiptare, përkthyes në frëngjisht i Kanunit dhe i veprave letrare shqiptare ("Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo" të D. Agollit), krijoi katedrën e gjuhës shqipe, katedër që vazhdon edhe sot, ku mësohet gjuha shqipe, qytetërimi i vjetër shqiptar, kultura, zhvillimet politike, etj. Shumë lektorë shqiptarë të ardhur nga Shqipëria nëpër vite dhanë një kontribut të shquar në këtë drejtim duke filluar me Sotir Pepo, Nuçi Naçi, Robert d'Angely, etj.

Lidhur me përcaktimin e këtij instituti si i gjuhëve dhe qytetërimeve orientale, kjo s'ka të bëjë thjesht me Orientin siç kuptohet sot, por më shumë me Orientin gjeografik, pasi në këtë institut studiohen gjuhët dhe qytetërimet e Japonisë, Kinës, Rusisë, Koresë, Vietnamit, Indonezisë, vendeve baltike, atyre ballkanike, Turqisë, Kroacisë, Sllovenisë, Greqisë e padyshim atyre arabe, të Irakut, Afganistanit, Sirisë, etj., si dhe Izraelit. Pra është një fushë mjaft e gjerë. Një nga botimet më pasionante për mua ka qenë shkrimi dhe botimi i librit «Bujtës të largët» prej 700 faqesh dhe me referenca të rëndësishme mbi udhëtimet e udhëtarëve francezë nëpër Shqipëri gjatë shekullit XIX, duke bërë një hyrje të këtyre udhëtarëve që në shekujt XIII - XIV dhe në kohën e kryqëzatave drejt Jerusalemit duke përshkruar trojet shqiptare. Aty janë portrete të historianëve, gjeografëve, arkeologëve, gjeologëve, etnografëve e konsujve francezë të cilët lanë mjaft dorëshkrime e libra të botuara me përshtypjet e tyre për Shqipërinë; janë studiues të njohur evropianë si Ami Bue, konsulli Hecquard në Shkodër, arkeologu Leon Heuzey, Guillaume Lejean, François Pouqueville, i dërguari i Napoleonit në oborrin e Ali Pashës, e deri tek konsulli i fundit francez në shekullin XIX Auguste Dozon, i cili bëri dhe zbulimet e para rreth kulturës shqiptare të Komanit, duke përshkruar edhe vizitën e tij në veriun shqiptar.

Në bibliotekën e pasur të Inalco-s kam gjetur botimin e hershëm të piktorit Louis Dupré "Udhëtim në Athinë dhe Kostandinopojë në vitin 1819", ku ai përshkruante takimet me Ali Pashën dhe arvanitët që pikëtakoi në Athinë e gjetkë, libër që e përktheva dhe e botova në gjuhët shqip-frëngjisht i shoqëruar me ilustrime të mrekullueshme të suljotëve dhe arvanitasve. Një ngasje tjetër ka qenë puna që bëra për shkrimin dhe botimin e librit «Konsujt francezë në Shqipëri gjatë shekujve XVI-XIX», duke i sjellë lexuesit shqiptar personazhe mjaft interesante dhe lidhjet shqiptaro-franceze të Shqipërisë së asaj kohe në dy pashallëqet e mëdha, atë të Janinës dhe Shkodrës. Në libër përshkruhet jeta e zakonshme e këtyre konsujve në Shqipëri dhe marrëdhëniet e tyre me banorët, duke shfrytëzuar shkrimet, raportet e tyre si dhe librat që ata botuan më pas mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, duke shfrytëzuar arkivat e Quai d'Orsay. Auguste Dozon ishte një personazh mjaft interesant të cilit i kushtova një studim të posaçëm. Ai ishte konsull në Janinë në vitet 1869-1874. Gjatë punës si konsull, ai studioi thellësisht gjuhën dhe kulturën shqiptare, duke botuar një fjalor të gjuhës shqipe si dhe librin "Përralla shqiptare" të botuar në frëngjisht dhe në shqipen e vjetër, për çka dhe mori çmimin "Volney" nga Akademia Franceze. Konsulli francez në Shkodër në mesin e shekullit 197 XIX, Hecquard, me veprën e tij "Përshkrim i Shqipërisë së veriut", na la dëshmi të rralla të jetës, historisë, kulturës, zakoneve e traditave popullore. Duke punuar në arkivat e ministrisë së Jashtme franceze, arrita të jap një pasqyrë të qëndrimit të tij në Shqipërinë e atëhershme, kufijtë e së cilës shkonin gjer në Arta e Preveza. Pas botimit në shqip, unë e botova librin dhe në gjuhën frënge "Dozon, le consul qui aimait les contes" për ta njohur kontributin e tij shqiptar dhe në botën frankofone.

Nga ana tjetër, qenia në gjirin e Inalco-s më ka dhënë mundësinë të thellohem në historinë shqiptare dhe pikëtakimet franko-shqiptare. Nëse kam shkruar dhe botuar libra si Shqipëria gjatë luftërave normando-bizantine në vitet 1090-1105, kjo është në sajë të kësaj pune studimore. Po kështu dhe libri «Kalorësit e stuhisë», mbi marrëdhëniet historike franko-shqiptare nga normandët e anzhuinët e deri tek Skënderbeu dhe kontributi i tij evropian dhe lëvizjet shqiptaro-ballkanike të shekullit XVII.

M.: Në syllabuset e lëndëve që ligjëroni, a janë të përfshirë autorët shqiptarë?

L.R.: Padyshim që janë përfshirë, si në fushën e gjeopolitikës ashtu dhe të historisë. Botimet e Eqrem Çabejit, Kristo Frashërit, Shaban Demiraj, Frano Prendit, Pëllumb Xhufit, letërsia historike rreth Skënderbeut me Barletin, Beçikemin, "Kujtimet" e Gjon Muzakës, etj. Në fakt çdo lëndë, çdo epokë historike ka referencat e autorëve shqiptarë dhe të huaj. E rëndësishme për historinë p.sh. është botimi universitar i "Historisë së Shqipërisë" në pesë vëllime apo botimet e tjera akademike, libra të gjeopolitikës apo historisë si dhe librat e Arben Putos, Paskal Milos, Aurel Plasarit e shumë të tjerë.

M.: Jeni autor i mbi 50 librave të letërsisë fiksionale dhe studimeve letrare. Po ashtu keni shkruar një numër të konsiderueshëm skenarësh të filmave të metrazhit të gjatë dhe filmave vizatimor? Si arrini të ruani dëshirën dhe vullnetin për krijimtarinë letrare dhe artistike për një kohë kaq të gjatë?

L.R.: Kur nis një rrugë krijuese është e vështirë të ndalesh pasi sapo botohet një libër rifillon një tjetër. Më kujtohet se kur shkruaja librin "Pikëtakim me Jean Cocteau", kur shkoja në shtëpinë e një mikeje dhe i bija interfonit, nga apartamenti, zëri i saj pyeste: Kush është? - Jean Cocteau! - i përgjigjesha në frëngjisht. Ajo e dinte që unë po shkruaja këtë libër shumëdimensonal për këtë "princ të poezisë" franceze, por dhe dramaturg, regjisor filmash, piktor, aktor etj. Muaj më vonë unë shkova sërish dhe përsëri po ajo pyetje nga interfoni: - Kush është? Dhe unë iu përgjigja: - Jean Moreas!... Ajo e kuptoi menjëherë se kisha filluar një libër të ri. Ishte në fakt libri për poetin franko-arvanitas i ardhur nga Hidra e Greqisë në Francë ku para poetëve francezë ai u prezantua si Jean Moreas, apo Jani nga Morea. Ishte nga Hidra dhe pinjoll i një familjeje të madhe, i dy admiralëve arvanitas Tombazi dhe Papadiamanti, të cilët kishin dhënë një kontribut të madh me anijet e tyre në luftën kundër ushtrisë osmane gjatë revolucionit grek të vitit 1823 për pavarësi. Në Paris, shumë shpejt ky poet i ri, mik i poetit Verlaine dhe Oscar Wild, u bë i njohur dhe themeloi "shkollën e simbolizmit francez" e më pas "shkollën romane" të letërsisë. Në fondin e librave të mia janë mbi 50 libra të gjinive të ndryshme si vëllime poetike, romane, tregime, ese, libra historikë si dhe për fëmijë. Nga librat poetikë mund të përmend ato të botuara në Francë dhe në Shqipëri si "Mbulomëni me një copëz qiell" (frëngjisht dhe shqip), "Territoret e shpirtit" (frëngjisht dhe shqip), "Porto Palermo-vargjet e gurit", apo "Poezi dashurie në kohë të vonë". Nga librat historikë mund të përmend dhe dy biografitë: "Fransua Miteran - dhe Zotërit vdesin gjithashtu" dhe "Gjenerali De Gol-një legjendë e gjallë". Dy biografi-ese në vështrimin e pikëtakimeve franko-shqiptare. Po kështu librat për pikturën dhe piktorët si "Dino-shtegtari i Portës sublime", për piktorin me origjinë shqiptare Abedin Dino; "Omer - Shtegtimi i shtërgut" për piktorin Omer Kaleshi, "Valdet" për piktorin Valdet Hamidi botuar në Francë apo "Përpara tablosë", me shkrime mbi piktorë të huaj dhe shqiptarë. Në këtë kuadër mund të përmend disa ese si "Dorëshkrimet e Purpurta" mbi kodikët e Beratit dhe kodikët më të vjetër të botës (një kapitull mê vete është mbi zbuluesin e "Kodikëve tê Beratit, "Beratinus 1" dhe "Kodikut të Anthimit", pra "Beratinus 2" nga studjuesi francez Pierre Batiffol) apo librin me katër vëllime me shkrime publicistike "Në udhëkryqet e kohës", ku janë shkrime të botuara në revista, gazeta, antologji, parathënie librash etj., botuar gjatë këtyre viteve. Një nga librat e fundit është dhe "Epistolari i Zaratës", i botuar fillimisht në shqip e më pas në frëngjisht, L'épistolaire de Zarata", në anglisht "Zaratha's Epistolary (Melbourn) dhe në italisht, "Epistolario di Zarata", të cilin e prezantova në Firenze dhjetorin e kaluar, botuar nga shtëpia botuese "Scribo". Ishte një ngasje e thjeshtë dhe mjaft domethënëse që e lexova në disa rreshta në një gazetë ku shkruhej për një shqiptar latinist dhe i pasionuar pas letërsisë italiane që pas çlirimit, ishte arrestuar si një pro-perëndimor dhe ishte dënuar në një kamp të burgosurish politikë, në ishullin e Zvërnecit. Pikërisht atje ai përjeton ferrin dhe njëkohësisht nis të përkthejë "Ferrin" e Dantes nga "Komedia Hyjnore". Ky fakt më ngacmoi ta shikoja këtë roman në formë epistolari rreth dhunës dhe etjes së lirisë, ku përkthyesi i referohet vazhdimisht jetës dhe veprës së Dantes dhe të dashurës së tij, Beatriçes. Libri është përkthyer dhe në greqisht dhe besoj që do të botohet dhe në gjuhën holandeze. Krahas poezive kam shkruar romanet "Santa Quaranta" mbi historinë shqiptare të balerinës franko-amerikane Isadora Duncan; "Camera obscura-Origjina e botës" apo së fundi "Një kohë pa kohë". Nga esetë, mund të përmend botimin në frëngjisht të librit "Le long chemin sous le tunnel de Platon" ("Udha e gjatë në tunelin e Platonit") mbi artistin dhe raportet me pushtetin gjatë epokës totalitare, ku pasqyrohet letërsia e burgut, censura, kulti i individit dhe i liderit politik, disidenca shqiptare, sistemi i dënimeve të intelektualëve, etj., ngjarje këto që trajtohen deri në fillim të viteve '90 me fillimin e ndryshimeve politike në Shqipëri, pra pas rënies së murit të Berlinit..

M.: Jeni nga autorët e rrallë që përdorni dygjuhësinë, gjë që u mundëson të jeni i pranishëm në letërsinë shqipe dhe franceze? Nga kjo përvojë, a mund të krahasoni kulturën e leximit ndër shqiptarë dhe francezë?

L.R.: Aventura e përkthimit dhe e bilinguizmit apo e dy-gjuhësisë filloi fillimisht me një bashkëpunim me miken time të vjetër Solange d'Angély në Paris për librin poetik «Mbulomëni me një copëz qiell», i

cili u botua në dy gjuhë, frëngjisht dhe në shqip nga shtëpia botuese «Le Petit Vehicule». Kjo aventurë pastaj vazhdoi me disa libra të tjerë si librin «Krushq të largët» të botuar në shqip e të përkthyer pastaj në frëngjisht «Pont entre deux Rives» («Ura mes dy brigjeve») rreth pikëtakimeve franko-shqiptare gjatë historisë, botuar nga «Société des Ecrivains Français». Më pas nisa të përkthej libra nga frëngjishtja në shqip çka për mua ishte më e lehtë siç ishte një biografi e gjerë historike për dinastinë e Mehmet Ali Pashës, themeluesit të Egjiptit modern, shkruar nga franko-hebreu Gilbert Sinué, shumë i njohur në fushën e romanit historik si dhe romanin historik të historianit dhe shkrimtarit francez Michel de Grèce, «Bubulina», për figurën e Laskarina Bubulinës, një nga kapedanet arvanite që aq shumë i dha revolucionit grek. Ndër të tjera ai shkruante me argumente historike se ishujt Hidra dhe Specaj të Peloponezit ishin ishuj të banuar nga shqiptarët të cilët flisnin gjuhën shqipe ashtu si dhe Bubulina. Që nga ajo kohë pata një ngasje të veçantë për temën arvanite. Kështu, duke udhëtuar shpesh nëpër Greqi dhe në fshatrat arvanitase, në Peloponez apo rreth Athinës, në Tebë, ishullin Eubea, Menidhi, Mandra etj., unë shkrova librin «Në Greqi mes arvanitasve», libër të cilin e përktheva në frëngjisht «En Grèce avec les Arvanites». Kam përkthyer, gjithashtu libra të tjerë historikë siç ishte libri që shkrova për kohën e Luftës së Parë Botërore dhe shqiptarët që luftuan krahas ushtrisë franceze të «Frontit të Lindjes», nën titullin «Bonjour d'Albanie», libër që e përktheva në frëngjisht dhe e botova me titullin «En Albanie, sous l'ombre des bombes». Sigurisht puna me gjuhën, kalimi nga një gjuhë në tjetrën është sa pasionante aq dhe e vështirë, por që të jesh një përkthyes i mirë së pari duhet të jesh një njohës shumë i mirë i gjuhës amtare, të kesh një leksik të pasur për të arritur një përkthim të saktë dhe interesant. Para dy muajsh isha i ftuar në një konferencë internacionale në kuadrin e frankofonisë mes shkrimtarëve të gjuhës franceze nga vende të ndryshme frankofone si Kanadaja, Vietnami, Bullgaria, Hungaria, Rumania, madje dhe nga Algjeria e Kosova, etj., ku secili solli eksperiencën e tij personale në përjetimin e letërsisë përmes dy gjuhëve. Përsa i përket kulturës së leximit, secili vend ka karakteristikat e veta. Në një vend si Franca, kultura e leximit ka qenë gjithnjë e madhe, pasi letrarët kanë qenë të shumtë dhe prurja artistike tepër e madhe në të gjitha kohët, që nga letërsia e hershme kalorsiake e kohës epike me "Këngët e



Rolandit". Kur erdha në Francë, më habiti fakti që ngado që shkoja, në autobusë, tramvaje, trena, shikoje njerëzit që lexonin libra. Ishte një kulturë e ngulitur gjeneratë pas gjenerate, një traditë që edhe pse me zhvillimin e madh të kinematografisë, televizionit dhe mjeteve të reja të komunikimit masiv përmes internetit, dashuria për librin qëndronte konstante. Edhe në kohën e librit elektronik, francezët përsëri duan më shumë librin e shtypur. Ndërsa në Shqipëri edhe në kohën totalitare, njerëzit ishin të etur për të lexuar edhe pse një letërsi e zgjedhur dhe e censuruar përsa i përket letërsisë së huaj, përgjithësisht klasike. Leximi ishte një dritare e hapur drejt botës, dijes, njohjes së kulturave të tjera dhe historive të popujve. Kjo traditë, me ndryshimet politike në Shqipëri pas viteve '90 vazhdoi fuqishëm me rritjen e botimeve më së tepërmi të letërsisë së huaj me autorë që më parë ishin të censuruar apo me autorët më të rinj të botës moderne dhe të letrarëve nga e gjithë bota.

M.: Pra, në Francë, letërsia shqipe është e njohur përmes dygjuhësisë dhe përkthimeve. Përveç Kadaresë, që tashmë botërisht është i njohur për arritjet letrare në shtetin francez, si mendoni, cilët janë autorët shqiptarë më të njohur dhe të pranueshëm për lexuesin dhe kritikën franceze?

L.R.: Letërsia e Kadaresë është letërsia shqiptare më e njohur në Francë, si dhe në gjithë botën. Madje shumë romane në gjuhë të tjera të huaja, vite më parë janë bazuar në versionin frëngjisht të përkthyesit të madh Jusuf Vrioni. Ky shkrimtar i madh ka arritur të japë me një art spikatës dramën dhe shpirtin shqiptar, historinë e tij dhe ngjarjet më tronditëse, nga kohët e vjetra gjer në ditët tona, veçanërisht të kohës totalitare, dhënë me një modernitet të skajshëm. Kur erdha në Francë, më kujtohet se kur binte fjala për Shqipërinë në personalitete të ndryshme citohej menjëherë emri i Kadaresë. Por në vitet 2000 autorë të tjerë u botuan në Francë si Fatos Kongoli, Besnik Mustafaj, Bashkim Shehu, Ornela Vorpsi, Ylljet Aliçka, Besa Myftiu etj., si dhe autorë të tjerë, poetë e romancierë, botime antologjish të romanit apo poezisë shqiptare, etj. Sigurisht shumë autorë të tjerë po përkthehen në gjuhën frënge, edhe pse duhet thënë se pak përkthyes ekzistojnë aktualisht në përkthimin e letërsisë shqipe në gjuhën frënge. Le të shpresojmë që nga gjenerata e emigracionit pas viteve '90, të lindur në Francë tashmë, të dalin përkthyes të përsosur.

M.: Keni përkthyer mbi 15 shkrimtarë shqiptarë dhe francezë në gjuhën frënge dhe në gjuhën shqipe. Një kontribut i çmuar. Si vendosët të merreni edhe më përkthime; nga kërkesa e shtëpive botuese, se identifikuat përfaqësim të mangët të dy letërsive në gjuhën e njëra tjetrës, apo për kënaqësi?

L.R.: Dëshira për të përkthyer erdhi si një nevojë e brendshme dhe si pasojë e pasionit për gjuhën frënge, fillimisht duke përkthyer librat e mi nga shqipja në frëngjisht, krijimet poetike, esetë, etj., siç ndodhi dhe me librin «Pont entre deux Rives», një vëllim që përmblidhte pikëtakime të Shqipërisë dhe Francës përgjatë historisë, me ngjarje e personazhe të ndryshme, nga Skënderbeu dhe poeti Ronsard, tek «Opera Skënderbeu» e shfaqur në Versajë duke vazhduar me Faik Konicën në Francë dhe revistën e tij «Albania», me histori të emigracionit, apo francezë të mëdhenj që iu gjenden pranë Shqipërisë në ditë të vështira siç ishin deputeti Justin Godart apo senatori Paul d'Estournelles de Constant si dhe personazhe të një kohe të mëvonët deri në ditët tona. Një nga librat e parë ishte dhe përkthimi në shqip i poetit francez Alain Bosquet «Demain sans moi» («Nesër pa mua»). Më pas kam përkthyer poetë shqiptarë në frëngjisht si ishte Rita Petro me librin «L'Origine» të botuar në shtëpinë botuese «L'Harmatann», Petraq Risto me «I hidhur mjalti i varreve» botuar në «L'Harmattan» apo së fundi «L'homme avec la fenêtre dans ses bras» («Njeriu me dritaren në krahët e tij») botuar po në «Le Petit Vehicule» (në bashkëpunim me përkthyesin Luan Canaj. Nga poetët francezë kam përkthyer, gjithashtu librin e Laure Cambau «E bardhë pa të bardhë», ku gjysma e librit i kushtohet pikturës së Omer Kaleshit nga shqiptarët e Maqedonisë së veriut. Ishte shtëpia botuese ALBAS në Tiranë që më kërkoi të përktheja «Kantikën e Kantikave» apo siç njihet gjithashtu «Këngа e Salomonit», që është dhe kënga më e vjetër dhe më e bukur e dashurisë në botë. Kjo pjesë e Dhiatës së Vjetër, pra e Biblës hebraike, duhej përkthyer në fakt nga hebraishtja, por në mungesë të një përkthimi të deritanishëm nga kjo gjuhë, me dëshirën për ta bërë të njohur këtë perlë të dashurisë, e përktheva nga frëngjishtja duke krahasuar tekstin zyrtar të Vatikanit me dy përkthime të tjera, njëra prej të cilave nga studiuesi i shquar Ernest Renan.

M.: Sipas mendimit tuaj, çka po ndodh me letërsinë në këto kohë të zhvillimeve të mëdha teknologjike dhe konsumit të shpejtë. A kemi lexues të durueshëm që i rrinë besnik leximit voluminoz të letërsisë?

L.R.: Sado të përparojnë teknologjitë e komunikimit gjer tek ato më të sofistikuarat, mendoj se njerëzimi nuk do ta lëshoj librin nga dora, jo pse është krijuar tashmë një lloj riti i vjetër, por sepse ka një lidhje të jashtëzakonshme shpirtërore midis librit në letër dhe lexuesit që nga koha e Gutenbergut. Kam pyetur shumë miq e njerëz rreth leximit të romaneve në tabletat elektronike, madje e kam provuar dhe vetë, por e pamundur ta shijoj letërsinë në një ekran, ndryshe nga libri në letër, që e shfleton duke medituar mbi të. Leximi elektronik është një lexim i ftohtë, edhe pse praktik për tu informuar, por nuk është emocional. Është një lidhje shekullore që u reziston dhe do ti rezistojë teknologjive moderne edhe në të ardhmen. Njeriu ka nevojë ta lexojë në letër, ti rikthehet dhe të imagjinojë në intimitetin e tij.

M.: Bazuar në përvojën tuaj, letërsia shqipe lexohet dhe mësohet si një letërsi e përbashkët, apo e ndarë sipas shteteve/qendrave kulturore?

L.R.: Kudoqoftë njeriu, në një vend të madh apo të vogël ka nevojë jo vetëm të lexojë letërsinë e kombit të tij por dhe të kombeve të tjerë. Kjo ka qenë dhe është e përbotshme. Latinët nisën të përkthenin autorët antikë të Greqisë së lashtë, sepse njerëzit kishin nevojë të njihnin popujt e tjerë. Po kështu Perëndimi përktheu letërsinë e vjetër perse apo atë kineze e arabe. Të gjithë duam të lexojmë nga letërsia e popujve të tjerë, pasi përmes saj mësojmë për trashëgiminë e tyre, traditat, sistemet shoqërore, identitetet, trashëgimitë materiale



dhe imateriale. «Iliada» dhe «Odisea» janë përkthyer në të gjitha gjuhët e botës. Po kështu dhe eposet e popujve ballkanikë, hispanikë, frëng, gjermanikë apo skandinavë. Letërsia lexohet sipas pasioneve, kërshërive, nevojave për të njohur një letërsi apo zhanret e një letërsie duke parapëlqyer këtë apo atë zhanër, poezinë apo prozën, tregimin fantastik apo esenë, biografitë, letërsinë për fëmijë, etj. Ajo sot mësohet nëpër shkolla në një kuadër më të gjerë, sipas shkollave letrare, traditave të shkrimit, autorëve, etj. Qendrat kulturore dhe Shtëpitë e Librit dhe të Leximit apo të Komunikimit janë bërë sot një nevojë e domosdoshme, por edhe panairet e mëdha, të cilat na japin rastin të njihemi si me letërsinë e traditës ashtu dhe me autorët më të rinj të saj.

M.: Para përfundimit, po kthehemi në vitet `90 kur Shqipëria ishte e mbyllur nga regjimi komunist dhe ju thyet kufijtë e hekurt për të komunikuar me Parisin, për të kryer funksionin e redaktorit në "Courrier International", si ndodhi?

L.R.: Në fillimin e viteve '90 unë vija në Paris si diplomat me pasionin për tu takuar me një kulturë perëndimore, por duke pasur stigmatet e një kohe totalitare. Ishte koha kur mijëra të rinj vazhdonin të largoheshin drejt Perëndimit për të ndërtuar një jetë më të mirë dhe gëzuar lirinë, përmes një emigrimi plot rreziqe. Por ata më së fundi ia dolën mbanë. Pas viteve 1991-1993, ish presidenti Berisha me të ardhur në pushtet përmes një nisme personale dhe autoritare i largoi nga ambasadat shqiptare nëpër botë të gjithë diplomatët që kishin ardhur para se ai të merrte pushtetin. Ishte një masë drastike dhe «revolucionare» e tipit të Robespierit. Pra, në Shqipëri gjithçka duhej të fillonte nga viti «zero», nga e para: ekonomia, kultura, drejtësia, diplomacia. Kështu unë fillova të merresha me kinematografi, duke u angazhuar me filmin franko-shqiptar «Larg barbarëve» të regjisores Liria Begeja e më pas në filmat të Pavel Lungin apo të Frederik Miteran. Në vitin 1995 u angazhova në revistën prestigjioze «Le Courrier International» për të mbuluar ngjarjet në Shqipëri dhe rreth saj në Ballkan, meqë Ballkani përjetonte ngjarje të mëdha



tragjike dhe tranzicionet ishin tepër të vështira. Duhej sjellë jehona e shtypit shqiptar rreth ngjarjeve si djegia e gazetës «Koha jonë», zgjedhjet e vitit 1996, Referendumi i Berishës apo ngjarjet e lidhura me «piramidat financiare» e veçanërisht ngjarjet kur në mars të vitit 1997 shteti ra dhe Shqipëria ishte në gjendje kolapsi. Në vjeshtë të vitit 1997 u caktova ambasador në Paris në një situatë post-krize, kur me ndryshimet politike, e majta erdhi në pushtet. Por, përsëri Shqipëria do të përjetonte ngjarjet tragjike të grushtit të shtetit në 1998 kur Berisha në krye të Partisë Demokratike sulmoi me antitanke kryeministrinë, e pushtoi atë si dhe televizionin shtetëror çka tregoi për trashëgiminë e politikës së dhunës. Duke vendosur në kontakt direkt ministrin e Jashtëm francez me homologun e tij shqiptar, Franca, ashtu si gjithë vendet perëndimore dhe Amerika, shprehu mbështetjen e plotë për qeverinë shqiptare duke deklaruar se pushtetet nuk merren përmes dhunës së rrugës, por me programe elektorale dhe votën e popullit.

Një nga periudhat më interesante për mua ka qenë periudha e Luftës së Kosovës, me ngjarjet e Konferencës së Rambujesë dhe të Kleber, çka e kam përshkruar dhe në librin kushtuar atyre ngjarjeve në veprën «Nën hijen e eklipsit», ku tregoj për angazhimin e madh politik e intelektual të Francës pro popullit shqiptar në Kosovë, takimet e udhëheqësve kosovarë në ambasadën shqiptare në Paris, etj.

M.: Jeni nderuar me çmime presidentësh, në vitin 2002, jeni nderuar nga Presidenti i Republikës franceze, Jacques Chirac me dekoratën e lartë "Grand Officier de l'Ordre National de Merite", (Oficer i Madh i Urdhrit Kombëtar të Meritës), në vitin 1986 jeni dekoruar me dekoratën "Naim Frashëri" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Si kanë ndikuar këto çmime të larta në krijimtarinë tuaj letrare?

L.R.: Dekorata "Grand Officier de l'Ordre de Merite» është një dekoratë tepër e rëndësishme që mund ti jepet një diplomati dhe kjo mendoj ka qenë fryt i angazhimit si në planin bilateral ashtu dhe në angazhimin tim në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë dhe si përfaqësues Personal i presidentit Rexhep Meidani. Më pas unë u zgjodha anëtar i Këshillit të Lartë të Frankofonisë, një këshill që përpunonte politikat e kësaj organizate. Në ato vite kam udhëtuar shumë në vendet frankofone dhe kam marrë pjesë në misionet vëzhguese për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në vendet frankofone në Afrikë (Senegal, Niger, Cad, Madagaskar apo në Oqeani, në ishujt Moris etj. Madje kam drejtuar dhe misione të tilla. Këto udhëtime, siç ishte dhe ajo në Guine Bisao, të japin rastin të njihesh me kulturat e popujve dhe shkrimtarët e këtyre vendeve. Ndërkohë në vitin 2000 u nderova dhe me çmimin evropian të Shoqatës së Shkrimtarëve të Gjuhës Frënge për librin "Udha e gjatë në tunelin e Platonit". Megjithatë, nuk janë as dekoratat e as çmimet ato që të nxisin në kuadrin letrar. Gjithçka vjen nga pasioni dhe dashuria për letërsinë dhe aktin e të shkruarit. Nga libri në libër fitohet eksperiencë, mësohet, ngjit shkallë të tjera.

M.: Duke dëgjuar për punën tuaj voluminoze, tani jeni duke pushuar apo duke punuar në projekte të reja?

L.R.: Kur hyn në rrugën letrare e vështirë të ndalesh pasi në çdo hap, në çdo ngjarje apo histori njerëzore që je i pranishëm është gjithnjë ngasja për ta shkruar në një mënyrë letrare, për tu bërë një narrator, një rrëfimtar i ngjarjes apo jetës së një personazhi. Ja pse udhëtimet janë shpesh burime letrare pasi ke mundësi të pikëtakosh personazhe, të njohësh drama, tragjedi, supersticione apo komedi që ti sugjeron vetë jeta e përditshme. Aktualisht sapo kam përfunduar një libër me shkrime historike nga koha e Cezarit deri në vitin 1200 ku përfshihen ngjarje historike me Shqipërinë. Ndërkohë po përgatis gjithashtu një libër të ri poetik si dhe një roman bazuar mbi një tregim të botuar në vëllimin me tregime "Vjeshta e Alberto Savianit" të botuar para dy vitesh. Është interesant fakti se jo rrallë tregimet më japin ngasjen për ti kthyer ato në romane, pasi lënda apo ngjarjet dhe personazhet që përshkruhen janë të tilla që premtojnë për një trajtim më të gjerë. Ndërkohë kam përfunduar dhe shkrimin e një tregimi fantastiko-shkencor për fëmijë që mori shkas me shpalljen në janarin e këtij viti të një ylli me emrin "Illiria" dhe planetin e tij të quajtur "Arbër". Më pëlqen letërsia për fëmijë çka dëshmohet dhe me librat e botuar "Në botën e pikturës" dhe "Legjenda shqiptare" të botuara nga ALBAS. Po kjo shtëpi botuese më ka botuar 9 libra të kolanës "Më quajnë", si librat "Më quajnë Skënderbeu", "Më quajnë Onufri", "Më quajnë Aleksandër Moisi", «Më quajnë Ismail Qemali», e për personazhe të tjerë historikë apo të artit e kulturës shqiptare. Siç mund ta kuptoni unë shkruaj paralelisht zhanre të ndryshme duke ecur paralelisht në disa projekte njëherësh, çka ndoshta dikë tjetër do ta pengonte kjo mënyrë të shkruari. Zakonisht poezitë i shkruaj nëpër trena, tramvaje, avionë, nga ngasje direkte, pa pritur muzën. Prej disa kohësh kam dashur të shkruaj për një figurë mjaft interesante, senatorin francez Paul d'Estournelles de Constant, një nga mbrojtësit e mëdhenj të Shqipërisë në vitet '20 të shekullit XX, por për këtë më duhet të shkoj jashtë Parisit, ku dhe ndodhet gjithë fondi i tij arkival. Tashmë sapo kam mbaruar mbledhjen e materialeve historike dhe nisur shkrimin e një libri për stradiotët shqiptarë në Francë dhe bëmat e tyre, pasi stradiotët që erdhën nga brigjet shqiptare dhe Peloponezi pas vdekjes së Skënderbeut i shërbyen fillimisht Republikës së Venedikut e më pas morën pjesë në luftërat e Italisë. Gjatë një shekulli ata u shfaqën dhe në Francë, duke filluar me mbretin francez Charles VIII e duke vazhduar me mbretin Louis XII, François I, apo Henri IV. Ishin këta stradiotë, këta «kalorës të stuhisë» siç i cilësonin kronistët e asaj kohe, që i dhanë Francës fitoren gjatë betejës së Marinjanit. Shumë prej tyre, mbretërit francezë i fisnikëruan pasi ishin ata, siç shkruajnë historianët francezë që krijuan në ushtrinë franceze atë që quhej «Chevalerie albanoise» («kalorësia shqiptare»). Një kohë padyshim epike. Kontributi shqiptar, siç e vë në dukje dhe një nga historianët e mëdhenj francez Albert Dumont, është i madh në Mesjetën evropiane... Pra në punën krijuese, siç e shikoni, do më duhej që dita të mos kishte 24 por 48 orë, në mënyrë që të mund të realizoj dëshirat e mia por dhe si kontribut në fushën e historisë dhe të letërsisë.

(Ermelinda Kashah "*Proza e Petrit Palushit*" Monografi, Lumbardhi, Prizren 2021)

GJUHA ROMANORE E PETRIT PALUSHIT - DASHURI, TRADHTI, DHEMBJE DHE VETMI

Nga Kosovare Krasniqi

Libri studimor "*Proza e Petrit Palushit*" i studiueses Ermelinda Kashah është studim mbi një personalitet të rëndësishëm të letrave shqipe.

Ermelinda Kashah përveç që është profesoreshë e Universitetit të Gjirokastrës "*Eqrem Çabej*", është e njohur edhe si studiuese e letërsisë shqipe, sepse është autore e shumë titujvestudimorë, të publikuar brenda dhe jashtë vendit.

Krijimtaria e romansierit Petrit Palushit është ndër të veçantat në letërsinë shqipe, dhe rruga shkencore që studiuesja Ermelinda Kashah ndjek, është të shpalosë botën krijuese të tij, e cila shpërfaqet kryesisht në fushën e romanit.

Jo pak here e pyesim veten si studiues, si do ta gjykojë lexuesi punën tonë studimore?

Dhe, përgjigjja e një pyetje të tillë është kjo:Vlera e një studiuesi qëndron gjithnjë në zbulimin e një diçkaje që e veçon shkrimtarin nga shkrimtarët tjerë.

Dhe, cila është vlera e autorit Petrit Palushi si shkrimtar?

Trajtimit dhe studimit të krijimtarisë së romancierit Petrit Palushi, studiuesja Kashah i qaset me mjaft kujdes dhe nga këndvështrime të ndryshme.

Në monografinë gjithëpërfshirëse të krijimtarisë së Palushit, studiuesja sjell të dhëna me interes për lexuesin, e gjithashtu lexuesi njihet me një vepër origjinale për romansierin Palushi.

Ajo që e bën artin të veçantë, mendoj se është qartësia e mendimit. Kjo është arsyeja pse studiuesja duke ecur nëpër krijimtarinë romanore të Palushit thotë se, arti i romanit të Palushit, është art i pastër dhe jep ide origjinale. Për më tutje, studiuesja shton se, letërsia e shkrimtarit Palushi, është shpërthim i përjetimeve emocionale, që derdhet përmes një ligjërimi gati të figurshëm, por jo mbi koncepte teorike, dhe jo krijimi një egoje "eksperimentale".

Metodat e studimit të cilat studiuesja zgjedh t'i përdorë, janë krahasuese e cilësore, pastaj metoda e mbledhjes së të dhënave, si, kërkimet shkencore e konferencat kombëtare, duke dashur që origjinaliteti të jetë tipari që e karakterizon librin.

Struktura dhe rrjedha e librit

Struktura mbi të cilën studiuesja Kashah ka ndërtuar kornizën e librit, mund të konsiderohet si studim gjithëpërfshirës i krijimtarisë së Petrit Palushit. Kjo strukturë e librit në fjalë, vështrohet edhe nga prizmi i studiueses Klara Kodra, e cila sa i përket krijimtarisë së shkrimtarit Palushi dhe studimit të studiueses Kashah, thotë: "*Autorja e punimit ndalet edhe në meritat e Petrit Palushit si kritik dhe eseist letrar. Merita kryesore e autores* është *ajo e qarjes* së *një toke gati* të *virgjër. Ermelinda, pse jo gjithashtu, përpiqet* të *tregohet origjinale dhe objektive*". Pra, edhe pse Palushi është mjeshtri i cili krijon rrëfenja dhe me këmbëngulje e kultivon prozën, ku edhe mbetet prozator deri në fund, dhe i dalluar në fushën e romanit, studiuesja Kashah nuk e veçon, andaj shprehet: "*Shkrimtarin Petrit Palushin e vlerësova si prozator cilësor* në *krejt plotëninë e vet letrare*" (Kashah, 2021:16)

Një pasqyrë e romaneve

Me temat që trajton shkrimtari në romanet e tij, pastaj me mënyrën si e formëson lëndën në romanet, dhe me gjuhën dhe stilin e tij të veçantë të tij, proza e Petrit Palushit e nxit lexuesin të përsiasë për të, të mendojë më thellë, por edhe kritikën të gjykojë për këtë vepër, për secilën veç e veç, por edhe si vepër në tërësi.

Mprehtësia e shkrimtarit të mbështetet në imagjinatën dhe i lindur në një mjedis ku realiteti bëhet një me botën e legjendave, duke shfrytëzuar këtë botë, krijon një prozë moderne. Studimi i profesoreshës Kashahi trajton pikërisht këto romane me vlerë dhe siç e mendon ajo,"*Shkrimtari Petrit Palushi hyri në letërsi siç hyn një studiues me rrëfime madhështore të ideve. Hyri me tema që hasen shpesh, si ajo e artit të bukur, për të mbërritur drejt një pjekurie problematike dhe të kuptueshme, drejt një humanizmi të ri që konsiston në pranimin e vetëdijshëm të jetës*".(Kashah, 2021:26)

Dhe, si gjithnjë kur kemi pranë monografinë gjithëpërfshirëse të krijimtarisë së Palushit, pyetja që do lindë përnjëhershëm në laboratorin e kokës tonë është, çfarë kanë në qendër të subjektit romanet, pastaj si ecën autori në trajektoren romanore të tij me strukturën dhe mikrostrukturën e prozës së tij?

Profesoreshë Ermelinda në monografinë e saj është përpjekur të na sjellë të gjitha përgjigjet lidhur me këtë çështje, për të cilën pse-të ekzistojnë.

Lidhja e studiueses me shkrimtarin Palushi u nxit nga një libër i vetëm, "*Artemisa e mëkatit*", dhe kërkimi i saj në zgjidhjen e pse-së në romanet e autorit Palushi kishte filluar sapo kishte lexuar romanin. Në subjektin e kësaj vepre paraqitet bota e femrës dhe jeta erotike e saj. Autori, Artemisën e portretizon me simpati, por edhe me vërtetësinë më të pamëshirshme. Sipas studiueses, me ardhjen e kësaj vepre vjen edhe një prozator i fuqishëm, por edhe me ç'segment elegant e narrativ, ajo thotë:"*Romani është shkruar me elegancë, ka një ndërthurje të narracionit, meditimeve digresioneve, imazhit shpëtimtar ndaj imazhit të rremë*".(Kashah, 2021:45)

Shkrimtari Palushi parapëlqen që në romanet e tij të subjektizohen anët e errëta të sistemit komunist, dhe jeta nën diktaturën e egër komuniste janë kryesisht temat të cilat trajtohen në veprën e tij krijuese. Tema dhe probleme tjera njerëzore, si mungesa e lirisë së fjalës, ndalimi i religjionit, varfëria e skajshme, mungesat më elementare në një kohë kur mund të thuhet se edhe ëndrrat ishin të ndaluara dhe që shpërfaqen në pjesën dërrmuese të romaneve të tij, janë trajtuar nga studiuesja Kashah. Ajo jep një analizë të shkëlqyeshme të një vizioni të veçantë,kur bën prezantimin mbi atmosferën ku zhvillohen ngjarjet e romaneve. Autori është shumë realist, dhe bota tematike e ngjarjeve në romane përshkruhet pa u dhënë shumë anë të ndritshme apo të errëta, shumë të ëmbla apo shume të hidhura, shumë serioze dhe shumë ironike, pra jep jetën me nota reale të saj, pa anuar nga asnjëra anë - as nga ajo e keqja e as nga ajo e mira, gjithnjë shkon në një mjedis gri. Pra, një analizë e tillë do të fokusohet edhe brenda kornizës së këtij studimi,"*Shkrimtari prek konceptin e tij për kohën, të tashmen historike, ose të tashmen e amshueshme , e cila qëndron aty ku priten boshti i kohës dhe i hapësirës reale me boshtin e kohës dhe hapësirës ireale. Koha në veprën e autorit nuk është vetëm gjykim vlerëmatës, edhe pse vetë zgjedhja e temave dhe e autorëve përmban në vetvete parapëlqimin dhe nevojën e domosdoshme të gjetjes së vendndodhjes në strukturën e sistemit tonë letrar*". (Kashah, 2021:27)

Për të arritur mendimin esencial në vëmendjen e lexuesit për një autor dhe krijimtarinë e tij, metoda krahasuese është materiali më i përshtatshëm. Dhe, Ermelinda si në një formë të pyetjes, na thotë,*Gjithmonë një studiues gjatë leximit zbulon t*ë përbashkët *atdhe të veçantat që ky ka me shkrimtarë tjerë; ç'rëndësi ka se të kujt drejtim janë, modernistë, postmodernist*ë *apo realist*ë. Megjithëse, gjykimi kritik i saj na shpije te një autor, *romanet e të cilit janë balada për dashurinë dhe jetën në tërësinë ë vet*. (Kashah, 2021:65).

Gjithashtu, një element i cili kërkon vëmendje të veçantë dhe që është në harmoni me veprimin shkencor, të cilin studiuesja Kashah vë në dukje, është edhe elementi publicistik i këtij autori. Pikërisht për këtë arsye studimi plotësohet edhe me fjalët e studiuesit Prof. Dr. Zeqir Kadriu, cili e mbështet idenë se, "*Me shumë përkushtim profesoresha Ermelinda Kashah* vë në dukje elementin publicistik të këtij shkrimtari*, i cili është në harmoni me veprimin shkencor apo atë analitik, duke i dhënë këtij punimi monografik vlerën e këtij botimi të formatit të gjerë*". Unë mendoj se kritika e vërtetë i kushton rëndësi edhe intervistës me autorin, dhe në librin në fjalë nuk mungon një dialog kritik i tillë, nga biseda me të cilin ne mësojmë për surpriza të rëndësishme e gjëra interesante.

Edhe kritikët tjerë letrare nuk kanë kursyer lavdet për romansierin Palushi. "*Opinione t***ë** *kritik***ë***ve dhe studiuesve shqiptar*" ***ë***sht***ë*** pjesa ku kritika shqipe jep një pasqyrë koncize dhe shumë informuese të zhvillimit të artit të autorit. Emrat më të njohur kritik të krijimtarisë së Palushit janë: Vath Koreshi, Sali Bytyçi, Abdullah Konushevci, Arta Marku, Ahmet Selmani, Prend Buzhala e shumë të tjerët cilët përmenden në libër.

Përfundim

Në këtë monografi për veprën letrare të shkrimtarit shqiptar Petrit Palushi, Ermelinda na shpjegon se pse Palushi është shkrimtari i saj i përzgjedhur dhe pse vlerëson ajo veprat e këtij shkrimtari.*"Pasi lexova veprat e shkrimtarit, kuptova se sistemi i ideve të tij është i mirëngritur, funksional dhe i specializuar fakte këto që ndriçojnë dhe tërheqin mendjen e lexuesit"* (Kashah, 2021:24). I tërë arti i shkrimtarit dëshmohet në fjalët e saj.

Bota e romancierit ka forcën të bëjë vetëm me kënaqësinë e të treguarit. E frymëzuar nga një shkrimtar, romansier, i cili në krijimtarinë e tij, *përveç lëvizjes në realitet të personazheve, merr krahë fuqishëm edhe fantazia,*studiuesja krijon një përshtypje të fuqishme dhe një admirim për profesionalizmin e autorit. Për këtë Ermelinda thotë: "*Një nga intencat e këtij studimi, është edhe trajtimi i lidhshmërisë, apo bashkëjetesës së koncepteve kohë dhe hapësirë* në *letërsi. Letërsia shpreh kohen ose alegorinë e kohës*isë. *Koha sillet* në *raportet hapësinore shkak-pasoje,* në *raportet kuantifikuese, prandaj edhe vepra* është *refleksion i saj* më *i thellë*".(Kashah, 2021:74).

Do ta përfundoja duke shtuar se studimi "*Proza e Petrit Palushit*", i studiueses Ermelinda, është një e arritur dhe me vlerë studimore, studim për një autor, i cili fuqishëm jep mesazhin e veprave të tij, në të cilat temë mbi temat mbetet liria e individit dhe dashuria e tij ndaj njeriut.

Persiatje mbi romanin "Varret" të shkrimtarit Erjon Muça

MBI "VARRET" DHE RRËNOJAT TONA AUTOKTONE

Nga Pol Milo

- Në djall të vejë vdekja! – thirri duke tundur Lëkurën e shagrenit, - Tani dua të rroj! Jam i pasur, domethënë i kam të gjitha meritat. Askush s'do të më kundërshtojë. Të kam në dorë moj pronë e famshme! Jam i pasur, mund t'ju blej të gjithëve, edhe atë deputetin atje, që po gërhet. Hajdeni, horra të shoqërisë së lartë, bekoëni!

Honoré de Balzac – Lëkura e shagrenit

Thuhej se Poliandër Mele i paskësh thënë mikut të tij Petraq Bubarit, se një studiues fatsjellës, nga një qytet antik i rrënuar në brigjet e Mesdheut perëndimor, i paskësh dhuruar një libër kryetarit të shoqatës së po asaj bashkësie njerëzish që ishin autoktonë.

Ky libër, i cili fliste për tre breza të tërë që kishin jetuar mbi ato toka apo kodrina, paskëshin takuar edhe paraardhës të kryetarit. Deri diku ky paska qenë në dijeni, por donte të dinte ende më tej. Ndoshta do duhej zbuluar mbi rrënjët apo "Varret" siç quhej edhe ky libër apo ndoshta edhe më tej, të zbulohej mbi bazën autoktone të kësaj prejardhje. Jo se Poliandri i dinte mirë këto gjëra, por gjatë diskutimeve me Petraqin diçka edhe e kishin zbardhur.



Në një qytet të Italisë jeton një shkrimtar që është po aq autokton sa vetë njerëzit që jetojnë në bashkësinë e Mesdheut perëndimor, por që rrefimet e tij i kishte mbledhur dhe kamufluar në trajtë romani, që nuk ka historian që mund ti krijojë.

Duke qenë se kryetari interesohej për çështje të rëndësishme, ai u habit por njëkohësisht u mendua sesi miku i tij studiues fatsjellës kishte qenë në dijeni dhe në zotërim të këtij romani. Bashkë me librin paskan ekzistuar në qytetin antik të rrënuar mistere dhe sekrete me prejardhje të panjohura. Jo vetëm mistere dhe sekrete të okultizmit dhe të astrologjisë, por më tepër të teknikave artizanale të prodhimit dhe të përpunimit të produkteve dhe të sendeve. Një mister i tillë thuhej se ishte edhe një teknikë e përpunimit të lëkurëve.

Disa banorë me prejardhje nga malësitë të quajtur lumjanë, kishin sjellë delet dhe dhitë e tyre në ultësirat bregdetare. Pas ritualeve të therjes dhe marrjes së mishit, lëkurat i liheshin vendasve. Duke qenë pranë kriporeve të shumta, kishin zbuluar se në kriporet e Dajlanit, siç quhej zona aty pranë, lëkurat e deleve dhe të dhive regjeshin nga dielli mesdhetar i përzier me kripën e detit duke u kthyer kështu në produkte të kësaj punishteje të teknologjisë së mirëfilltë.

Më pas këto lëkura shiteshin dhe transportoheshin me anije nga porti drejt e në perëndim. Tregtarët e vendeve europiane i blinin ato për t'i përdorur, por pa e ditur dhe pa e shpjeguar misterin sesi arrinin ta merrnin atë cilësi. Kurse mjeshtrit që kishin zhvilluar këtë teknikë të mistershme përpunimi kishin filluar të quheshin punues të lëkurave nga delja e dhia. Vetëm këta mjeshtra mund ta arrinin këtë cilësi.

Por cili ishte ky sekret kaq i panjohur që ata kishin zbuluar!? Dikur thuhej se nje astrolog nga orienti kishte nxjerrë një sekret të ngjashëm nga yjësia e dashit, por gjithashtu mendohej se edhe një tjetër zbulim do të kishte ardhur nga yjesia e peshqve. A thua peshqit të mbanin sekrete?! Po, paska qenë e vërtetë, ky sekret paska ardhur nga peshqit. Në një vend bregdetar, çdo gjë pritet të vijë nga deti, ashtu siç kishin ardhur disa peshq të një thellësie të njëjtë, nga një rryme e ngrohtë detare. Këta peshq kishin në kurrizin e tyre shenja si të zebrës, vija-vija, që peshkatarët i kishin dalluar.

Ky lloj peshku kishte marrë emrin "Skumër" dhe peshkatarët e kishin tharë atë. Në të njëjtën mënyrë kishin vepruar edhe me lëkurat në kriporet e Dajlanit, duke i tharë sipas thatësirës ose lagështirës stinore përzier me nivelin përkatës të kripës. Teknika ishte aq shumë e zhvilluar saqë kishin filluar të shpjegonin dukuritë e ndryshimit të motit dhe të lagështirës së ajrit vetëm nëpërmjet zgjerimit apo tkurrjes së lëkurave.

Tregtarët në perëndim s'kishin sesi ta kuptonin këtë dukuri ndaj dhe kjo interpretohej si një lloj enigme e pashpjegueshme mbi zgjerimin apo tkurrjen e tyre. Ato kishin lexuar vetëm per tkurrjen diabolike të lëkurës së shagrenit që ndiqte dëshirat e një shoqërie të orientuar nga pasuria dhe dëfrimi i çthurur. Horrat e shoqërisë së lartë kishin shtrirë zotërimet e tyre mbi pasuritë dhe pronat shekuj më parë, kur morali në brigjet e Mesdheut perëndimor ishte në zhvillim. Ato kishin kujtuar se kishin pushtetin e gjithësishëm, madje edhe mbi virtytet e natyrës dhe universit. Por ato ende nuk kishin kuptuar misteret e përtejme, ndaj po rrudheshin si lëkurat e tkurrura e të thara të egos së tyre përtej dëshirave dhe pasioneve.

Këto gjëra nuk shkruheshin qartë në libër dhe shkrimtari që jetonte në Piza i kishte shpjeguar shkarazi ato, pasi nuk mund ti rikthej zbulimit të sekreteve të lëkurave, sikurse shkrimtari tjetër që kishte pas shkruar në mënyrë më të thelluar për sekretet dhe lëkurat e shagrenëve në librin e tij. Të gjithë kujtuan se kishin zbuluar gjëra që kishin të bënin me këto mistere, por nuk po arrinin ende të konkuldonin për çështjet që kishin të bënin me prejardhjen e tyre autoktone.

Gjynah që ai shkrimtari i lëkurave dhe i shagrenit nuk foli kurrë për mjeshtrat e Kazazëve, Deliallisëve, Kacanëve apo Karagjozëve. Këtë do ta bënte dikush tjetër, shekuj më pas.

Këtë vijonte të diskutonte Poliandri ndërsa miku i tij Petraq po thonte se ai studiuesi kishte zbuluar në librin e shkrimtarit nga Piza një ekuacion të padukshëm, që barazonte rrënojat e qytetit antik me varret e njerëzve! Ndryshe nga shkrimtari i lëkurave të shagrenit që rrënojat e njerëzve dhe të shoqërisë aludonte ti groposte nëpër varre, ky shkrimtari i ri dukej sikur varreve i jepte jetë, i jepte kuptim. Këto paradokse dihet që krijojnë tronditje nëse lihen të lira të përhapen masivisht. Por duke qenë se tronditje njëra pas tjetrës filluan të ndodhnin se fundmi në qytetin e rrënuar, duket sikur çështja e varreve, lëkurave dhe mistereve ishte lënë në hije.

Tharja e lëkurave ishte vetëm njëri nga misteret që Poliandri dhe Petraqi kishin zbuluar. Kurse kryetari do të gjente aty jo vetëm këtë, por edhe një pjesë të historisë së dy shekujve të fundit të autoktonëve të lidhur me këto mbiemra, që përdoren e ruhen ende dhe sot.

Këto gjëra Poliandri i pohonte ndonjëherë në heshtje, kurse miku i tij Petraq kishte insistuar që të mos harxhonte shumë kohë dhe energji me të pazgjidhshmet por të merrej edhe me të zgjidhshmet. Kurse zgjidhshmet ishin gati aty. Dy gota me birrë të freskët u ngritën në tavolinë, u dëgjua një trokitje e lehtë dhe më pas disa gllënka.

MOIKOM ZEQO – NJË JETË E PAZAKONTË E NJË NJERIU TË MADH

Vllasova Musta

Kaloi një vit, prej asaj dite të kobshme, kur miku ynë i shtrenjtë Moikom Zeqo, iku nga kjo jetë.

Edhe pse i ikur, ai është përherë mes nesh, na thërret dhe ne, s´bëjmë tjetër veçse duam të flasim e të tregojmë për të.

Ai la krijimtari të pafundme, libra dhe libra pambarimisht sikur e dinte, që do të shkonte shpejt dhe nxitonte t´i linte duke përcjellë në to gjithë tharmin e diturisë së tij të pamatë,me kulturën e jashtëzakonshme dhe të gjithanshme, me talentin e madh dhe aftësinë befasuese për të punuar, pa ndjerë kurrë lodhje dhe të gjitha këto, përbëjnë atë që është quajtur „Fenomeni real i një çudie njerëzore, me emrin Moikom Zeqo“.

Moikom Zeqo, është portreti emblematik ku spikati poeti, prozatori, studiuesi, gazetari, arkeologu, historiani, politikani e shumëçka tjetër, i papërsëritshëm dhe i rrallë në diturinë dhe mrekullinë e tij.

Fenomeni Moikom Zeqo, është modeli tipik i një vizionari të lartë, që çeli një etapë të re në letërsisë dhe kulturën shqipe.

Në poezitë e Moikomit, figurat artistike, metaforat, fantazia ishin në pikat më kulmore aqsa, të dukej sikur para teje hapej një tjetër botë, e paparë dhe e padëgjuar më parë.

Kujtoj, se teksa lexoja me ëndje librin e tij me poezi „Përjetësi me qira”, më shoqëronin pandërprerë motivet e poezive, befasitë shpërthyese, metaforat e përndritura dhe kësisoj, ndihesha sikur isha nën një vezullim yjor, që më vërtitej në çdo hap e në çdo kohë.

Pasi e mbarova së lexuari krejt librin, ndjeva sikur rreth meje vërtiteshin dhjetëra universe, me dije, me kulturë, me shkëlqim, me dhunti tej njerëzores së përditshme e në fund, e mrekulluar prej asaj që kisha marrë, thashë me vete: udhëtova në universin magjik me tingull, me ngjyrë, e me dritë të Moikom Zeqos!

Përherë jam ndjerë fatlume, që u njoha me të, kur ishim bashkëstudentë, 18 vjeçarë, e kisha shok e më pas mik të shtrenjtë e tejet të çmuar, maratonomakun me flakadan drite që, edhe pse me ritmin e tij i kish kapërcyer kohët, e kishim mes nesh e na përcillte mrekullinë e penës së tij!

Po, gjithë jetën, ai ishte një maratonomak dijeplotë, që rendtte e nuk dinte të ndalej.

Sa herë më thoshte që, do të pimë një kafe dhe do të të sjell botimin tim të fundit, gjithherët ndjeja një gëzim dhe isha si në festë, sepse e dija se përballë meje, po vinte maratonomaku me një flakadan të ri në duar dhe brenda atyre fletëve vezullonin mrekullitë e talentit dhe fantazisë së tij të epërme.

Ky ishte Moikomi, një njeri krejt i veçantë, në dituri, në mirësi, në lidhje miqësore, në dhënie dashurie, me aftësi unikale dhe tepër të natyrshme për të pasur pranë jo një, dy apo tre miq e shokë, por pambarimisht, si në Shqipëri, Kosovë e kudo nëpër botë.

Ai kishte pranë vetes jo vetëm miq prej një jete, por edhe të sapo njohur, që i mirëpriste me një bujari të pazakontë, aq sa pa hezitim mund të thuash se, ai dha, por edhe mori shumë dashuri njerëzore.

Këtë vlerë të karakterit të Moikomit e trajton, në librin e sapo botuar, të titulluar ”Me Moikomin” në këndvështrimin më të bukur e më të plotë, miku i tij i kahershëm dhe shkrimtari i penes elegante e gjithë ngjyrë, Enver Kushi.

Para pak ditësh e mora këtë libër, që e prisja të dilte nga shtypi, e lexova me një frymë dhe faqe pas faqeje, më rishfaqej Moikomi me gjithë madhështinë e shpirtit të tij njerëzor.

Askush më mirë se Enveri, nuk mund ta jepte me kaq botë, me kaq emocion, me këtë vërtetësi të ngrohtë portretin njerëzor të Moikom Zeqos. Një jetë pranë njëri tjetrit, një jetë e mbushur plotepërplot me mirësi dhe ndjenja të një fisnikërie për t´u admiruar, një jetë krah për krah, duke shpërfillur distancat e duke bashkuar gëzimet, shqetësimet, e deri tek sëmundja e mundimshme e mikut të vyer.

Enver Kushi, një mik i rrallë, që pasi largohet nga spitali, është i paqetë dhe s´bën tjetër veçse merr letrën përpara e nis të shkruajë, isha tek Moikomi, duket i përmirësuar, më tej, shkova në spital, ishte si në kllapi, në një tjetër ditë, sot ligjëroi pafund për gati një orë, e habitshme, ku e gjen gjithë këtë forcë, e kështu ditë pas dite ai është pranë tij, i pandarë, duke përjetuar gjithë ecurinë e shëndetit të tij të keqësuar, por përherë duke e shmangur mendimin kobzi se nga dita në ditë, po avitej e mund të trokiste vdekja.

Në këtë libër janë ndërthurur në një harmoni të përkryer kujtimet, mbresat, letërkëmbimet mes tyre ndërvite, shkrimet dhe fotot, që kanë si kryefjalë të pandarë, Moikomin, por Moikomin njeri, Moikomin mik dhe shok, aqsa të duket sikur gjithçka rrjedh si në një bashkëbisedim që zgjat pambarimisht.

Po, ky libër, është si njëbashkëbisedim i papërsëritshëm, i një erduditi, që përherë na befason, që në gjithçka thotë duket sikur ka zbritur nga kozmosi dhe shpalos gjithë dituritë jo vetëm për mikun e tij, Enver Kushin, por njëherazi për gjithë ata, që do të duan të lexojnë e të dinë, cili ishte Moikom Zeqo.

Dhe pikërisht në këtë përzgjedhje materialesh të një jete të tërë, në këtë strukturim të gjithë librit, Enver Kushi ka ditur të japë tharmin e vlerave, esencën kulturore dhe shpirtërore të atij tempulli gjigand, që mbartte emri i ndritur, Moikom Zeqo.

Në gjithësinë e këtij libri ka brenda shumë dashuri, ka fisnikëri dhe dritë shpirtërore, ka frymë, ka emocion, ndjen dhimbje dhe ajo që është më parësore, ke përballë një portret jetësor, të vërtetë, të pakrahasueshëm dhe pa asnjë ngjyrim dashamirës nxitur nga miqesia.

Në të është Moikomi ynë, ashtu siç e kemi njohur e për çka e kemi dashur!

Sepse, tek të gjithë miqtë e tij, ai mbetet pasuri pa cak, që patëm fatin ta njihnim dhe do të jemi krenarë sa herë që do të themi: e kisha mik!

Në letërsinë botërore është shkruar për personalitete të mëdha të të gjitha kohëve, për shkrimtarë, për artistë, për shkencëtarë dhe përherë më ka tërhequr vëmendjen një fakt që, pasi thuhen gjithë vlerësimet absolute për njërin apo tjetrin në fushën e suksesit të tyre, kur ndalen tek portretizimi i tipareve në marrdhëniet njerëzore, ka përherë një **“por“**, thuhet: ishte gjeni, **por**, në mërrdhëniet njerëzore ishte zemërak, apo, ishte talent i madh, **por,** në raport me të tjerët, ishte i mbyllur, ishte i ngurtë, apo ishte vigan, **por,** krejt i vetmuar, pa miq, etj,etj.

Jam e sigurt, se sa herë do të flitet për Moikom Zeqon si poet, shkrimtar, studiues, arkeolog, historian... një univers dijesh, nuk do të ketë kurrë një “**por”**, sepse ai ishte i madh në gjithçka dhe atij i takon si askujt tjetër vleresimi, Moikomi i Madh.

Ndaj them se libri **“Me Moikomin“,** i shkrimtarit të talentuar dhe mikut tim të mirë, Enver Kushi, është një dëshmi autentike e sjellë me art dhe shpirt për figurën e ndritur të Moikom Zeqos, ndriçon dhe i jep vezullim jetës, karakterit dhe botës së tij të brendshme.

Moikomi nga njera faqe e librit e në vijim të tyre, flet, tregon, bashkëbisedon e pasi e mbyll faqen e fundit, ti ndjen se ai vazhdon të frymojë, të shkruajë e të sjellë një tjetër libër, një tjetër studim, një tjetër esse sepse ai vetëm kështu do të jetë në kohë e paskohë, duke shpalosur, duke rrëfyer, duke sjellë vlera dhe vetëm vlera për ne, por edhe për ata që do të vinë, sepse Moikomi nuk di të ndalet, sfidon mbi gjithçka dhe troket në hapësirë.

Ai ishte një univers qiellor që patëm fatin ta kishim pranë, ta dëgjonim e të mësonim prej tij.

Ai ishte dhe mbetet një libër i hapur, që do të shfletohet tej kohëve!

Dritë emrit të tij!

Mbi romanin "Mos harro të më kujtosh" të Liridon Mulajt

KUJTESA, MASA E DASHURISË PËR TË AFËRMIN

Nga Oana Glasu

Isha bërë admiruese e Liridonit duke lexuar poezitë e tij, pastaj pjesë nga shkrimet e tij të ndryshme, të botuara në revista letrare, kurse tani, ai arriti të më pushtojë tërësisht me romanin e tij të fundit „Mos harro të më kujtosh", si nga shkrimi: i rrjedhshëm, elegant, i mbushur me melankoli kumbuese, ashtu dhe nga tematika. Megjithëse mund të krijojë përshtypjen e një ditari që në rreshtat e parë, duke pasur parasysh përdorimin e vetës së parë, por sidomos përshkrimin e vetë qenies së tij, në fakt kemi të bëjmë me një roman. Autori i ri ndërton një histori shqetësuese, emocionuese dhe aktuale për vetminë e njeriut, një i burgosur në vetveten e tij, peng në trupin e tij dhe thellësitë e dashurisë. Një epikë që me shikimin e parë mund të duket e thjeshtë: Tadori, personazhi kryesor, personazhi narrator i bllokuar brenda vëzhgon atë që po ndodh jashtë, kujton të kaluarën, kërkon të shkëpusë kuptimet e asaj që ka ndodhur, por veçanërisht për të rirregulluar këto fakte në mënyrë që të gjejë një kuptim, duke qenë i dënuar në një kombinim i gjendjeve, të cilat Liridoni i riprodhon, i rrëfen shkëlqyeshëm, të fuqisë absolute dhe të pamundësisë absolute. Sigurisht, një ndërtim plot monolog dhe retorikë të brendshme, e cila në fund më dha përshtypjen e letrës më të bukur të hapur, gati testamentale, që Tadori – personazhi apo në realitet, autori - mund ta lërë. Gjërat natyrore, të cilat ndodhin në jetën e përditshme të gjithsecilit dhe mbi të cilat autori përqendrohet në nivelin e rrëfimit dhe jo të mësimeve të zhvillimit personal, duken si grimca të shkëputura nga e tëra dhe që bien si thërrime nga festa e një dite të pasur. Të cilën shumë prej nesh e jetojmë të shkujdesur, plot ngjarje që nuk u kemi kushtuar vëmendje në kohën e duhur. Më vonë, gjërat për të cilat nuk na intereson hakmerren, duke u kthyer nga ne me një efekt delikat bumerang, duke dashur të na tregojnë se kemi gabuar, se kemi gënjyer veten kur kemi zgjedhur të jemi sipërfaqësorë ose të përkëdhelur nga jeta. Nga një shportë me fruta të ndryshme, ne zgjedhim atë që na pëlqen, megjithëse disa prej tyre, duke qenë më të këqija, më të dobëta rrezikojnë të prishen. Pra, ne zgjedhim të tashmen. Por prishja e jetës del përmes kujtesës dhe na tregon se ajo që dikur e quanim lëvozhgë ishte në të vërtetë thelbi. Një lojë e vjetër midis dukjes dhe esencës, midis parëndësisë dhe domethënies. Për Tadorin, gëzimi dhe vuajtja janë argumente për kujtesën dhe prandaj i lejon asaj memories për ta sulmuar, kjo duke qenë dhe spiranca e vetme që e lidh atë në bregun e jetës. Ky lajtmotiv i nevojës për të mbajtur mend fiton, përmes aftësisë së ndërtimit ose përshkrimit në lidhje me imazhet ose personazhet e paktë të romanit, rolin e një subjekti, i një personazhi ne vetvete, i cili nga ana tjetër krijon imazhe unike, të papërsëritshme dhe të pathyeshme.

Specialiteti i Liridonit është ekzistenca e brishtë nga e cila ai arrin të ndërtojë fytyra të jashtëzakonshme. Jam absolutisht e bindur se përtej artit të trajtimit të elementeve të krijimit të trillimeve në roman, me qëllim largimin nga imazhet tepër personale që lënë një përshtypje autobiografike librit, ka shumë përvojë personale, të paktën në kushtet e përshkrimeve të hapësirave, ngjyrave, ndjenjave, ose si rrëfyes ose si vëzhgues. Gjurmët e këmbëve që i shkel në një moment sepse jeta të çon në hapësira të caktuara të përbashkëta si sprova, suksese ose dështime, janë aq të prekshme për autorin sa më jep përshtypjen se ky lloj libri i esencave të jetës mund të përfshihet në radhë të librave që na lexojnë neve, na lexojnë biografinë tonë, dhe jo ne ata. Prandaj kunji i këtij romani është më i thellë. Rrobat e hedhura andej-këndej në një fushë të gjerë kanë akoma ngjyrë, mbase edhe erë, për sa kohë që autori përpiqet me imagjinatë të rindërtojë disa prej fytyrave të brishta për të cilat po flisnim dhe që, natyrisht, dikush do të duhet t'i kujtojë edhe këto.

Veçanërisht më bëri përshtypje ndërhyrja e vetës së dytë në rrjedhën e monologut dhe rindërtimin e portretit të të dashurës, nënës së mundshme të ardhshme të një djali të palindur, nga kapitulli i pestë. Është, në fakt, deklarata më e bukur e dashurisë, e pathënë drejtpërdrejt dhe me kohë, por që më magjepsi nga thjeshtësia e paraqitjes së portretit femëror. Karakter i përbërë nga hezitime, heshtje dhe gjeste, heqje dorë ose mjegulla të shpirtit, pa qëndrueshmëri psikologjike dhe për këtë arsye është dhe tërheqëse. Në vetvete, kapitulli i pestë na ofron një meditim për dashurinë, por veçanërisht për lirinë. Në kuptimin e të mos varurit, të mos qenit i shtrënguar, të qenit në gjendje të zgjedhësh. Të paktën, në nivelin e kalimit të vijës imagjinare të konceptit.

Një roman i shkurtër, por i koncentruar, në kuptimin konciz, të cilit nuk i mungojnë temat kryesore të shoqërisë së sotme, të cilën Liridoni nuk e paraqet aspak në një letërsi eksperimentale, por si një projekt shumë më ambicioz. Gjerësisht, autori ndjek gjatë gjithë rrëfimit se si fantazitë vetëshkatërruese shndërrohen në forca krijuese të tekstit rrëfyes. I cili, në fund të fundit, si vdekja, ky tekst mbetet i heshtur. Origjinaliteti e veçon Liridonin nga shumë shkrimtarë të moshës së tij dhe, guxoj ta them, e diferencon nga ata edhe më me përvojë, të themi. Befasia e parë që ka lexuesi i këtij rrëfimi është pikërisht mungesa e tij e paramenduar si spektakël, si zhurmë. Narracion i thjeshtë, pa fishekzjarrë, shumë pak detaje intime (erotike), gjë që na tregon që nga fillimi se shënjestra e mesazhit është diku tjetër. Personazhi kryesor i këtij rrëfimi tërhiqet nga përvojat, ai i kërkon ato, hidhet në to për të parë kufijtë e imagjinatës. Vetë jeta e tij është përvoja themelore e rizbulimit të njeriut ose, ndoshta një ditë, e rigjenerimit të tij (Donald). Titujt e kapitujve janë, jo rastësisht, etapa në rrugën e jetës, piketa të një rruge hyrëse, fatkeqësisht e ndërprerë papritmas nga ajo që shoqëria përmes të metave ose indiferencës krijon në nivel të brendshëm tek individi, duke e rrëzuar atë, dhe këtu gjeta një indeksi stilistik i matur. Me një fjalë, në fillim të çdo kapitulli, kur diçka e re do të shfaqet, megjithëse foljet

përdoren në kohën e shkuar, kujtesa shndërron çdo ndjenjë në të tashmen. Që më vonë të ndërhyjnë: një dashuri, një takim me fat, një bamirësi, një ribashkim, një propozim për një punë. Duket sikur këto intervale, përmes tensionit të papritur që përfshijnë, azhornohen gjithmonë në historinë rrëfyese. Një aspekt shumë i rëndësishëm dhe i ndërtuar mirë i romanit është mungesa e ajrit justifikues (vetëjustifikues). Autori i jep personazhit mundësinë për të marr përsipër suksese ose dështime, njësoj domethënëse, si mundësi për reflektim për ne, lexuesit.

Fjalët kryesore, fjalët çelës të librit janë: harresa dhe kujtesa (në pasqyrë apo antagonizëm, antitezë), por mendoj se tema kryesore është faji. Faji i Tadorit për të qenit i ndryshëm, për besimin ose ndjekjen e ëndrrave të tij, për dashurinë, për dëshirën për t'u bërë baba, për leximin, për ndihmën, për shpëtimin apo mbështetjen, natyrisht në polin e kundërt, fajin për heqjen dorë, për të rënë në pasione, pastaj të vdesë në fund, i vrarë, por jo nga sëmundja, e cila, sado që do ta kishte gjunjëzuar ose përkulur shpinën, arrin të qëndrojë me ndërgjegjen e tij të drejtë deri në fund. Ky është një faj individual, por theksohet shumë mirë, megjithëse me shumë delikatesë, faji kolektiv. Ai i sistemit. Mesazhi testamentar, më pëlqen ta quaj, i autorit ka të bëjë me zgjimin e ndërgjegjes tonë dhe të atyre që na rrethojnë, me rritjen e vëmendjes ndaj problemeve të dikujt përreth nesh, me dozimin e ndjenjës së dashurisë për të afërmin, me zëvendësimin e ndjenjës së fajësimit me atë të altruizmit. Sigurisht, këto ndryshime të brendshme të njeriut duhet të përfitojnë nga mbështetja edukative që shoqëria, pjesë e së cilës jemi, mund ta ofrojë.

Libri është gjithashtu një mbrojtje, një mbështetje për depresionin, e konsideruar si sëmundja e shekullit, por që nuk ka të bëjë me sëmundjen si një patologji dhe trajtimet e saj mjekësore, por për gjendjen që mund të kalojë çdokush, por nga e cila mund të shpëtohet në kohë. Ata që lexojnë librin nuk do të harrojnë që tani e tutje të jenë të kujdesshëm rreth tyre. Ose, nëse hasin raste, ata do të kujtojnë se lexuan diku për këtë thirrje për njerëzimin, për të treguar dashuri të afërmit të tyre në situata të tilla, dashuri që shpëton para se të arrihet në degradim të gjendjes dhe për të cilën shpesh ndërhyn: „qe shumë vonë ". Në të njëjtën kohë, romani është një thirrje për jetën, e cila nuk është gjithmonë ajo që duam, e cila është e destinuar, e shkruar për ne që nga lindja ose shumë para se të lindesh, e cila ka ulje dhe ngritje, e cila të pengon të gëzosh dashurinë prindërore, të gëzosh qetësi, mirëqenie, mure të pastra dhe të thata, apo shëndet, por që ia vlen të jetosh, sepse në të gjitha këto relativitete, në fakt, mëson se siguria e saj e vetme është Vdekja! Dhe ajo mbetet e pandryshueshme! Asgjë nuk mungon, siç mund ta shihni, nga romani.

Duhet theksuar gjithashtu se romani imponon kadencën e tij. Duhet të futemi në ritmin specifik të kësaj frymëmarrje të ngadaltë të gjërave për të kuptuar. Kemi të bëjmë me një slow novel, nga ky këndvështrim, i cili përpiqet të edukojë shqisat tona, por edhe të gjejë një rrugëdalje nga agjitacioni pa horizont për të lexuar ngadaltë kuptimet e njerëzimit, gjërave, shpirtrave. Një ushtrim që e mëson lexuesin të akordojë zemrën dhe mendimet e tij. Harresa intensifikon esencat, aromat e fshehura të gjërave. Por kjo botë e zhytur në harresë është e shpëtuar sepse mund të tregohet, të rrëfehet. Këtë botë e shpëton bukuria.

Nëse kujdeseni për shokun tuaj, mos harroni ta kujtoni atë! Nëse vlerësoni njerëzit, pavarësisht nga shkalla e rezervave të fshehura në lidhje me vlerën e tyre, përpiquni t'i ndihmoni ata të kthjellojnë mendjen e tyre, edhe nëse nuk tregojnë entuziazëm, edhe nëse ndonjëherë ata do të rezistonin përmes përtacisë, vetë-braktisjes, vetëvlerësimit të ulët, injoranca ose mosbesimi i tyre. Pasi të jenë të qartë në mendjen e tyre (të trazuar nga pakënaqësia, alkooli ose depresioni) ata do të jenë në gjendje të vlerësojnë përkushtimin, kujdesin, vëmendjen tuaj. Gjëra të thjeshta që duhet të ndodhin në çdo shoqëri, madje edhe në ato që bien në duart e mendjeve fatale. Fatkeqësisht, ka shoqëri që kanë nevojë për terapeutë socialë dhe për më shumë kohë shërimi, por edhe kështu, në nivelin e secilës prej tyre ekziston një kategori e çuditshme e njerëzve që mund të sjellin ndryshime. Të ndryshojnë mendime, paradigma, dogma. Këta njerëz janë ndoshta më të urryerit, ata adhurojnë një Zot të vetëm me shumë fytyra, dhe ai quhet Ide. Ata gjithmonë duket se vijnë nga një kohë tjetër ose paralajmërojnë kohë të tjera dhe nëse janë të rinj, madje ngjallin dhe pak zili. Ato janë speciet më të brishta të shoqërive, ende në tranzicion dhe quhen Intelektualë. E them këtë në përgjithësi, por njëri prej këtyre intelektualëve modernë është Liridoni, për të cilin kënaqësia e të menduarit, e të ndjerit të funksionimit të mendjes është një dehje e lehtë, pa pasoja fiziologjike. Dhe kush e jeton këtë dehje superiore nuk mund të ndahet më prej saj.

Më në fund, duke lexuar Liridonin, doja të dija jo vetëm kush ishte ai, por të zbuloja, duke e shikuar, kush isha unë.

KËNDVËSHTRIM PËRMES MESAZHEVE, PERSONAZHEVE FICTION APO REAL NË VEPRAT E RIDVAN DIBRËS

Nga Valbona Bërdica
Drejtore e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës

3587
Natyrisht që një shkrimtar
Funksionon si çdo individ tjetër.
Me të njëjtin mekanizëm.
Veçse ka do ingranazhe tepër
(here-herë të panevojshëm)
që ia ndërlikojnë jo pak ekzistencën.
Rd.

Duke lexuar veprat e Dibrës dhe duke pare se së shumti është vetë ai personazh, Ridi, Rd.apo Ridvan Dibra, vëndet ku zhvillohen ngjarjet janë në "Egobokë"dhe "Vegimland", dhe siç thekson ai tek **"Plagët e Moisiut"**"Dituria jone nuk eshte gje tjeter veçse korigjim i gabimeve të bëra dikur" , na kredhë në idenë se ndoshta gjithçka këtu është një përmbledhje e sukseseve, dështimeve, përjetimeve të jetës së tij , dhe gjithë këtë material jetik ai e kthen në një gjuhë të bukur arti. Pikërisht ndaj kësaj gjuhe tek romani **"Gjumi mbi borë"** autori i kërkon lexuesit t'i kushtojë pak vëmendje, pasi siç thotë ai aty ka derdhur shumë mund e energji. Gjithashtu jo pak vënd në këto vepra zë edhe loja imagjinare e shfaqur nëpërmjet personazheve apo karaktereve që nuk janë të shumtë në numër, por siç vetë autori thekson në një intervistë: nëpërmjet tyre është rrekur të bëj një prozë : drejt thellësive e mistereve të qënies.

Nëpërmjet personazhit të Alfredit tek romani **"Nudo"** kuptojmë se ai kërkon admirimin e të tjerëve ngaqë shumica nuk e don, dhe nuk e don sepse nuk e kuptojnë as atë dhe as artin e tij. Por ai nuk mundet e as nuk dëshiron të jetë tjetër dhe aq më pak që Artin e tij ta bëjë ndryshe.

"Ai ishte i admiruar prej të gjithëve: e prekte adhurimin e tyre. Me qindar autografë lëshoi gjatë këtyre ditëve: ai po kthehej në mit, në perëndi, dhe për një perëndi nuk ka asgjë të pamundur…Ai, tashmë e ndjente se nuk i përkiste vetvetes, ose i përkiste fare pak. Ai ishte bërë idhulli i asaj turme…Kishte qenë një fjalim i mrekullueshëm: disi eterik, i patrajtë, një shpërthim i beftë i pavetëdijes".

Gjithashtu Dibra nëpërmjet rrëfimit të tij lë të kuptojë se njeriu dhe marrëdhënia e tij me botën që e rrethon është gjithmonë në kufirin e një krisje, ndoshta edhe në kapërcim të vetes. *"Tha me vete thelbi i çdo njeriu ruhet në pavetëdije, i pëlqeu ky mendim…E vazhdoi arsyetimin, duke shtuar se vetëdija ishte guaska që lëmohet, ndryshon, përpunohet, përshtatet e, pse jo, edhe thyhet në vartësi të kushteve dhe rrethanave në të cilat ndodhet njeriu. Një guackë e fortë e ruan thelbin. Në të kundërtën…"*

Edhe në veprat e më vonëshme të autorit do të gjejmë përsëri në qëndër të tyre përvojën jetësore, dhe telat e tendosur mbi të cilët siç ai vetë shprehet duhet të ecë një shkrimtar. *Rrugëtimi është një ekuilibër delikat mes kulturës dhe ndjeshmërisë, "egos" për emër të madh dhe ndershmërisë krijuese; kërkesave të kohës dhe "artit të pakohë"; mes shkëlqimit dhe "territ të urithit"; mes "idhujve" që duhen ndjekur dhe atyre që duhen shuar; mes heshtjes dashakeqëse e të qëllimtë dhe duartrokitjeve naive; mes miqve të vërtetë e të rremë dhe armiqve të bekuar; mes ankthit të pritjes së gjatë dhe durimit që sheh larg në kohë; mes dyshimeve për kotësinë e punës tënde dhe të kundërtën; mes shpërblimeve të merituara dhe atyre aspak të merituara.*

"Edhe pse tashmë, falë dhe njëfarë emri që gëzoj, e kam thuajse të sigurt botimin. Siç është më se normale që në të gjitha këto raste, pritjesh e botimesh, të më bien ndërmend tri vjershat e para dhe gjithçka tjetër që ndodhi pas botimit të tyre". **Kështu do të shprehet Dibra në librin "Në kërkim të fëmijës së humbur" duke na lërë të kuptojmë se ndjesia dhe emocioni i artistit nuk ndryshon me kalimin e viteve, biles nganjëherë ka nevojë për emocionin e pastër e të "panjollosur" të fëmijërisë.**

"Nganjëherë, mendjet më brilante dhe inteligjente nuk shkëlqejnë në testet e standartizuara sepse ato nuk kanë mendje të standartizuara". – Diane Ravitch-

Në fakt kështu ka vepruar edhe Dibra me stilin e tij të narratives, duke mos ndjekur korrnizat standarte të cilat duket se ishin një kurth për të. Duke vendosur realitetin si bazë të veprave, maskimin e këtij realiteti me mjeshtri me qëllim ndoshta për ta bërë lexuesin më kureshtar apo hamendësues, pastaj zbehjen e reales për t'u kthyer sinqerisht tek vetvetja, nihilizmin për ata që e "shpërfillën", nuk e kuptuan apo e luftuan, kalimin tek hiper-realja në bashkjetesë me kafshën, me atë kafshë që është brënda njeriut, Dibra e dinte që arti të cilin ai po ndërtonte ishte në një distance kilometrash larg me mendësinë e shoqërisë shqiptare. E megjithatë ai ishte i bindur dhe i qetë, edhe pse për hirë të së vërtetës shumë herë i "luftuar" apo i "mënjanuar" me qëllim, se arti i tij është i bukur e do të kishte vendin e tij të merituar dhe pse jo edhe si model për të tjerët.

Pyetjes "hamendësimit" nëse ky art do të jetë apo jo i përhershëm, Dibra i përgjigjet në mënyrë të tërthortë në "mendimin" e tij me nr.3583:

Përcaktimi "shkrimtar i sukseshëm" ose jo, i vë autorët në korsitë e një gare atletike.

Ndërkohë që Letërsia është një "maratonë", e cila zgjat edhe pas vdekjes së shkrimtarit.

Duke na lënë kështu të kuptojmë se arti i një kohe të caktuar nuk është i përjetshëm, e rëndësishme është që ai të kuptohet dhe të pëlqehet nga njerëzit e kohës. Njerëzit që do vinë më pas do krijojnë artin e tyre dhe historinë e atij arti. E kjo do vazhdojë pa fund…

"Sexonic ose Sesilja",tek Parafjalë e Autorit, Dibra na lë të kuptojmë se ai beson dhe shpreh se në **gjithçka** që **ndodh** vetëm **një herë** është frymëzimi i ashtuquajtur **"hyjnor"**, dhe gjithçka tjetër si **letërsia**, **dashuria**, **zemra** apo **forma** është **një lojë**. Një lojë që vetë ai njeriu i Egobokës luan, luan pse e dëshiron ta luaj apo edhe pse ndoshta është i detyruar. Dhe e gjitha kjo ndërtohet në formën e një fjalë kryqi:

1.**NJË HERË**,*vetëm një herë i dorëzohesh frymëzimit të ashtuquajtur "hyjnor". Mandej* ***Lëtërsia*** *kthehet në "lojë",* ***"lojë"*** *me veten dhe me të tjerët. Kështu ndodh edhe* ***me dashurinë.***

2.**GJITHÇKA** *në Universin tonë ekziston falë një simetrie të përkryer. Simetri që da ta kishte edhe trupi i njeriut, nëse diku në anën e majtë do t'i mungonte diçka e vogël. Fjala është* ***për zemrën.***

*3.**NDODH*** të rrëzohen e të bastardohen gjithë kultet e mitet, ashtu siç mund të ndodhë të vihet në dyshim gjithçka. Në raste të tilla është fort e rëndësishme ***t'i besosh dikujt****. E pse jo,* ***Formës****?*

Një herë gjithçka mundet me ndodh, e zemrën mund t'ia besosh dikujt.

Atëherë, Dashuria ashtu si edhe Letërsia merr Formë e kthehet në një Lojë.

Në fakt kjo lojë e njeriut, njeriut pa arsye, pa ndnjenjë, njeriut dashakeqës, kishte qenë aty e pranishme edhe tek "Triumfi i Gjergj Elez Alisë":

…Mjerë ai fëmijë që do të joshet nga kthjethtësia e pazakontë e Përroit të Thatë dhe do të guxojë të zhytet në ujrat e tij. Përroi i thatë nuk është ai që është. Ai sot bën sikur. Rrallëherë sillet kështu Përroi i Thatë. Kurse njerëzit shpesh. Thuajse përherë. Vështirë ta dish se kur janë ata që janë. Përherë luajnë. Kujtojnë se me të tjerët, por më shumë me veten e tyre. I kthjellti luan të turbulltin. I turbullti të kthjelltin. Vetëm budallejtë nuk luajnë. Sepse nuk dine.

Dibra tek "Plagët e Moisiut, duket se veten e vendos tek njeriu, tek ai njeri që është i ndërgjegjshëm, i vetkorigjueshëm, si dhe dhe tek njeriu që është në gjendje të bëjë paqe me veten për gjithë atë kohë që nuk u kuptua dhe ndoshta edhe u keq interpretua për stilin e tij:

"Dituria jone nuk eshte gje tjeter veçse korigjim i gabimeve te bera dikur".

Ishte jeta ne fillim
Vdekja erdhi fill pas.
Kur zotat bejne lufte mes tyre
Njeriu duhet te beje paqe me veten,

Për ta vazhduar këtë ide tek "Triumfi i Gjergj Elez Alisë",

…Një Egobokas i vërtetë kurrë s'kërkon të falur", thoshte Babai im, ndjesë pastë.

…Unë e urreja luftën!

Heshturazi, Brenda vetes, pa guxuar t'ia pohoja ndokujt tjetër. Edhe fëmijë, u shmangesha lojrave që imitonin luftërat e të rriturve, të vetmet lodra me të cilat argëtoheshin bashkëmoshatarët e mi në Egobokë.

…Unë thjesht kam dëshirë, kam nevojë të shkruaj. Dhe do të shkruaj deri në çastin e mbramë.

"Pse shkruan?"
"Shkruaj jetën time"
"Atë që këndojnë edhe rapsodët?"
"Jo, Tjetrën. Atë të vërtetën".

Në dorëshkrimin, 2009-2015, Dibra "thuri" 33 mendime:

MBI NDJESHMËRINË

Në numrin 1. [i drejtohet Zotit me një lutje për të falur ato që s'dinë çfarë bëjnë prandaj edhe nuk përgjigjen për çka bëjnë. E shprehur me ironi deri në sarkazëm] :

Fali, Zoti im,
Se janë të ndjeshëm
dhe s'përgjigjen për çka bëjnë.

Duke vazhduar me porosinë nr. 6, [për ato që janë të pandjeshëm]:

Një jetë me porosinë:
Ujitni gjithë lulet,
por jo atë të ndjeshmërisë.

Numri 15. [Dilema ndërmjet lidhjes inteligjencë dhe ndjeshmëri]:

Dilemë e përjetshme:
Ndjeshmdjeshmëri inteligjente
a inteligjencë e ndjeshme?

Mbyllja me numrin 33. [Apokalipsi, që do të pushtojë botën do të jetë nga papërgjegjshmëria, apo pa ndjeshmëria]:

Apokalipsi s'është gjë tjetër
veçse bjerrja e plotë e ndjeshmërisë.

E në fakt k'të mosndjeshmëri të qënies njerzore apo atë çfarë e shkakton k'të ndjeshmëri autori e ka kuptuar dhe trajtuar që nga romani "Stina e Ujkut", ku që në pjesën e parë jo më kot të titulluar PRANIMI ai jep një këshillë në dukje kontraverse, por në fakt s'është gjë tjetër veçse një dualizim apo ndoshta edhe

asimetri e ndjeshmërisë, egos, gjendjes shpirtërore të bashkjetesës:

" Dëgjoni, miku im! Mos kërkoni ta vrisni bishën. As ta llastoni. Thjesht duhet ta pranoni atë...",

për të vazhduar:

..."A s'është egoizëm dëshira e paprajshme për t'u ndier i ngopur?"

"Për njeriun po, por jo për bishën.

"Pse jo për ty?"

"Sepse bisha kurrë nuk është e nginjur. Edhe kur bën si e tillë".

"Domethënë kur shtiret?"

"Thashë "bën sikur" dhe jo "shtiret".

"Janë e njëjta gjë".

"Jo: bisha nuk shtiret kurrë", tha Ujku.

"Po atëherë kush bën sikur?", tha Njeriu.

"Njeriu brenda bishës"

"Budallallëqe: një bishë është vetëm bishë"

"Aq sa njeri është vetëm njeri".

"Jo, njeriu është diçka më shumë se vetja".

"Domethënë ka edhe bishën Brenda vetes?"

"Pikërisht".

"Dashurite e virgjëreshës Madalenë" [e këtu ai personazhi dëshiron të jetë ai dhe vetëm ai]

Madalena flokëkuqja mos ndoshta nuk është askush tjetër veçse vetë ai i cili shpreh të gjithë revolten ndaj rregullave strikte të kohës, që e banën me dashtë, me vepru i diktuar nga vetë ato rregullat dhe jo sipas asaj që ai ka ndi vetë. I kthyer në një cinik urren veten pse nuk diti të vlerësojë studenten kur ajo ishte në auditor, që nuk e kishte kuptu me kohë se ajo po i jepte mundësinë "m'u kthy në jetë", se opininonet e të tjerëve mbeteshin njësoj të liga edhe pse ti mundohesh me ndjek rregullat e shoqërisë. Në fund, në promovimin e librit "është ndoshta vetë" autori që kërkon në sallë studenten e tij për ti dhënë opinionin për librin e tij dhe jo e kundërta. Të duket se Dibra arrin të bashkojë në një, veten e tij me personazhin që nuk mundet me e pasë në realitet por vetëm artistikisht.

"Dekalogu i Turpit eSe". Epilogu

Kam marrë Rrugën e Kthimit. Druhem ta pohoj (pohime të tilla nuk janë në nderin e shkrimtarit bashkëkohor). porse një vel i hollë malli më ka mbështjellë të tërin. Mall për Shkodrën time dhe provincializmin e saj. Ose për diçka tjetër. Mall të cilin, për turpin tone!, kemi turp t'ia pohojmë vetes. Sidomos të tjerëve. Mall për të thjeshtën. Të vërtetën. Të pabujën. Thelbin. Qe, ndoshta, ruhet ndokund i pacënuar. ("Më lini në strehëzen time të qetë/ të qesh me botën budallaqe". Varg i një poeti Frankofon, në përkthimin e kolegut tim NO. Shënim i imi. Rd.).

Diku nga fundi i Rrugës, tamam aty ku "zhduket Buena nen nji kodër, zhduket Drini nen nji mal", kujtohem për trastën me librat e mi: i kam harruar në Metropol, te kazani i hedhurinave. Trishtohem. Por vetëm për pak çaste. Sepse (ashtu si përherë) e ngushëlloj veten: ndoshta, falë një rastësie fatlume, atë trastë e gjen ndonjëri prej lexuesve të mi.

Ndihem i drobitur. Mbyll sytë dhe dremis.

Vëllimi "Djalit larg" i Mimoza Pulajt

ÇELESAT E NJË POEZIE

Nga Jolanda Cmeta

Vetëm para tridhjetë a dyzetë vjetësh në Shqipëri, poet hermetik ishte baraz me heretik. Sot një poet hermetik është vetëm një zë në një kor të gjërë zërash meqenëse dy nga prirjet kryesore të poezisë bashkëkohore janë hermetizmi dhe pas- hermetizmi. Mimoza Pulaj është një poeteshë hermetike.

Po a është e aftë të këndojë solo?

Po ndalemi në vëllimin e saj dygjuhësh " Djalit larg". Eshtë ditari lirik i një nëne që komunikon me të birin nga i cili e ndan një largësi gjeografike, po e bashkon nje afërsi shpirtërore.

Te çdo poet fshihet një prind se midis veprës dhe krijuesit të saj ka marrëdhenie prind – fëmijë. Po ndofta poeteshat mund të ecin me hap më të sigurt në këtë shteg se vetëm ato e përjetojnë fizikisht dhe shpirtërisht të qenit nënë.

Një poet i vërtetë mund të depërtojë në ndjenjat e gruas dhe në veçanti të gruas – nënë.

Anasjelltas një poeteshë mund të depërtojë me anë të fantazisë në ndjenjat e një burri.

Megjithatë gratë - poetesha e njohin më mirë këtë zonë ndjenjash. Në krahasim me burrat ato u ngjajnë atyre qenieve që mund të perceptojnë rrezet infra të kuqe apo ultraviolete të ndaluara për njerëzit.

"Djalit larg" është një himn për amësinë. Eshte shkruar për të gjitha nënat e sotme që e përjetojnë me dhimbje ndarjen nga fëmijët.

Ato e kanë përjetuar ndarjen e tyre nga fëmijët që në çastin që i sollën në jetë duke i shkëputur nga trupi i tyre. U shkëputën prej tyre me dhimbje të mprehta per t'ua dorëzuar dritës, pra, jetës.

Më vonë do të përjetojnë ndarjen tjetër të dhimbshme per t'ua dorëzuar së ardhmes që do të jetë vetëm e tyrja.

Mimoza me ndjeshmërinë e veçantë të një poeteje shkruan për këtë ndarje me mall, dhimbje, po edhe krenari. Ajo ndërton me gjakun e mendimit dhe të zemrës si në flijimet e dikurshme, një urë vargjesh që të ngrihet mbi oqeann dhe të çojë te "djali larg".

Tërë vëllimi i saj është një dialog nënë – bir. Ky vëllim ka një kod të veçantë që i biri do të mund ta dëshifrojë përmes lenteve magjike të zemrës.

Po lexuesit (dhe natyrisht kritikut) i duhen çelësa te veçantë fjalësorë për të hyrë në botën poetike të vëllimit. Po të shprehemi me gjuhën e teknologjisë "password".

Ekzistojnë disa fjalë çelësa për t'u futur në vëllimin e Mimozës, i errët në dukje, si errësira e barkut të nënës kur mban fëmijën, si qielli kur është i largët, si deti kur është i thellë.

Të përpiqemi t'i gjejmë.

Dy të tilla janë, pa dyshim anija dhe treni, mjete për udhëtimin që do ta çojë autoren te djali. Janë mjete konkrete fizike, po shndërrohen në metafora dhe identifikohen, herë me nënën, herë me djalin, dy udhëtarë që janë shkëputur nga toka e tyre e lindjes dhe ecin nëpër planet. Ecin per t'u larguar nga njëri – tjetri, po edhe per t'u ribashkuar.

Një fjalë tjetër çelës i vëllimit është dielli, i binjakëzuar me agimin. Një tjetër fjalë është një metaforë – simbol tipikisht shqiptare, shqiponja.

Fjala tjetër çelës është deti, një imazh ky relativisht i rrallë në poezinë shqiptare, po tepër kuptimplotë për poetët emigrantë se është simbol si i lirisë së dëshiruar, po të paarritur dhe gjithashtu i bashkimit me vendlindjen.

Jo më kot kritikët përfaqësues së metodës psikanalitike shikonin tek deti simbolin e amësisë.

Deti te poezia e Mimozës ka të tërë kuptimet e përdorura më lart.

A është Mimoza një poete metaforash?

Pa dyshim. Dhe jo vetëm e metaforave të thjeshta. E metaforave të ndërtuara me dy gjymtyrë dhe tre gjymtyrë si në poezinë orientale që për çudi ka rifilluar të ndikojë në poezinë tonë si dikur në poezinë e Rilindjes:

Hartë valësh, pëlhurë e universit, breshëri drite, shiu i shpirtit, petëlat e diellit, diell prej balte të purpurt. (Kjo metaforë e trefishtë e fundit është në kah negativ, duke përfaqësuar vlerat e rreme në të cilat besonin dikur shqiptarët).

Në këtë vëllim ka dhe figura jo të zakonshme nga ato që shkrijnë fusha të ndryshme perceptimi, afrojnë me njëra – tjetrën fjalë që i kundërvihen njëra – tjetrës, oksimore dhe sinestezi: të gjelbër shprese, kaçurrela të kaltra, ëndrra të drunjta, dritë balte, ferr i ftohtë, të vdekur – të gjallë.

Ka edhe epitete kuptimplotë siç i shohim te : vargje të pafajshëm, gjelbërues, puthje të ëmbla, të pamëshirshme, vullkan flakërues, ndonjë prej tyre epitet kompozitë si i verdhë kaltërosh.

Megjithatë për poezinë e Mimozës s'janë të largëta detajet e jetës së përditshme, nga e kaluara ne vendlindje dhe nga qytetet e huaja që janë bërë prej vitesh shtëpi dhe strehë për të.

Luleshqerrat që asaj i sillte djali i vogël, kuverta që rrëshqet nga shtrati i zbrazët, tingëllima e ziles, shenja të vogla kujdesi, dashurie e malli.

Ballkoni i vjetër në Milano, kumbulla e vjetër, biskotat dhe karamelet që ofron mamaja në bazë të mikpritjes shqiptare.

Poezia e Mimozës përçon një mesazh dashurie, për birin e saj sigurisht, po edhe per ata që i kanë shprehur solidaritet në dhe të huaj, për tërë njerëzit që vuajnë, po luftojnë dhe shpresojnë për një botë më të mirë. Edhe poetesha e ka rritur të birin për një botë të tillë, prandaj me dashurinë ndërthuret edhe urrejtja për të keqen, mbi të gjitha për luftën, e cila shihet në syrin e nënës, ashtu siç e shihte dikur me naivitet një poeteshë arbëreshe, poetja e parë shqiptare, Maria Antonia Baile, po më me vetëdije (Tokë e përgjumur).

Syri i poeteshës fundoset thellë në rrënjët e së keqes. Ajo e sheh "mbretin lek si sundues të "pasioneve të egra" (Një penel periferie).

Poezia e Mimozës ka antiteza. Në Shqipërinë e dikurshme që jeton përmes përfytyrimit të heroinës lirike shohim "forma të shqyera", " të detyruara të marshonin të lumtur". Po edhe në Amerikën demokratike që e ka strehuar djalin e poeteshës, përballë Statujës së Lirisë shohim bishën e vjetër, ujkun e fshehur në thellësi të shpirtit të njeriut që shprehet në proverbin e lashtë "Homo homini lupus".

Mimoza ka zgjedhur për metrikën e vëllimit vargun e lirë për të shprehur lirinë e mendimit të saj dhe të shpërthimit të ndjenjave të saj, larg skemave dhe tabuve tradicionale: jo për të refuzuar në mënyrë kapriçoze displinën që do t'i jepte vargut të saj ritmi e rima.

Ajo ka qenë e vetëdijshme që refuzonte disa mundësira për ta shtuar muzikalitetin e poezisë së saj ose për të komunikuar më lehtë me lexuesin, po s' ka dashur tjetër muzikalitet veç ritmit të vetvetishëm dallgëzues të mendimeve dhe të ndjenjave që mund të shprehin, herë ëmbëlsi, herë ashpërsi. Ketë muzikalitet vargu i saj e ka. Mimoza tregohet e guximshme edhe në drejtshkrim, jo me arbitraritetin e futuristëve, po duke manovruar me pikat, me presjet, me gërmat kapitale.

Poezisë së Mimozës nuk i mungojnë ngjyrat. Në radhë të parë ngjyrat antitetike të skajshme, bardhë e zi. Po poezia e saj nuk u ngjan fotografive të dikurshme. Ajo i ngjan më tepër pikturave, ndërthur të kaltrën, të gjelbrën, të kuqen.

"Djalit larg" është vëllimi i tretë i Mimoza Pulajt ku autorja shpreh pjekurinë e saj me zgjerimin e spektrit të poezisë së saj, me larminë e problematikës dhe të figuracionit, me konçizitetin dhe forcën shprehëse.

"Të lë një gjurmë të pashlyeshme" – a ka një gjurmë tonën në këtë botë të sotme? Mbi përmbledhjen me tregime të Zija Çelës "Thika pa gjak", botim i Onufrit dhe të esesë së Maruice Blanchot "From Dread to Language".

THIKAT" E ZIJA ÇELËS NË LOJËN E ARTIT

Nga Ballsor Hoxha

Çfarë ka mbetur nga letërsia sot? Dhe kjo pyetje të vjen në mendje pikërisht në leximin e një mrekullie si përmbledhja e tregimeve të Zija Çelës "thika pa gjak". Kjo mrekulli e gjendur përballë hiçit të Publikes që po vuan zhveshjen e Botës (si Publike po ashtu). Apo ta themi shkurtë, ç' po ndodh me letërsinë sot?

Letërsia është bërë vetëdije, vetëdijesim tejet i kthjelltë, i prekshëm dhe i zëshëm ndaj humbjes së ndërnjerëzores, ndaj këtij ankthi të hiçit.

Dhe në anën tjetër, Publikja, çdo gjë që është e turmës, është një ikje në galop nga po e njëjta, nga vetëdijesimi se qëniesojmë pikërisht sikur këta që jemi, e ajo që jemi është pikërisht ajo nga e cila po ikim.

A është e tëra një deziluzionim, apo jemi më afër ankthit të humbjes së gjurmës sonë në vetë botën tonë?

"Çdo gjë është brënda tekstit", thuhet në teorinë e dekonstruksionit dhe në poststrukturalizëm.

Po ashtu, sipas po të njëjtës, - gjurma – e origjinares, së – fshirë – në prezencë, është evidente në çdo tekst. Dhe më tutje, në të njëjtën, thuhet se në tekst është vetë autori, pa nevojë të dilet në Pozitivizëm dhe të kërkohet në autobiografi të tij.

Le ta marrim shembull tregimin "Përpara portës", ku prej tekstit vetë mund të arrijmë më tutje në gjakimin e autorit për të 'vazhduar' dashurinë dhe bashkëndjesinë për njeriun. Për të rilidhur të humburën e pakthyeshme dhe për të rigjetur të humburën.

Në të vërtetë, ajo që është – fshirë – nga prezenca, këtu shfaqet në – gjurmën – e origjinares së tekstit të Çelës, dhe në këtë shpërfaq në zinxhirë fenomene prej hapjes dhe të të paspërjetuarit të ankthit ekzistencial, rilidhjes së njeriut me njeriun dhe, në fund, empatinë e pashkatërrueshme që shkakton përjetimi i ankthit të përjetuar ekzistencial.

Kjo është pra pikënisja e tregimit të Zija Çelës.

Mirëpo ky punim ka të bëjë me përmbledhjen me tregime "Thika pa gjak" të autorit Zija Çela si diskutim me esenë e filozofit dhe zanafillës së post-strukralizmit Maurice Blanchot "Nga ankthi deri te gjuha" (From Dread to Language).

Ajo që bën letërsia, në tërë "çorodinë" e teorisë dhe të interpretuesve për vdekjen e autorit e për vdekjen e letërsisë është përvijimi i ndërnjerëzores dhe me këtë lënia e një shenje, një gjurme dhe një gjakimi - të cilin në përhershmëri e – fshin – prezenca/Publikja e cila ik prej pikërisht ankthit ekzistencial dhe empatisë së këtij teksti në fjalë. Prandaj këtu po i përballim, gjithnjë pa e shpaluar mrekullinë e teksteve/tekstit të Zija Çelës, përmbledhjen e tij me tregime, dhe saktësinë e filozofisë së Maurice Blanchot, e cila thotë pikërisht të kundërtën e kësaj "çorodie" teoretimesh dhe interpretimesh.

(Për të diskutuar këto dy tekste kemi vënë përballë citime nga kjo ese dhe shtjellimin e tekstit të Çelës.)

1. citimi i parë i Blanchot:

Një shkrimtar i cili shkruan "jam i vetmuar", apo sikur Rembo, "Jam me të vërtetë nga prapa varrit", mund të merret si komike. Është komike për njeriun që të njohë vetminë e vet, duke iu adresuar lexuesit dhe duke përdorur metoda që e ndalojnë po të njëjtin individ nga të qenit i vetmuar. Fjala i vetmuar *është e përgjithshme, po aq sa edhe fjala* bukë. *Të shprehurit e saj do të thotë të thërrasësh praninë e tërë asaj, që po e njëjta fjalë përjashton. Çka është e mjaftueshme që fjalët e bëjnë punën e tyre dhe me këtë e bëjnë letërsinë të pamundshme. "Unë" e shkrimtarit ka kuptim të thjeshtë (askush afër meje), gjë që përdorimi i gjuhës e kundërshton vetëm në dukje... Si mund të jetë një person i vetmuar, nëse ai na rrëfehet se është i vetmuar? Ai në të vërtetë na thërret për të na shmangur; ai argëtohet në ne për të na bindur se nuk është duke u argëtuar në ne; ai flet gjuhën e njerëzve në momentin kur më nuk ka për atë as gjuhë dhe as njeri. Është lehtë të besohet se ky person, i cili duhet të jetë i ndarë nga vetja përmes dëshpërimit, jo vetëm se e mban mendimin e ndonjë personi tjetër, por edhe përdor këtë vetmi për të krijuar një efekt që shkatërron po të njëjtën vetmi.* (Kjo është hyrja në esenë e Blanchot).

Kjo do të thotë, gjithnjë sipas Blanchot, se në të vërtetë gjuha e bën të pamundshme tërë ndërmarrjen totale dhe absolute të shkrimit, si kotësi përballë logjikës së saj.

Duke e parë më me kujdes tregimin e Zija Çelës hasim në tri elemente kyçe:

1. habia, qoftë filozofike qoftë fenomenologjike, posaçërisht e ndër-njerëzores.

2. paradoksi, si përmbysje e rrjedhës së vetëdijes së njeriut në një zgjidhje, të cilën e dikton vetë rastësia!

3. dhe empatia, si arritje e tjetrit, si motiv i të shkruarit.

Shembulli më i mirë këtu është tregimi "Thika pa gjak" në përmbledhjen me të njëjtin titull, dhe përfundimi i tregimit: "*Sa shumë thika të tilla, prej trazimesh të gjithfarshme, mban fshehur njerëzimi në zemrën e vet.*"

Në të vërtetë autori këtu, thënë më saktë teksti, zgjon, thërret përtej vetmisë së tij, tenton të ngjitet mbi estetikën dhe artin dhe fiksionin argëtues, në thirrje çlirimtare dhe thirrje përtej shpirtngushtësisë së njeriut.

Por kjo është dëshmia ekzakte e ankthit, ankthit që edhe zhbën çdo përpjekje për të thirrur e çdo përpjekje për të emëruar (Heidegger).

Dhe më tutje në këtë përballje, të esesë së Blanchot me tekstin e Çelës, vazhdon me sa vijon

2. citimi i dytë i esesë së Blanchot:

Sipas po së njëjtës ese, shkrimi është i ngjashëm me bixhozin, që fillon si lojë, por më tutje kalon në investim të realitetit në lojë, gjë e cila kalon nga loja në realitet. Kështu, nëse shkrimtari do të hedhë ndarjen e zareve të bixhozit për atë që shkruan, ai mund ta bëjë këtë duke investuar në atë tërë reflektimin, të njëjtin kërkim për gjuhën, përpjekjen e njëjtë të pafavorshme dhe të kotë të të shkruarit. Për shkrimtarin bixhozi është vetë të shkruarit, të shkruarit duke i bërë të dyja, edhe duke shndërruar mendjen e tij dhe po ashtu dhuntitë e tij në rastësi të vërtetë.

Tregimi i Zija Çelës është pikërisht mishërimi i çdo qelize të shkrimtarit përbrenda tekstit të tij, është edhe mendja edhe dhuntia e tij, jo vetëm si teknikë e të shkruarit, por sidomos duke përfshirë – empatinë – e tij si njeri.

Shkrimtari Zija Çela është një "kumarxhi" i pashërueshëm, i cili në tregimin e tij investon tërë atë që e ka dhe tërë atë që mund ta imagjinojë, vetëm e vetëm për të arritur në tjetrin, për të gjetur dhe shkundur e kthjelluar tjetrin. (Tregimet "Shuplaka e motrës"; "Banka e ankesave", etj)

Sidoqoftë, në këtë citat të dytë, Blanchot flet për ankthin e shkrimtarit, që është nën ndikimin e ankthit (ekzistencial, të vdekjes, etj), ankthit që neutralizon çdo përpjekje të tij dhe në këtë gjendje shkrimtari kërkon në





rastësinë për të gjetur një mundësi të shprehjes, qoftë të ankthit, qoftë të motivit të tij.

Mirëpo rastësia është vetë kumari, që nuk arrin asnjëherë të krijojë një gjuhë të veten, një rregull personal, duke qenë se i kthehet vetë gjuhës së origjinares.

3. Citimi i tretë i esesë së Blanchot:

Objekti i idealit të "fjalëve të çliruara" nuk është për të liruar këto fjalë nga të gjitha rregullat, por të lirohen ato nga rregulli të cilit personi nuk i bindet më, në mënyrë që i njëjti person t'i nënshtrojë ato ndaj një rregulli që e ndien vetvetiu. Ka një përpjekje që akti i të shkruarit të ketë shkakun e një stuhie të rregullit dhe të një paroksizmi (shpërthimi) të vetëdijes aq më shumë të plotësuar me ankth, për shkak se kjo vetëdije e organizimit të pagabimtë është gjithashtu vetëdija e një dështimi absolut të rregullit...

Kështu që, për të shpikur rregulla të reja, është jo më shumë se të shpikësh rregullat e vjetra; përkundrazi. Është më e vështirë të rizgjohet në gjuhën e zakonshme rregulli i cili është – fshirë – nga ai, për t'iu bindur shprehisë së njëjtë sikur thirrjeve të vetë reflektimit. Për t'i dhënë kuptim më të pastër fjalëve të fisit(origjinares), mund të jetë t'u japësh fjalëve kuptim të ri, por është po ashtu e njëjta gjë, që do të thotë t'u japësh fjalëve kuptimin e vjetër për t'ua dhuruar fjalëve kuptimin që e kanë, duke i ringjallur ashtu siç nuk kanë ndaluar së qeni.

Tregimi i Zija Çelës është pikërisht ajo që citohet më lart, është ambiguiteti i çlirimit të gjuhës nga zakonshmëria e saj dhe, në të njëjtën kohë, huazimi i gjuhës së "fisit" për të shprehur 'habinë' dhe empatinë e tij ndaj njerëzimit.

Që prej "*Ankthit të influencës*" e deri tek Umberto Eco, e të tjerë, të gjitha këto fenomene bashkëkohore, ato të dyzimit, ndërthurjes dhe të intertekstualitetit (postmodern) në të vërtetë janë huazime nga filozofia e Maurice Blanchot, janë po i njëjti ambiguitet i çlirimit të fjalës nga "logjika" e saj rrënuese, dhe të "huazimit" të gjuhës së "fisit" për të shpikur vetë rregullin e saj dhe të rregullit personal. (Këtu do të kishim cekur posaçërisht tekstin e tregimit "*Udhëtim në rrotullim*"; "*Banka e ankesave*"; "*Nëna e fluturuesit*".)

4. Citimi i katërt dhe fundi i esesë së Blanchot:

Çdo gjë në mendjen e shkrimtarit, për këtë arsye, përpiqet të jetë e domosdoshme si lidhje dhe vlerë e testuar; çdo gjë në kujtimin e shkrimtarit përpiqet të jetë kujtim i një gjuhe, e cila ende nuk është shpikur dhe të jetë shpikja e gjuhës që personi e kujton; për secilin operacion lidhet direkt një kuptim, dhe në këto operacione si grup, korrespondon ai kuptimi tjetër se nuk ka një kuptim të dalluar për asnjërin prej tyre; fjalët kanë kuptimin e tyre si zëvendësim për ide, por gjithashtu për një kompozicion të zërave dhe të një realiteti fizik; imazhet shënjojnë veten si imazhe, dhe mendimet pohojnë domosdonë e dyfishtë se bashkëshoqërojnë ato me shprehje të caktuara dhe i bëjnë këto mendime të mendimeve të tjera. Vetëm këtu shkrimtari mund të thotë se çdo gjë e shkruar ka, për shkrimtarin, kuptimin më të madh të mundshëm, por se ka edhe kuptimin e vet, i cili është kuptim i lidhur me rastësinë, e që është jokuptim. Natyrisht, duke qenë se vetëdija estetike është e vetëdijshme vetëm për një pjesë të asaj që bën, përpjekja për të arritur domosdonë absolute edhe permes kësaj, është kotësi absolute që është gjithëherë e kotë. Nuk mund të ketë sukses, dhe është kjo pamundësi e suksesit, të arritjes së fundit, që është e njëjta gjë sikur kurrë të mos ketë pasur sukses, çka e bën gjithëherë të mundshme. Gjë që mban pak kuptim nga fakti se kurrë nuk e pranon tërë kuptimin e saj dhe është i plotësuar me ankthin për shkak se nuk mund të jetë ankth i pastër.

Teksti i Zija Çelës është po ashtu në mes të rastësisë së gjuhës, rikujtimit të saj në "fisin" – origjinaren e saj, dhe të kuptimit që është kuptim dhe në të njëjtën kohë edhe jokuptim.

Ankthi për të cilin flet Blanchot, është cekur qysh në fillim, i lidhur me dy fenomene: "Logjikën" e gjuhës përballë të komunikuarit të "vetmisë" së tjetrit, dhe të ankthit i cili është paravetëdijes, paranjerëzor dhe primodrial, të cilin, sipas Blanchot, as nuk mund ta mishërojmë dhe as ta anashkalojmë në shkrim.

Por për këtë le t'i kthehemi tregimit "Përgjigjet e munguara":

A mundemi të shohim në tregimet e Zija Çelës origjinaren, pra 'vetminë e njeriut' dhe ikjen nga ajo





përmes 'zgjedhjes' së personazheve? Në të vërtetë, në veprën e Blanchot "Hapësira e Letërsisë", thuhet se shkrimtari për të ikur "nga kjo komike dhe nga kjo patetikë dhe asgjë e gjuhës", krijon 'Hapësirën' e letërsisë, duke e kaluar letërsinë nga "Unë jam i vetmuar", në "Ai është i vetmuar", pra duke e kaluar përjetimin dhe rrëfimin nga veta e parë në vetën e tretë. Gjë që e kalon origjinaren (sipas Post-strukturalizmit) në prezencë, dhe prezenca duke u kompleksuar në të gjitha kohët.

Kjo është evidente dhe më lehtë e kapshme përmes tregimeve "*Shkurre me lepuj*" dhe "*Timoni*", ku autori ka krijuar situatën. Në të parin, narratori në emër të tij personal prezanton letrën intime të një personazhi, ndërsa në të dytin kjo bëhet përmes një psikologu, për të cilin rrëfehet nga narratori dhe ku është një letër drejtuar po të njëjtit psikolog.

Në tregimin e parë është një rrëfim intim i një personazheje, e cila e lut narratorin ta bëjë publike letrën e saj. Kjo nuk është vetëm ikje nga komikja e asgjësë së letërsisë, kjo në të njëjtën kohë është edhe krijimi i hapësirës së letërsisë, marrje e territorit të saj dhe të thyerjes së kokëfortësisë së *logjikës së fjalëve*.

Aq më shumë në tregimin "*Timoni*" kjo bëhet në teknikë më klasike, teksa autori i padukshëm rrëfen për përvojën e një psikologu dhe "një të fejuare" që atij i ka dërguar letër. Por, megjithatë, hapësira e letërsisë është krejtësisht e përkufizuar, e prekshme dhe e kuptueshme.

Dhe pikërisht në hyjren e esesë së Blanchot është edhe vetë çelësi i leximit, si të tregimeve dhe të shkrimit të Zija Çelës, dhe po ashtu edhe të kësaj eseje: *Është lehtë të besohet se ky person, i cili duhet të jetë i ndarë nga vetja përmes dëshpërimit, jo vetëm se e mban mendimin e ndonjë personi tjetër, por edhe e përdor këtë vetmi për të krijuar një efekt që shkatërron po të njëjtën vetmi.*

Mirëpo kjo në të vërtetë thërret aporinë e ankthit të të shkruarit. Të shprehurit e ankthit edhe në kotësinë e të shkruarit për shkak të ankthit. Gjë që e vë në dualitet shkrimtarin edhe si ankth i mungesës së logjikës në zanatin e tij, por edhe si domosdoshmëri e të shkruarit. Në të vërtetë, sipas Blanchot, ekzistenca e shkrimtarit është dëshmia që brenda një individi gjenden edhe një i "çmendur" dhe një qenie e "arsyeshme".

Këtu, duke iu kthyer hyrjes së punimit, mbi thënien se "çdo gjë është brenda tekstit" dhe se "edhe autori është brenda tekstit", lehtë mund të vijmë në përafrimin e tekstit brenda vetes si ankth i ndër – njerëzores, ankth i zhveshjes së kuptimit dhe ankth i çlirimit të vetëdijes nga kuptimi, në njërën anë; dhe në anën tjetër, si ankth për rënien e shkrimit/shkrimtarit brenda Publikes, absorbimit të tij në të Pa-vërejtshmen e Publikes (Heidegger, Kierkegaard), dhe me këtë dyzimin e shkrimtarit përballë letërsisë, shkrimit, në një të "çmendur" dhe një të "arsyeshëm" brenda tekstit.

Eseja në fjalë në këtë punim, niset nga kotësia dhe aq më shumë njëlloj "abuzimi i vetmisë" së shkrimtarit, që kalon në kumar dhe "investim" të tërë vetes së tij në këtë domosdo, pastaj në ankth të gjetjes së gjuhës, e cila do të shprehte edhe ankthin e lartpërmendur, edhe ankthin primordial, por që e sjell shkrimin në kotësi dhe jokuptim; dhe deri tek gjetja e gjuhës në rrënimin e rregullit të saj, për ta rigjetur përmes po të njëjtit rrënim, sado në pamundësi për t'i ikur rregullit të "fisit".

Përballë, përmbledhja me tregime e Zija Çelës është në të vërtetë një lojë me këtë ambiguitet, herë e dalë haptas si shpallje e shkrimit dhe letërsisë si nevojë shpirtërore, qoftë në empatinë e saj, dhe qoftë në pandjeshmërinë e lojës postmoderne; dhe, së dyti, është pikërisht ankthi i të ndierit të vetëzbrazjes së ankthit, dhe po ashtu të gjithpërfshirjes së "Botës" si Publike nga ankthi, brenda dhe jashtë tij, në të brendshmen dhe në të jashtmen e tij.

Andaj, ç'është kjo "çmenduri" që e filozofon Blanchot dhe e hasim në çdo letërsi në absoluten e saj, dhe aq më shumë në 'luciditetin' e ZIja Çelës? A është kumti, apo "Kotësia" e kumtit, apo të dyja bashkë, të veshura me dhembjen e ekzistencës.

Sidoqoftë, duke mos shpaluar tërë mrekullinë e përmbajtjeve të prozës së autorit, tregimi i Zija Çelës është çelës dhe përballje me këtë 'hiç', ballë për ballë dhe haptas, që nëse e neutralizon ankthi i kudondodhshëm, së paku është ajo që e thotë ky tekst sublim në tregimin "Përpara portës":

"*Nëse më hapet dera për të kaluar, po nuk e pashë te pragu, do të kërkoj të kthehem dhe do t'i lutem Supremit Absolut të marrë tjetër vendim për mua. Jo, nuk mund ta pranoj parajsën, nëse nuk kam qenë në gjendje të lë gjurmë të pashlyeshme tek im bir.*"

DY TREGIME RETROSPEKTIVË

nga

Feride PAPLEKA

1. Kukulla

"Letërsia është një uzinë me kimera dhe makthe".
J. L. Borges

Kur isha e vogël, kisha mbledhur ca copëza kadifesh të mbetura nga një fustan që më patën qepur prindërit si dhuratë për Vitin e Ri. Ëndërroja shumë të bëja me to një kukull. Kukull të vërtetë si ato që shiten sot në treg ende s'kisha parë, por i kisha parë shoqes sime një kukull të bërë vetë. Edhe ajo mbase e kishte parë te dikush tjetër. Ku ta dish? Ideja për të sajuar këto hyjnesha të vogla mund të jetë shumë e lashtë, ndoshta, që nga koha e qytetërimit sumero-akadian.

Me copërat e kadifes të palosura e të vendosura në një kuti tualeti të vjetruar që e kisha gjetur midis sendeve të nusërisë të nënës sime, vajta te shtëpia e Lilit - kështu e quanin shoqen time. Kishim biseduar për kukullën një ditë më parë dhe mezi prisnim të bëheshim bashkë. Do të doja ta riprodhoja këtu atë bisedë të çuditshme, nga e cila zë fill kjo ngjarje, që duke e shkruar, më duket sikur e zbuloj, por më pengon harresa.

Shtëpia e Lilit ishte nga ato ndërtesat tip njëkatëshe, me bodrum poshtë, me një verandë të vogël përpara, rrethuar me gjithfarë lulesh. Në verandë hyje duke ngjitur katër- pesë shkallë, me parete borë të bardha, ngaqë mami i Lilit i lyente vazhdimisht me gëlqere. Për të qenë sa më rehat, ne shkuam në një kthinë pas shtëpisë, në të cilën futeshe ose nga një derë e brendshme në korridor ose nga jashtë, përmes një deriçke, që të nxirrte në kopsht. Aty në atë kthinë, mes asaj qetësie e ndieja veten gjithnjë të lirë. Ndoshta nga ajo liri fare e thjeshtë buronte ngazëllimi im i atyre çasteve. Shtëpia ime, ndryshe prej asaj kthine, ishte një apartament në një pallat dykatësh që sa futeshe brenda, kuptohet që do të mbyllje derën. Megjithëse isha dy pëllëmbë mbi dhe, kur kthehesha nga shtëpia e Lilit në apartamentin tonë, më dukej sikur më zihej fryma.

Iu vumë punës të dyja. Ishte një ditë pranvere nga ato që truri i ngulit në kujtesë për mos t'i harruar. Shushurima e gjetheve të pemëve më bën sot të përfytyroj ekstazën e analfabetëve kur dëgjonin vargje nga *Kantika e kantikave,* ndërsa zogjtë që përplasnin flatrat të dehur nga rrezet e diellit, më shtyjnë të mendoj se mbase kanë qenë pikërisht zogjtë që qëndruan dikur mbi supet e Francisko de Asizit.

Lëviznim duart të heshtura e tërë seriozitet, siç veprohet nga të rriturit për një porosi që duhet mbaruar. Pre, qep e shqep, deri sa kukulla mori formë. Ishte hera e parë që provoja të bëja një kukull. Më në fund i vendosa mbi flokët e sajuar prej një cope mëndafshi në ngjyrë të errët edhe diçka të shndritshme që shëmbëllente me një kapëse argjendi. Doli një kukull aq e përkryer, sa kur e vura përpara syve për ta soditur, m'u duk se diçka më pëshpëriti. Unë iu përgjigja me ca fjalë të ëmbla, shijen parajsore të të cilave e kam të gjallë si sot. Vonë, kur u bëra nënë, duke mbajtur foshnjën time në duar, kam menduar se këtë çast tashmë e kisha përjetuar.

Kishte kaluar thuajse gjysma e ditës, kur u ngrita për të ikur. Mamaja më kishte thirrur dy-tri herë nga dritarja e një dhome që binte në vijë të pjerrët me derën e pasme të kthinës, për t'u siguruar që s'isha larguar, sepse e dinte që kur s'luaja jashtë, isha atje, dhe më kishte lënë të mbaroja më nge kukullën.

U ndava me Lilin - edhe ajo ishte si e shtangur nga bukuria e kukullës - dhe me shpirt krejt të mrekulluar, vrapova për në shtëpi. Kukullën e mbaja në duar. Teksa po i afrohesha shtëpisë - largësia ishte a s'ishte pesëdhjetë metra - më kapi një ankth që papritur ma rrëmbeu tërë lumturinë. Kalimi i viteve ma ka zbehur rrethanën e kësaj ndjesie, por pushtetin shtypës të atij çasti e kam të gdhendur në tru si shenja fatale e yllit në të cilin kemi lindur. Ankthi u kthye në një llahtari aq tronditëse, sa për një grimë here u ndala, pa ditur ku isha e ç'po bëja. Edhe të kisha qenë Judita me kokën e prerë të Holofernit ndër duar, nuk do të nguroseshа ashtu. Jam përpjekur ta shpjegoj atë transformim të beftë të gjendjes time psikike dhe lëmshi i mendimeve përherë më ngatërrohet. Isha aq e vogël, robinë e mikrouniversit tim fëmijëror, ku lulëzonte një jetë e dëlirë si te të gjitha vajzat e asaj moshe! Por historia jonë nuk nis në ne! Prej ç'kohe e prej ç'grimce atomi, brofi nga gjaku im kompleksi se të mbash një kukull në duar, do të thotë të guxosh e të shkosh larg, të ngjitesh te e ardhmja jote e të shikosh pasqyrën tënde në fytyrën e një bebeje?! Është mendim tepër i çuditshëm për një çupëlinë që sapo ka mbushur pesë vjeçe. Unë as që e kisha menduar ndonjëherë këtë gjë, madje as se do të isha e rritur një ditë. Isha në moshën kur këto nocione nuk ekzistojnë, ngaqë fëmijët kanë një përfytyrim metafizik për kohën. Dikush tjetër që flinte në mua, pa dijeninë time befas u zgjua.

Shtyva derën e shtëpisë, me kukullën në njërën dorë, e zhveshur nga çdo lloj emocioni të gëzueshëm dhe hyra në korridor si hije. Kur pashë tim atë në këmbë, në mes të kuzhinës, e humba fare. Ai më thirri që të më puthte, siç bënte kur ndodhej në raste tepër të rralla ditën në shtëpi. Me dridhma në shpirt, pa vetëdije, unë u futa në dhomën e gjumit, e prisha me të shpejtë kukullën dhe si e çartallosur e hodha në një qoshe pas dollapit. Golemi im dergjej tani i zhbërë në mënyrën më mizore.

Fare e papërqendruar pastaj iu afrova babait. Zemra më rrihte aq fort, sa dëgjoja buçimat e saj në vesh e në tëmtha. Im atë u përkul në gjunjë, më mori pranë, më puthi sytë e më pa nga duart. "Ç'e bëre kukullën, shpirt?"- më pyeti. Unë e vështrova gjatë, pa mundur të nxirrja qoftë edhe një tingull. Dhe sytë m'u veshën nga dy pika të mëdha loti që rrinin gati për të rënë sa të ulja qepallat. "Vajza është e sëmurë", i tha ai mëmës që po përgatiste drekën. Duke më vënë dorën e tij të shtrenjtë mbi ballë, më ngriti hopa e më çoi në shtrat me pamje të trishtuar.

1995

*2. Prindërit**

-Më falni, e zënë është?

Ai tregoi me një lëvizje të dorës ndenjësen e lirë dhe priti përgjigjen me mirësjellje. I hollë e i gjatë, me sy të errët, të mëdhenj dhe flokë të zinj e të dendur, mund të mendoje se nuk ishte as njëzet vjeç. Kështu të krijonte ai përshtypjen edhe nga zëri i veçantë me një lloj tingulli të fortë që karakterizon djemtë e rinj, por vështrimin e kishte melankolik e të thellë si burrë.

Sapo dëgjoi "jo"- në, ai u largua me hap të nxituar dhe u duk përsëri. Para tij ecte një grua bardhoshe, e shëndetshme, disi trupmadhe, por me fytyrë të vogël e lëkurë të pastër si kristali; kishte në krahë një bebe. Aq e vogël ishte bebja, sa dukej si një bukurezë që është ndalur mbi një degë peme. Burri kishte hedhur në sup një çantë udhëtimi, por që me siguri peshonte pak, se e mbante shpinën drejt.

Te ndenjësja e lirë, ai diç i tha gruas dhe kaloi vetë i pari, shkoi në fund dhe qëndroi në këmbë, derisa ajo u ul ; pastaj u ul edhe vetë. Ashtu ulur, nxori nga çanta që pati lënë përtokë një pako që mesa duket kishte rroba për foshnjën. Ajo e mbajti beben hopa te gjunjët, duke i buzëqeshur e duke e ledhatuar. Ai lëmsh i kuqërremtë, u lumturua dhe lëvizi këmbë e duar tërë energji. Goja e vogël, që megjithëse ishte pa dhëmbë, ngjante si një kurorëz e trëndafiltë dhe ai vetë si një engjëll që ka zbritur përkohësisht në tokë. Burri mori batanijen e pambuktë në gjurin e gruas, e palosi me kujdes dhe e shtroi mbi ndenjëse, por me lëvizje të matura. Gruaja i bënte çilimiut ca shenja me sy që vetëm ai i kuptonte dhe shkrihej në të qeshura, pastaj e mbështeti beben në kraharor dhe me një dorë e kontrolloi edhe njëherë shtrojën. Mbi të vuri një mbajtëse bebesh. Qe një gjë e bukur, prej fanellate të bardhë, e rrahur lehtë me makinë, në formën e një xhepi të madh. E futën beben brenda. Siç duket mbajtësja ishte verore, se këmbkat dhe doçkat e tij rrinin jashtë dhe filluan të tundeshin në ajër si dy lodra të gjalla. Nga të dyja anët mbajtësja kishte fjongo të bardha mëndafshi, pala-pala. Mund të mendoje se në ndenjëse kishte mbirë një ngastër me lulebore të çelura. Gruaja i vuri bebes edhe një nënkresë të butë dhe nisi ta përkundte ngadalë, duke e cekur me majat e gishtave në mjekër e duke i buzëqeshur ëmbëlsisht. Ndërsa burri përsëriste gjestet e gruas dhe ia lëmonte kokën bebes me lëvizje të lehta. Bebja u kthye nga ai dhe ia nguli sytë. I kishte bojë hiri, por të mëdhenj, rrethuar me qerpikë të zinj. Burri dhe fëmija ngjanin si dy pika uji. Aty e merrje vesh që ai ishte i ati. Udhëtari tjetër iku dhe për fat në hyrje të kabinës, nuk priste njeri për t'ia zënë vendin. Burri u mbështet mirë, duke mos e hequr dorën nga shpina e bebes që tashmë kishte pulitur sytë.

Lokomotiva fishkëlleu. Vagoni u lëkund paksa dhe menjëherë u ndie ritmi metalik i shinave. Foshnja nuk dha ndonjë shenjë se dëgjonte. Bota për të, kuptohet, nuk kishte asnjë sekret, gjithçka ishte e njëtrajtshme. Të dy prindërit me sytë si një qiell i vogël mbi atë gjallesë të vockël, diçka mërmërisnin në një gjuhë të pakuptueshme për të tjerët, por të kuptueshme për beben që hapte gojën rrumbullake si një lulekambane dhe qeshte.

Kur kaluan stacionin e parë foshnja shtrembëroi fytyrën dhe u bë gati të qante. Gruaja e përkundi sërish, duke ia mbajtur pëllëmbën dhembshurisht te brinja si mbrojtëse. Burri futi dorën nën shtrojën e foshnjës, por si duket mendoi që ishte pak, se nxori nga çanta një mbulesë tjetër pambuku, disi më të vogël, e palosi më katërsh duke imituar shtratin dhe i bëri një shenjë gruas të ngrinte beben. Por ajo, ndërkohë, pa mbaruar ai shenjën e kishte marrë beben ndër duar dhe ai ia shtoi shtrojës ekzistuese. Pastaj ajo e vuri ngadalë si të

kishte të bënte me diçka të thyeshme. Burri e mbante çantën gjithnjë hapur dhe nxoi një shishe të mbështjellë me letër të bardhë. Ishte ujë. Gruaja ia afroi bebes te goja.

-Kujdes, - tha ai.

Ajo nuk foli se e kishte mendjen të përqendruar, por nga shprehja që mori, u kuptua sikur tha: "Sigurisht, ja, shih". Fillimisht e gudulisi pak të voglin me gishtat e dorës së majtë në mjekër, më pas i preku fare lehtë buzën e poshtme me hiberon si në një lojë dhe sakaq ia vuri në gojë kur ai qeshi. Foshnja e mbërtheu i ngazëllyer dhe piu me etje; megjithatë pamjen nuk e kishte të qetë se e lëshoi menjëherë. Gruaja e ngriti shishen lart, në drejtim të shikimit dhe pa vijat ndarëse për të llogaritur sasinë. Ia dha burrit me një shenjë miratuese të kokës që nënkuptonte se kishte pirë mjaftueshëm. Ai e mbështolli dhe e futi përsëri në çantë. Ajo ia vuri sërish biberonin midis buzëve, por tani pa shishe, sidoqoftë këtë gjë e bënte rrallë, sepse nuk donte që t'i shndërrohej në shprehi e t'ia prishte formën e gojës. Pas pak burri e ktheu foshnjën në anën tjetër. Ai sikur u urtua, sepse iu varën duart dhe fytyra i humbi midis ndenjëses dhe mbështetëses. I dukej vetëm shpina si zambak i njomë dhe një topth i lëmuar, si një planet i vogël, që ishte koka. Burri mori në çantë një napë të hollë e ia hodhi përsipër. Gruaja e lëmonte paksa në brinjë dhe i nanuriste duke e përkundur. Në kabinë shpërndahej një melodi e hareshme. Mos ishte Pranvera e Vivaldit? I vogli ndryshoi pozicionin e kokës të mbante vesh. Biberoni ngjasonte si hundë pinoku pranë asaj hunde imcake që fërgëllonte. Bënte vapë e padurueshme. Ata të dy e vunë re njëkohësisht si iu njomën tëmthat nga djersa dhe me veprime të përbashkëta ia fshinë me një napë të hollë dhe e kthyen mbarë. Foshnja heshti një grimë, pastaj e mbërtheu napën me ca gjeste të trazuara dhe nisi të grindej. Biberoni i ra nga goja, por gruaja i kishte sytë aty. E kapi me dy gishta diku midis mjekrës dhe gushës, ia tundi para fytyrës, si t'i tregonte një zogth ose një flutur dhe i qeshi me aq butësi, sa ajo qenie sa një grusht, ia ktheu menjëherë me gugatje të gëzuara. Por pastaj qau. Gruaja e mori në prehër dhe nxori sisën e saj të madhe. Në tërë qenien i rrezatonte një diell i brendshëm mëmësie. Bebja e zhyti fillimisht kokën në atë masë të bardhë dhe në çast e gjeti thimthin që e futi në gojë me vrull. Qumështi zuri të rrëkëllehej herë shpejt e herë ngadalë; gusha e tij e njomë e pasqyronte gurgullimën si të ishte një qelq i tejdukshëm. Herë pas here ai e nxirrte sisën nga goja, shihte sa të ëmën, sa të atin dhe i kthehej përsëri detyrës foshnjore. Pa flokë, pa dhëmbë, tepër i bardhë dhe i imët, fëmija të krijonte idenë e një sendi ajror që përkundet nga ritme të mistershme. Ai piu një herë në njërën sisë, pastaj në tjetrën, i kënaqur si të ishte në festë dhe pastaj kërkoi që të ndryshonte krah. Gruaja e ngriti hopa duke e mbajtur mirë nga sqetullat, e la disa minuta të mahnitej me gjerdanin e saj dhe kur e kuptoi që u lodh, e shtriu në "shtratin e vet". Foshnja u duk sikur ra në qetësi, por pas një grimë here klithi fort, si ta kishte thumbuar ndonjë grerëz. Burri shkoi dorën përgjatë paretit dhe poshtë dritares që të pikaste se mos frynte. E hoqi i menduar dhe përnjëherë si të kujtohej për diçka, e vuri dorën poshtë, te vendi i mollaqeve të bebes. Edhe gruaja i kontrolloi rrobat, duke e përkëdhelur. Ajo e pa burrin në sy, gjysmë e pezmatuar. Pra, fëmija ishte lagur dhe asaj nuk i kishte shkuar në mend më herët?! Ai afroi çantën pa zhurmë dhe gjeti pakon me një palë ndërresa të bardha. E zhveshën dhe e veshën beben të dy, me veprime të sakta si nga një komandë e fshehtë. Sigurisht i vogli qau pak, por kur e shtrinë përsëri, gruaja shtoi edhe një napë të hollë prej pambuku, të cilën ia palosi më katërsh nën të ndenjura, pastaj ia kaloi midis kofshëve që i kishte rrathë-rrathë prej shëndetit. Burri e mbante lehtazi te supet se mos rrokullisej. Bebja u duk krejt si akullore e bardhë. E kthyen "akulloren" gjysmë përmbys. Ajo i ledhatonte kokën, ai i prekte me mollëzat e gishtave supin, shpinën dhe pastaj e çonte ngadalë dorën te shputat e këmbëve. Dikur foshnjën e zuri një gjumë i thellë. Këmbkat e vogla si pufka reshtën e u palosën të kapitura dhe nga doçkat me gishta të hapur si yj në të dyja anët e ndenjëses, lëshohej një freski hënore. Mëma e sodiste tek buzëqeshte në gjumë. E ulur në zgrip, për t'i lënë sa më shumë vend të lirë dhe e përkulur mbi të, ajo ngjasonte me një floçkë që këqyr pasqyrimin e vet. Babai në ndenjësen përballë, me dorën të zgjatur përherë nga shpina e bebes për ta mbajtur, dukej si një urë mitike që dridhtohet.

1983

** Ky tregim është paraqitur më 1986 dhe më 1988 në Shtëpinë botuese "Naim Frashëri", në një libër të titulluar* Mundja e vdekjes, *i cili nuk u botua. Është një histori kontradiktore dhe komike mes recensave pozitive dhe vendimit negativ të redaksisë, të cilat i ruaj dhe mbase do t'i botoj një ditë. Më 1996 u botua në librin* Duart e Anës, *Marin Barleti, Tiranë.*

KATËR POEZI

nga Afrim Demiri

Heshtja e purpurt

Vala n'breg
merr brengën teme
e valon n'thellësi të detit
pastaj e vjell me mllef
e nxjerr si balenë të ngordhun

Godet sërish
tash m'përbinë mue
me'ban njësh me detin
pikëzohem deri sa tretem

Nuk e njoh veten
pres baticen ta trazon detin
të m'përplas në breg

Unë dhe brenga jeme
në gjah të valës
grindemi në heshtjen
e purpurt të diellit

Gjurmët në zallë

Gjurmët e hapave
digjen në zallin valë
Në trupat e zhveshun
e kuptoj çmimin e lëkurës
së djegun

Shtrihem
gjysma në deti
gjysma në zallë
si urë e valës
dalldisëse

Kush e zbuloj varrin
nuk e ka njohë detin
lakmoj vdekjen e marinarëve

Hapat në zallë
as nuk shkojnë
as nuk vijnë
sharrojnë deri n›fundin
e detit

Rituali i ujit

Ujë ujë ujanë
bjen daullja e ujit
Askush s' është i huaj
Nën ritmin e saj

Fillon rituali
me stërkala n'qerpikë
n'buzë ngadalë na banë qullë
Të qullosun të marrosun
zhytemi në Akvariumin
prej ku jemi Krijue

Daullja e ujit
trazon detin
e shkyen qiellin
i dalldisë lumenjtë

Në valën e tij
si në vallën e përjetshme
rri Epi i Perëndisë
së ujit

Në fund të tij
të gjithë fundosemi
ngadalë të bindun se jemi
Posejdoni vet

Deti n'det

Një shtatzanë
hyni n'det si një zanë
frytit të nanës iu dukë
se deti hyni n'det

Deti u fry u fry
dhe nga vala e tij
e pashë si lindi
një fëmijë

Fëmija jetim doli
n' breg e nana
vazhdoi jeten si sirenë
deri në shtatzaninë
e radhës

NJË NATË PËR BURRIN

Tregim nga Shqiponja Axhami

Mbështjellë në një batanije leshi, Rexha ndjente vapë. Kur Zoica dhe tri gratë e tjera të tij kaluan dhe kthesën e fundit të rrugës, ai e kuptoi se kishin mbërritur tek varrezat. Disa metra para se të futeshe në varreza, rruga nuk kishte gropa.

Që do të mbështillej në një batanije leshi, që do të mbahej nga katër gratë e tij dhe do të dërgohej në mes të varrezave, tek një varr pa emër, këtë nuk e kishte parë as në ëndrrën më të frikshme. Por, siç i thonë një fjale, nevoja të sprovon dhe më strofullën e dreqit. Ai kishte dyzet vite martesë dhe nuk ngjizi që nuk ngjizi dot një trashëgimtar. Në të ri qe martuar si gjithë të rinjtë e moshës së tij me Zoicën, një vajzë e urtë nga Mëhalla e Endësve. Por, pas njëzet vitesh, i vrerosur që barku i saj po dilte shterp, i tha të atit që duhej ta zgjidhnin këtë punë. Në atë kohë, nëse gruaja dilte shterpë, burri kishte të drejtë të martohej prapë. Martesa e dytë e Rexhës e dogji si gacë shpirtin e Zoicës, por nuk kishte rrugë tjetër. Të kthehej tek shpia e të atit as që bëhej fjalë. Nami që qe shterpë do të përhapej si flamë e keqe dhe do t'i duhej të martohej me ndonjë plak. Veç kësaj, ajo e donte me shpirt Rexhën.

Për fat të keq, as me Fatën, as me Gjylën dhe as me Mrikën, gruan e katërt, ai nuk ngjizi që nuk ngjizi dot një fëmijë. Zoica këndellej gëzimit sa herë që gratë e reja të të shoqit i përgjigjeshin: "Nuk ka gjë në torbë as këtë herë".

Kur dhe Mrika, vajza e re që plakun Rexhë e mori nga zori, ngaqë syri i majtë i saj qe pak më i vogël se i djathti dhe asnjë djalë i moshës së saj nuk ia hidhte sytë, nuk u ngjiz, Rexha u bind që fajin e kishte vetë. Nuk la spital e mjek pa vajtur, por qe ekotë.

I dëshpëruar dhe mbushur me mllef, megjithëse zor se gjendeshin në atë kohë, mori fshat më fshat hoxhallarë, por as kjo nuk i bëri punë. Kur të gjitha i kishte provuar, nuk kishte mbetur më asnjë shpresë dhe kishte ditë që nuk dilte as nga shtëpia, në fshat u hap lajmi se një plakë që jetonte e vetme në një fshat të përtejqafës bënte çudira. Ajo na paskësh mahnitur të gjithë, sepse, nusen e Dinit që e kapte herë-herë epilepsia, na e paskësh shëruar me një të fryrë të ujit. Por jo vetëm kaq, edhe djalin e Dan mullixhiut e paskësh ngritur nga krevati. Ky i fundit, prej vitesh nuk prekte tokën me këmbë, sepse sipas tij, toka qe mbushur me gjarpërinj dhe akrepa. Madje thuhej se me magjitë e sajkishtë bërë një lopë të pillte dy viça dhe, burrat e mbaruar që kishin vite pa u afruar me një grua, i shndërronte në hamshorë të hazdisur.

Tek kjo plakë Rexhën e bindi që të shkonte Zoica. Plaka, një grua e kërrusur, me fytyrë të sertë, që nuk të shikonte kurrë në sy, pasi fryu një polik me ujë në prag të derës, urdhëroi që Rexhën ta mbështillin në batanije dhe ta shtrinin në varreza, tek një varr pa

emër. Rrugës, katër gratë e tij do ta mbanin peshë, nuk do t'i flisnin dhe nuk do t'i jepnin asgjë, edhe sikur ai të kërkonte gjësendi.

Kur mbërritën në varrezë, Rexha psherëtiu i gufatur vape dhe fshiu djersët që i rridhnin çurg. Zoica i afroi buzëve polikun me ujë dhe urdhëroi të tjerat që të gjenin ndonjë varr të vjetër, që nuk i dihej emri. Pas pak, Rexhën e shtrinë në një varr të sheshuar, gati njësh me tokën dhe katër gratë mbështetën kokën mbi trupin e tij, ashtu siç i kishte porositur plaka, duke përsëritur tri herë fjalët: "Varri i paemër, na sill një emër. "Më pas Rexha prapë do të mbështillej në batanije, por deri në mes të udhës, bri një arre të vjetër. Aty do të dilte mbështjellës dhe poshtë arrës do të thërriste tri herë: "Njeri! Njeri! Njeri!"

Mirëpo as pas kësaj nate dhe as pas mbarimit të ujit, që Rexha e piu për dy muaj, nuk ngjizi dot asnjërën nga gratë. Rregulli që të flinte me to ishte i tillë: ai linte nallanet e veta para derës së asaj me të cilën do të kalonte natën. Filloi me Zoicën, megjithëse ajo i kishte kaluar të pesëdhjetat, vazhdoi me Fatmën, Gjylën dhe sosi me Mrikën e re, por qe e kotë. Rexha jo vetëm që nuk ngjizi asnjërën prej tyre, por as të bënte dashuri siç bënte tjera herë, nuk mundi dot. Sapo ato futeshin në dhomë, atë e kapte një siklet, një zjarrmi, si ajo kur e mbështollën mes batanijes dhe mbytej nëdjersë.

Pikëllimi nisi ta brente çdo ditë e më shumë. Ndihej i zemëruar me veten, i inatosur me krejt botën. Dhe tërë helmin e mbledhur në shpirt ia nxirrte kalit të tij të vjetër, që hingëllinte sikur tallej sa herë që ai përpiqej të ngushëllonte gratë e tij.

Mllefi ndaj kalit arriti deri aty sa, thuajse çdo mëngjes, dilte duke turfulluar nga dhoma, hynte në stallë dhe e dërmonte kalin në hu. Disa herë Zoica e kishte ndjekur pas dhe qe përpjekur ta ndalte, por qe e kotë. Mbi kalin e gjorë Rexha nxirrte gjithë mllefin e dështimeve të tij.

Në fakt, kali qe shumë i vjetër, dhëmbët e poshtëm i kishin rënë dhe për më tepër gratë i vinin pesha të lehta, që nga dita kur, në mes të fshatit, ai u plandos gati i ngordhur dhe thasët me drithë që mbante në kurriz u grisën, misri i derdhur zverdhi dhenë.

I dërrmuar nga dëshpërimi, duke ngrënë nga pak sa të mbante shpirtin, Rexha erdhi u sos, mbeti kockë e lëkurë. Dëshira që të flinte me gratë pothuajse i

kishte ikur krejt. Nallanet nuk i linte më tek asnjëra nga dhomat e tyre, por i vinte si pa zhurmë përpara derës së nevojtores. Një natë, kur pas gjelit të parë hingëlliu gjatë dhe kali, ai doli vrulltas nga dhoma, zbriti në stallë dhe e tërhoqi më forcë dhe mllef.

Zoica që e ndiqte nga pas, i ulëriu:

"Do e mbysësh, ç'dreqin ke në mendje?"

Rexha, me një zë të çuditshëm dhe sy të zgurdulluar, ia ktheu: "Do shkoj ta shes! Nuk e duroj dot më coftinën!"

Kali nxori një hingëllimë të mbytur.

Pazari i kafshëve ishte në krye të një tatëpjete dhe Rexha mezi e sosi rrugën. Si ai, si kali, qenë të dërrmuar. Sapo disa fshatarë iu afruan ta pyesnin për çmimin, nuk e zgjati shumë me ta, por e shiti për dy para, aq lirë sa shitej një dele. Kur i lëshoi frerët në duart e blerësit, kali hingëlliu i lehtësuar.

Rexha i hodhi një shikim përbuzës kafshës që sapo ua pati dorëzuar të huajve dhe mori teposhtën i lehtësuar.

Kur sosi në mes të rrugës, bri arrës së madhe, u ul të pushonte. Kishte ditë që bënte një gjumë të keq dhe hante vetëm pak supë tërshëre, që së fundmi Zoica ia gatuante keq, nga mllefi që nallanet i vinte vetëm para derës së nevojtores. Kur ndjeu freskinë e hijes së arrës, iu kujtua vetja i vogël. Rrëshqiste tirqit me arna në degët e saj, kur fshihej shkopit të gjatë të nënëlokes, që e shponte nga poshtë të zbriste, sepse ishte vonë për në shkollë. Njëherë pati marrë dy vezë nga një fole zogjsh dhe e ëma i tha duke turfulluar se do të ishte i mallkuar gjithë jetën. U ndërmend se atë ditë, kur mbërriti në shkollë, një mësuese e shëmtuar me fytyrë burri e nxori para klase të vizatonte një dre dhe shokët u zgërdhinë me duart e tij të zeza nga lëvozhgat e arrës.

Një herë tjetër erdhi i ati me kalin, që atëherë ishte i ri, e mori duke e shpullisur dhe kapur për veshi, ngaqë kishte lënë dhentë pa zot, bri Përroit të Dreqit. Kur iu shfaq si nëpër mjegull dita e parë që kishte parë Zoicën në Lugun e Shelgjeve, ku prisnin degë për Ditën e Verës, e këputi gjumi.

Në ëndërr iu shfaq arkëmorti i vet.

Në arkëmort nuk ishte aq terr. Ai dëgjonte zërat e grave që e qanin, ndërsa Zoica e vajtonte.

Na le krahun thatë burro, oii Na le shtratin thatë burro, oii Na le trupin akull burro, oii

Nuk është zakon që një grua të vajtojë burrin, por ja që ajo e çmendura po e bënte.

"Moj ju marrtë dreqi, se më turpëruat! Kushedi sa burra janë në varrim!" bërtiti me të madhe brenda arkëmortit.

Por Zoica nuk e dëgjonte. Pas saj, fjalët e vajit përsëriteshin nga të tri gratë e tjera.

Rexha sa nuk po pëlciste nga inati dhe turpi. Ndjente nga thellësia e brinjëve një përvëlim, më keq se ai i batanijes. Donte të bërtiste, por nuk mundej. Arkëmorti ishte i rëndë dhe për më keq, me material hekuri. Pas vajit, gratë e lëshuan në gropë. Ai e kuptoi këtë, ngaqë trupi i peshoi poshtë dhe një *-oi* e Mrikës ndihej më e largët. Kur preku në tokë, kutia e hekurit lëshoi një tingull acarues, që të shurdhonte. Ai mezi i kuptonte gjysmëfjalitë e grave, që, si duket, vendosën t'i hidhnin sipër nga një plaçkë si kujtim.

"Unë do t'i jap me vete jelekun", tha mes lotëve Zoica.

Qe një jelek i punuar me vekë me lloj–lloj ngjyrash, që Zoica e kishte veshur ditën e dasmës. Gratë e tjera heshtën dhe nuk nxorën asnjë fjalë. Si duket, nuk kishin marrë asgjë me vete si shenjë kujtimi. Në momentet e fundit, kur Rexha po e ndjente edhe më frikën e territ, mungesën e ajrit dhe kur qe i bindur se tani gratë do t'i hidhnin dheun, zëri i Mrikës çau heshtjen, si piskamëqyqeje:

"Daleni, kam dhe unë diçka!"

Rexha dëgjoi sipër vetes zhurmën tipike të diçkaje, që ai i njihte fort mirë: ishin nallanet. Kur tingulli i tyre me faqet e hekurta të arkëmortit i shpoi jo vetëm veshin, por dhe shpirtin, shtati i kërceu

përpjetë, i doli gjumi.

Muzgu kishte përndezur rrethinat dhe degët e arrës dukeshin si pëllëmbë tëhapura varur në ajri. Një shpend i frikshëm përpëliti flatrat midis degëve ë arrës me zhurmë dhe ndërsa atij i oshëtiu veshëve një fjalë që e mbante mend fort mirë kur e patën çuar pranë varrit të paemër: Njeri! Njeri!Njeri!...

U ngrit dhe, me hap të shpejtë, mori gjysmën e rrugës së mbetur. Ngjyrat e atij muzgu i zbusnin pak shpirtin, duke i kujtuar jelekun e endur në vekë të Zoicës. E kishte marrë dhe uria.

Katër gratë zgurdulluan sytë kur e panë të shfaqej në derë. Rexha dukej njëzet vjet më i ri, ngjante i përtërirë vrullshëm, sikur brenda tij digjej një zjarr i fshehtë.

Pa i kushtuar vëmendje habisë së grave, Rexha ulëriti: "Më sillni për të ngrënë! Po më grijnë zorrët!"

Katër gratë nxituan të shtronin sofrën. I sollën djathë, bukë të sapogatuar, turshi, një shpatull qingji të pjekur dhe një tas të madh më kos deleje. Nuk e kishin parë prej vitesh të hante me aq oreks e babëzi. Si mbaroi bukën, shkoi dhe mori nallanet që i kishte lënë mbrëmjen e djeshme para derës së banjos dhe i vendosi para pragut të Zoicës. Por këtë veprim e kreu ngadalë e me ceremoni, që gratë ta shihnin mirë se çfarë po bënte. Gratë u çelën në fytyrë dhe ia ngulën sytë me zili Zoicës.

Zoica nuk e zgjati. U tha natën e mirë tri grave të tjera dhe shkoi në dhomën e vet.

Edhe tri gratë e tjera bënë të njëjtën gjë, duke i lëshuar një "natën e mirë" të thatë Rexhës, që as e mori mundimin t'ua kthente.

Pas tyre u ngrit dhe Rexha, që u fut pa zhurmë në dhomën e Zoicës. Pas pak shtrati i vjetër i Zoicës zuri të kërciste, sikur do të thyhej. Të trija gratë e tjera hapën dyert e dhomave dhe po përgjonin në errësirë atë që po ndodhte. Shtrati vazhdonte të lëshonte tinguj të çjerrë, dëgjoheshin rënkime të njëpasnjëshme, psherëtima. Pas njëfarë kohe, dëgjuan Zoicën që thoshte me zë të mbytur: "Dua, por nuk mundem. Dua, po s'mundem më."

Dëgjuan dikë që u ngrit nga shtrati dhe të tri gratë u futën shpejt e shpejt në dhoma.

Pas njëfarë kohe, tingujt mbytës, rënkimet dhe psherëtimat e kënaqësisë erdhën nga dhoma e Fatës. Fata lëshonte ca klithma me zë të mbytur, sikur e kishte ngjeshur pëllëmbën e dorës pas gojës. Pastaj u dëgjua një *oooooh* e zgjatur që në atë shtëpi nuk ishte dëgjuar kurrë. Fata e kalamendur nuk e kontrollonte më veten.

Natën vonë, Mrika dëgjoi përgjumësh rënkimet e mbytura që vinin nga dhoma e Gjylës. Nuk ngjanin me rënkime njerëzore, po me murmurimat e mbytura të një shtaze në agoni.

E përhumbur, Mrika nuk e kuptonte se çfarë po ndodhte asaj nate. U kthye në anën tjetër dhe preku me bulat e gishtërinjve faqen e ftohtë të murit. U rrënqeth. Po unë, unë, unë? i klithte vajtueshëm një zë i brendshëm.

Atëkohë u hap dera dhe hyri Rexha.

"Mjalti për në fund", tha duke u futur në shtratin e saj krejt lakuriq. Mrikës ia shpoi hundët një kundërmim i çuditshëm. Përveç aromës së thartë prej burri të Rexhës, në atë kundërmim ishin dhe aromat e tri grave të tjera. Ky kundërmim i ngjalli një eksitim të papërmbajtshëm. Bënë dashuri deri në dalëdritë, kur ylli i fundit po shuhej në qiellin e perëndimit. Rexha u ngrit dhe shkoi në kuzhinë, ndërsa Mrikën e këputi një gjumë i thellë.

Kur gratë u ngritën nga gjumi, diku afër mesditës, e gjetën Rexhën të shtrirë në divan, të ftohtë akull. Me siguri kishte dhënë shpirt herët në mëngjes, se shtati i kishte ngrirë.

Vaji dhe dhimbja e grave vazhdoi për ditë e javë të tëra. Vetëm pas katër muajsh, kur Zoica u tha tri grave të tjera se ishte shtatzënë, ato shpërthyen në lot gëzimi dhe pohuan se edhe ato mbanin fëmijët e Rexhës në bark.

KUAJT E NATËS

Tregim nga Istref Haxhillari

Thoshin se ishte kurvë, por ai e donte. Ja që edhe një femër e tillë mund të duhet, madje marrëzisht. Fjalët e liga nën zë nuk e bindnin.

"Njerëzit i zmadhojnë gjërat", - prirej të mos u zinte besë.

Në qytetin e tyre, e shkuara dhe e tashmja ndesheshin secila me mjetet e veta paqësore. Koha e re luftonte hapur me autostrada, makina luksi, internet, hotele moderne. Tinëzarja kohë e vjetër fshihej prapa qosheve, rrugicave me kalldrëm ngrënë nga koha, bahçeve të qëmoçme.

Sidomos prapa syve mosbesues.

Neni banonte në cep të lagjes së vjetër afër burimeve të famshme, Fillareta pranë rrugës kryesore në hyrje të qytetit. Jepte anglisht në një shkollë rrëzës së Malit të Thatë. Dilte herët në mëngjes te stacioni i autobusit, kthehej rreth orës katër pasdite.

Në fytyrë nuk ishte gjë, sytë e bardhë të larguar, hunda e vogël, flokët bojëgruri e tregonin mesatare, po kurmi i derdhur gjithë relieve, këmbët e përsosura, sjellja e shpenguar i godisnin meshkujt. Djemtë turbulloheshin, u mbahej goja, nuk lidhnin dy fjalë për të qenë, burrave të martuar u mbeteshin sytë, sikur rrekeshin të mbushnin boshllëkun e kahershëm. Guximtarët që kapërcenin cakun, i shpartallonte me vështrimin e butë të syve bardhoshë, lule kumbulle.

Bukuria femërore është më shumë se trill në skemën e përgjithshme të natyrës.

Nga që vishte bluza të hapura me ngjyra të vrara, funde të shkurtra, zbulonte gjer lart këmbët elegante, shumë syresh ishin të bindur se diçka nuk shkonte. Gratë e përgojonin si u vinte për mbarë.

Ajo nuk dinte të urrente.

"Forca e zakonit, - i mëshironte, - *sa pak dashuri kanë njerëzit!"*

Vajzat e sodisnin me frikë, si të sëmurët e pashërueshëm. Kaq e mirë dhe lavire? U vinte keq për Retën me trup aq të bukur, për t'u pasur zili.

"A nuk mund ta hiqte atë njollë?"

Ja kështu qe Reta, me shpirt të lirë, shikonte punën, as bëhej merak çfarë thoshin.

- Arrat i gjuajnë me gurë, - bënte shaka Tom Belegu.

Vajza i davariste brengat e moshës, si flladi i vjeshtës retë e zeza të fillim dimrit.

- Aha këtë e di xha Tomi, - miklohej pa të keq, - s'na the ndonjë gjë të re.

Neni e takonte në rrethinat e Qytezës, ku preheshin gjurmët e vendbanimit të lashtë. Drurët e dendur përmes të cilëve vinte një copë liqen gri me rrudha të argjendta krijonin intimitetin e dhomës së gjumit. Ajo vinte duar nën kokë, thithte polenin e luleve të sapoçelura, aromën e athët të rrugës, dëgjonte fëshfërimën dembele të ujit. Drita e zbehtë kafshonte lakimet e këmbëve, format e gjinjve, ndriçonte flokët në ngjyrën e mollëve të pjekura. Ngjitur pas njëri-tjetrit këmbenin ledha dashurie, eksploronin zona të panjohura.

Zgjasnin çastin para se të jepeshin.

- Je kali im i natës, - i thoshte ai.

- Eh jo, pelë më mirë.

Argalisej, qeshte.

Puthjet e zjarrta, rënkimet, vesku i natës, muzgu shkrirë në një, kjo ishte lumturia. Loja e kuajve të natës nuk shterte kurrë, orët larg u dukeshin vite...

Nga dritarja e raftit kozmetik në marketin e Kristinës, ku blinte çdo muaj pastën e dhëmbëve *"Cherer"*, Neni e pa të zbriste shkallët e pallatit. Pothuaj njëherësh dëgjoi zërin e ngjirur prej burri të Xexes.

- Ta pish në kupë, po ç'e do, e lëvizur.

Kristina u gjallërua përnjëherë.

- Eh, ajo jeton në tjetër botë.

Tërë ditën pas banakut regjistronte gjithçka si aparat digjital. Në dyqanin e saj duzina gra të ngeshme shtynin kohën. Rrallë i shpëtonin kalimtarët kërshërisë së tyre. Reta ishte pre i lehtë, nuk dinte të mbrohej.

- Shkon me Tom Belegun, - tha Xexja me gjysmë zëri sikur rrotullonte mastikë nëpër dhëmbët e ngrënë.

- Na bëre për të qeshur.

- E pashë me këta sy.

- Ku, moj e zezë?

- Rrugës së Qytezës. Dëgjova ca rënkime femre nga ato, e di ti, pastaj zërin e Tomit *kali im i natës.* Kështu i thënkan tani.

- Je në vete!

- Me zor e besova edhe vetë.

Neni pagoi, doli.

Kur u takuan në mbrëmje, Reta i tha buzagaz.

- Tom Belegu më quajti *kali i natës.*

U shastis.

- Jo, - ironizoi, - *kali im i natës.*

- Çdo të thuash?

- E dëgjove.

U ngrys dhe heshti. Fjalët më shumë e lodhnin, se sa e trishtonin.

Neni e dashuronte, nuk i bëhej të mbante inat. Atë mbrëmje loja erdhi mbresëlënëse si rrallë herë. Teksa e mbante në krahë, përkëdhelte kofshët e ngjeshura, të rrëshqitshme, harroi gjithçka.

Harroi edhe se ishte i vdekshëm...

Pasdite hyri në bar, porositi kafe, me sytë rrugës nga kthehej Reta. Në orën e caktuar sapo u dha te kthesa, ia shtoi rrahjet e zemrës. Klientët kthyen kokën njëherësh, e ndoqën me sy derisa silueta humbi pas farmacisë.

- Pelë hergjele! - ofshani Viktori i moshuar.

- Ah, edhe ti xha Tori! - e ngacmoi kamerieri.

- I fortë Belegu!

Zëri hundor erdhi nga fundi i kafenesë.

- Eh, këto laviret, sa të ëmbla janë! - hungëriu një i dehur me tonin e atyre që i dinë mirë ato punë.

Nenit u ngrit, doli i dërrmuar si fatkeq. Qielli e shtypte mbi kokë.

Mezi e priti takimin.

- Nga e dinë? - pyeti vrazhdë.

- Çfarë?

- Batutën.

- Prita të ma thoshe ti.

- Cila është e vërteta?

Habia ia lagu sytë e qelibartë. Nuk mori mundimin të vazhdonte një bisedë të kotë pa pikë kuptimi, as ishte e aftë të hynte në të tilla hulli. Skenat e neveritnin. Ç'të vërtetë kërkonte prej saj?

U zhduk si një psherëtimë.

E kërkoi qysh atë ditë, pastaj ditët e tjera. Nuk e gjeti dhe e pa veten siç qe në të vërtetë, të mjerë, pa dashuri. Ëndrra e thurur me aq mundim u zhbë, si të mos kishte qenë kurrë. Tre vjet të hatashëm u kthyen në kujtim.

Për një farë kohe njerëzve nuk u ra në sy, mandej u shqetësuan.

Burrat e martuar e kërkonin në vendet ku e shihnin dikur, nuk e gjenin, largoheshin të mërzitur, pa kuptuar tamam përse. Gratë e ndjenë më shumë. Zgjasnin kokën prapa perdeve, vështronin rrugën mëngjeseve, pasditeve, nuk e shihnin dhe ndiheshin bosh.

Si të mbushnin kohën?

Lagja e vjetër vazhdonte luftën e pashpallur, po tani jeta pati bërë kapërcime të mëdha. Kishte më shumë vajza të hijshme me funde të shkurtra rrugës, se gra të ligështuara nëpër markete.



DASMA

(triptik)

Nga Roland Gjoza

Dasma po harbohej nën pjergullat e rrushit të kuq tajgë. Dem Muzala thërriste me zërin e tij të ngjirur;

-- Mos prekni rrushin! Janë gjithsej 127 bistakë.

E shoqja Tinka Muzala e tërhiqte nga këmisha.

-- Mos, se na turpërove.

Dem Muzala thërriste;

-- Hani rrush, ju baftë mirë!

-- Ti paske cof, Dem.

Tinka dhe dy gra të tjera i prenë bistakët me gërshërë bagëtish dhe mbushën dy tepsi plot me rrush. Ishte një zallamhi, një katrahurë e vërtetë ,gjindja hante me dorë dhe pinte si e babëzitur.

Nusja, Mira Muzala, një vajzë e gjatë e bëshme me fytyrë madone nënqeshte me hir të përvuajtur. Asaj i vinin letra nën dorë, njëra më e tmerrshme se tjetra. "Babai yt ai gjatovina, flet marrina. Thuaji të mos llapë se po prish dasmën. Llomotit dokrra. "Ajo ia përcillte nënës. Një tjetër shkonte dhe më larg; Ju s'njfni zakonet e dasmës. Po e teproni."

Tinka s'e donte veten. 500 vetë në dasmë. 500 llupësa. 500 sarhoshë, se edhe gratë s'ia përtonin rakisë e birrës. Ç'ishte gjithë kjo pangopësi e shfrenuar, kjo shëmti e pakontrolluar e portreteve të mbufatur e të vrarë nga të ngrënët e të pirët e tepërt?

-- Hani rrush, -- thirri sërish Dem Muzala -- Qijani t'amën, më lat pa verë e raki. Më shuajtët o dasmorë të nderuar.

Tinka i binte me grusht në kurriz.

-- O i marrë ,ke parë të dehet babai i nuses në dasmë, ç'janë këto marrëzira, po na vijnë letra..na shajnë!

-- 20 000 ka kushtuar dasma.

-- Ç'flet, o i marrë!

Askush s'e dëgjonte. Të gjithë hanin e pinin.

-- Jam shkundur!

-- Je në vete?

-- Grua,bëj provë. Askush s'dëgjon nga ai vesh. Janë të kënaqur.

- Nuk e kishe me gjithë mënd?

-- Aspak.

-- Unë e shkreta këputa gjithë atë rrush.

-- Vetëm ti më dëgjove. Janë të kënaqur.

-- Po letrat?

-- Ç'letra?

Ajo i tregoi nje tufë me letra.

-- Janë nga ana e dhëndrrit, nuk e kupton? Jemi në konkurencë. Ai matufi, Fric Mushkalla ka ftuar vetëm 200 dasmorë. Ata vuajnë nga qimja.

-- Ç'do të thotë kjo?

-- Qime.

-- Shpjegohu!

-- Merren me qimen. Ai, Fric Mushkalla po zjen nga tërbimi. Ka konkurencë dhe në dasma, grua. Ia kaluam. Janë të kënaqur. Shiko si i shqyejnë syte, si thonë shaka, mish pa hesap, verë det, raki det, birrë 350 arka me nga 12 shishe secila. Nje vajzë kam. Nesër në drekë ikën. Më le, ikën grua, ikën nesër në dreke. Vjen e merr ai gjyslyksi, profesori i misrit.

-- Mos e shaj djalin.

-- S'e kam djalë.

-- Djalë e ke. Mbylle. Mos të dëgjojë vajza.

-- Askush s'dëgjon.

Në ora 12 të darkës Dem Muzalën e kaploi një merak i madh. Krushqia nuk po dukej. Kaloi ora 1, askush nuk u shfaq në derë. Tinka e alarmuar, Mira me sy përmbys. Vendi i dhëndërrit bosh.Ç'ka ndodhur? Ata të Fric Mushkallës po e tepronin. Ora tre. 500 dasmorët këndonin, pinin, hanin pa pushim.

Të nesërmen shtëpia u mbush plot, ngjeronin llokume, pinin kafe, cigare. Hynin e dilnin papushim. Kishte dalë fjala se Dem Muzala e kishte djegur, domethënë, hurrja byrrja, se ka me bollëk.

Po Dem Muzala mbahet rëndë, nuk i flet njeriu.

Ora 12 e drekës. Në derë hyn dhëndri, i zbehtë, i bukur, i bukur veçanërisht. Gjyslyket e miopit e bëjne të duket sapak tuhaf. U dëgjuan pëshpërima; erdhi, erdhi..

-- Kush erdhi? pyeti Dem Muzala.

-- Dhëndri.

-- Pse erdhi? Hej, pse erdhe ti,-- thirri Dem Muzala.

-- Erdhëm.

-- Pse erdhët?

Dasmorët i pushuan fjalët dhe mërmërimat. Ku ishte parë e dëgjuar që vjehrri të perzinte nga shtëpia dhëndrin?

-- Jam dhëndri,-- tha me naivitet profesori i misrit.

-- Ke ngatërruar derën,-- tha Dem Muzala i kënaqur tej mase në tërbimin e vet.

-- Kam ardhur të marr nusen.

-- Ç'nuse. S'ke punë me të. Shko, mos harro t'i vesh majat nga thembrat. Mos t'i pafsha sytë!

Dhëndri kthehet mbrapsht bashkë me shpur ën e tij. Ç'ndodhi? Asgjë e rëndësishme. Dasma vazhdon.

Mira Muzala u fut në një dhomë dhe s'doli më. Tinka Muzala bëri dy morfina intravene. Njerëzit hynin e dilnin papushim, hanin llokume, pinin kafen me surba të vogla dhe komentonin pa ndonjë interes të veçantë. Dasma vazhdon.

Dhëndri zuri dhomë në hotel dhe shkroi 1001 pusullka për Mira Muzalën.

Llokumet shoqëroheshin me sherbet trëndafili, amareta, çokollata, kikirikë, bajame, arra, stafidhe. Gjindja I hante me grushte.

Mira Muzala hapi dritaren dhe pa poshtë. Lidhi çarçafët dhe u kacavirr në shkurret me shermashek blu. Ia dha vrapit nëpër kopsht, shkeli mbi tepsitë me rrush, rrëshqiti, shqeu fustanin e nusërisë, një cohe e kushtueshme prej mëndafshi dhe u zhduk. U shtrua dreka, një drekë me mish e pije, u dehen e kënduan njerëzit, s'pyetën fort për Dem Muzalën, që tërhiqte lart çarçafët me tërbimin e një demi të goditur në zemër.Iku, pëshpëriti ,më la, iku përgjithmonë zemra ime dhe qau. Ma punoi, më turpëroi.

Andej nga dhëndëri vazhdoi dasma pa krushqi, këtej krushqia priste të nisej e s'po bëhej mbarë, po dasmat vazhduan në lindje dhe perëndim. Këtej mbeti gjindja midis të mirave që s'mbaronin as për shtatë ditë, ndërsa andej gjithashtu për shtatë ditë e shtatë net llauzi ngopi barkun e piu trutë.

-- Ç'ndodhi? pyeti dikush që i vinte për gjumë.

-- Asgjë, asgjë me rëndësi, dhëndri kishte kërkuar ftesë për atë natë.

Tjetri qeshi.

-- Ftesë për të ardhur krushqia në dasmë? Për herë të parë po e dëgjoj.

-- Megjithatë ishte një hollësi e vogël që s'ra fort në sy të 500 dasmorëve.

Mira Muzala merr mjekim ambulator, Dem Muzala nuk del në punë, Tinka Muzala ka zënë shtratin.

Dasma vazhdon.

-- 2 --

Dasma bëhej lart, poshtë në qilar babai i nuses dhe babai i dhëndrit rriheshin me grushte.

Nuses i kishte ardhur një pusullkë, pikërisht në kohën

kur ajo priste që ai t'i ulej në krah. Ajo lexon; "Liza, më ndje, ika, ika përgjithmonë. Mos më prit. Të kërkoj njëmilion herë ndjesë. Po iki me një tjetër, që e kam dashur, po më ka refuzuar gjithmonë. Të kam mashtruar. Më ndëshkoftë zoti. Atë kam dashur vërtet, vetëm atë, po s'të kam thënë. E di që të kam mashtruar. Më fal. Është e rëndë, ndoshta ti s'më fal kurrë dhe unë të jap të drejtë. Sot krejt papritur për fatin tim dhe fatkeqësinë tënde, ajo më tha po dhe ne u nisëm menjëherë, pa ndonjë drejtim, ku të na çonin këmbët. Lamtumirë përgjithmonë. Mos u pikëllo, duro, ndoshta një fat më i mirë të pret..jeto me këtë ëndërr. Më fal."

Asaj iu mor fryma. Më shumë se çdo gjë ndjeu hakmarrjen. Pastaj e hapi prap letrën krejt e marrosur, se ende nuk i besohej asgjë. E lexoi dhe njëherë me klithma të vogla. Dasma ishte në kulmin e vet. Dëgjohej orkestra, në pistë kërcenin të gjithë si të harbuar. Iu kujtua se diçka i kishte shpëtuar pa e lexuar. "Ps. E zhvesha kostumin e dhëndërrisë. Ia fala një lypësi."

Kjo e tërboi, iu përzie. Ia tregoi së ëmës, ajo ia tha të shoqit me ngjyra edhe më të zeza. Ai u ngrit, i foli diçka në vesh krushkut, babait të dhëndërrit, zbritën bashkë në qilar dhe atje filloi druri e huri. I gjetën të dy pa ndjenja.

Nusja hoqi byzylykët me rubinë të kuq, varësen prej ari me një zemër diamanti, shkuli vëthët, hoqi unazën me gurë diamanti blu dhe e flaku mbi dasmorët, zbathi këpucët, hoqi fustanin që e shkeli me këmbë dhe vetëm në këmishë nate ia mbathi nëpër shkallë dhe doli jashtë.

Atje në qilar nëna e nuses dhe krushka, nëna e dhëndrit, shkuleshin për flokeësh duke sharë njëra tjetrën me fjalët më të ndyra. Krushqit e të dyja palëve u zhdëpën në dru, përfunduan njëri mbi tjetrin të mbuluar me gjak.

Nusja trokiti te një portë ngjitur. Një djalosh me cullufe mbi ballë, me penë në dorë, nxorri kokën në dritare.

-- Liza,-- thirri ai -- ç'ka ndodhur?

-- Ai maskara më la, të doli fjala. Hape portën, pra?

-- Ke ardhur për mua? O zot!

-- Shpejt! Nuk e shikon si jam katandisur ?

Ai e hapi portën, ajo u fut brënda.

Atje kishte ardhur urgjenca, po dasma vazhdonte.

Pas dy orësh nusja qëndronte në vendin e saj, po në krah tani kishte një dhëndër tjetër. Një poet me cullufe, që dukej tejet i zbehtë. Mungonin disa vetë, babai, nëna e nuses,ca krushq,po kjo s'kishte fort rëndësi.

Dasma vazhdonte. Pritej të mbërrinin krushqit e rinj.

-- 3 --

Lin Delia mbushi një shishe me sherbet dhe ia dha djalit, Mart Delisë. Ishte mbrëmje.Ishte pahitur në bar e qe fashitur pothuajse fare pluhuri i rrafshnaltës ku kishte kaluar me vrundullimë grigja e fundit. Ai po nisej të lajmëronte dasmorët. Kali shkrofëtinte e kur e kur ngrihej kas me dalldi. Doli hëna. Maja e malit zuri cipë. Kali nxorri një palë flatra dhe u ngrit lart. Yjet këputeshin me furi me një muzikë të cuditshme.

Shtëpia e parë. I zoti i shtëpisë e gjerbi sapak shërbetin. Je i ftuar në dasmën time Luigj Veroneze. Ajo shishe shkoi shtëpi më shtëpi dhe të gjithë robt e Kelmendit i uruan të trashëgohej për jetë e mot. Kali fluturonte dhe hingëllinte nëpër mal. Shërbeti po bëhej fir e drita e hënës derdhej nëpër grykën e hollë të shishes e dyndej brënda me ngjyrën e qiellit kur bëhet gati të daleë agsholi. 999 frymë ishin lajmëruar përfundimisht, me një grimë sherbeti aromatik që të lë në gojë shijen e mjaltit të trëndafilit të egër dhe të qiellit të natës me hënë.

U kthye Mart Delia poshtë në pyllin me kedra blu dhe bëri një pushim të vogël. Atje në rrafshultë e flaku shishen e cila ra në një rrasë varri. Djali e mori shishen ku kishte mbetur grima e fundit e shërbetit dhe e derdhi mbi rrasë duke thirrur; Je i ftuar o i vdekur,kushdoqofsh ti, je i ftuar prej Mart Delisë në dasmën e tij.

999 frymë erdhën në fshatin Katmaranë dhe u bë një dasmë qe do të mbahet mënd. Shtatë ditë e shtatë net u zbrazën qilaret e kullës së Lin Delisë që martonte djalin e vetëm. Tëmotjet mbushën tryezat prej dru lisi, brumërat, mishrat përplot aromë bjeshke, verërat, rakia,ëmbëlsirat me shumë petë të topitura me arra e bajame të grira. Dikujt i bëri përshtypje një njeri i panjohur që rrinte diku nga fundi. Pranë tij qëndronte një vajzë e re e veshur me rrobat e nusërisë. I panjohuri mbante një kostum popullor, brekushe të bardha jelek me flori dhe qeleshe. Iu afrua Lin Delia.

-- Mirësevini,burrë i dheut! Nuk ju njof,po kjo s'ka rëndësi. Kush jeni ju?

-- Një i vdekur. Kjo është gruaja ime. E vdekur edhe ajo.

Pastaj ai i tregoi historinë. Po bënin dasmën, atij i pushon zemra.Bashkë me të shtijnë në varr dhe gruan e gjallë sipas zakonit të vjetër. Ajo nuk qau, pëshpëriti ai, kjo më dhëmbi. Më kishte dashtë, e mira e dheut.Ja, shishja që ra mbi rrasën e varrit. Djali juaj e derdhi pikën e fundit mbi të dhe më ftoi në dasmën e tij. Erdha me gjithë nusen time. E pimë shërbetin, burrë i dheut.

Lin Delia i ftoi të uleshin pranë çiftit, të bënin dhe ata dasmën e tyre të lënë përgjysmë. Po s'qe e thënë; doli agsholi dhe çifti i vdekur u bë fir.

Natalia Ginzburg

DIELLI DHE HËNA

Përktheu Anxhela Lepuri

Hera e fundit që e pashë në jetë Kalvinon, qe në dhomën e spitalit të Sienës, një ditë pasi e kishin operuar në kokë. Ndihej i venitur, kokën e kishte të fashuar, krahët e zhveshur jashtë shtrojës, të zeshkët dhe të fortë. Fytyra e tij ishte e dëlirë dhe e qetë, frymëmarrja e lehtë dhe e lirë. Në fytyrë nuk kishte shenja vuajtje. Mendova se së shpejti do të shërohej, do të ngrihej nga ai shtrat. Në ditët në vijim, gazetat gëlonin me frazat që kishte thënë kur ishte zgjuar. Kishte parë tubat e serumeve dhe kishte thënë: "I ngjaj një llambadari". Kishte hyrë e bija dhe e pat pyetur: "Kush jam unë?" I ishte përgjigjur: "Ti je breshka". Një prej mjekëve i kishte bërë disa pyetje dhe më pas i ishte drejtuar: "Kush jam unë?" Kalvino pat thënë: "Një komisar policie". Për ata që i donin të mirën, ato fraza ishin një dhuratë e paçmueshme, shenja se ishte përherë ai, se asgjë nuk kishte ndryshuar, se në mendjen e tij vërtiteshin ende breshkat, llambadarët dhe komisarët e policisë.

E kam të pamundur ta mendoj të vdekur. Nuk e di përse, por vdekja më dukej shumë larg tij. Kur e kam njohur, ishte një djalosh njëzetetrevjeçar. Më duhet ta pranoj se gjithmonë e kam parë si një djalosh. As që e kisha menduar se mund të plakej, të transformohej në një plak çalash dhe thinjosh. Dhe në të vërtetë, në moshën njëzetetrevjeçare në aspektin fizik nuk qe shumë i ndryshëm nga ai që u bë më vonë. Koha i shënjoi mbi ballë rrudha horizontale dhe ndonjë xhufkë gri tek tëmthat, por në fizik asgjë më shumë. Në rini ishte fjalëpakë, fjalështruar, syçelët e i drejtë dhe i tillë mbeti.

Edhe pse ishte kaq i drejtë si njeri, tentonte herë pas here edhe në rini të kërruste shpatullat, sikur donte të mblidhej në vetvete dhe të mbrohej nga pyetje të pavlefshme. Në rini, belbëzonte shpesh; edhe më pas belbëzonte, është e vërtetë, mirëpo në rini më tepër. Shumë herë dukej sikur i nxirrte fjalët prej një çante të fshehtë, ose sikur i shkulte me vështirësi prej ndonjë lëmshi sekret: dhe teksa i shqiptonte pengohej, ngryste ballin dhe shihte gishtërinjtë e vet të kryqëzuar, me një mëdyshje ironike dhe kokëforte, sikur ripohonte vetveten. Edhe pse shumë herë i nxirrte fjalët me vështirësi dhe ngadalësi, nuk vihej re aspak vështirësi dhe plogështi në mendimin e tij, e aq më pak në atë që bënte; vështirësia, ngadalësia dhe belbëzimet ishin një mënyrë për t'u tallur me vetveten dhe të tjerët, ishte mënyra e tij për të qëndruar në botë. Kur e njoha, ai belbëzim i tij, herë i vërtetë e herë i provokuar, më kishte bërë përshtypje për harenë e jashtëzakonshëm që çlironte: sepse aty fshihej një mënyrë e mrekullueshme për të komentuar hareshëm veten dhe tjetrin, si dhe bishtrat leshator, të ashpër, plot luspa dhe të pafundmë që gjarpëronin pas fjalëve.

E kam njohur Kalvinon në dimrin e '46-ës në Torino, në selinë e shtëpisë botuese Einaudi, në një korridor përballë një sobe druri. Ishte një mëngjes me borë, i hirtë e i ngrysur dhe në atë korridor qe ndezur drita. Soba ishte nga ato prej tulle, që vijnë nga Kastelamonte dhe që t'i kuqëlojnë duart teksa i prek. Kalvino atëherë punonte tek "Unità", dhe kishte ardhur aty rastësisht, ndoshta për të kërkuar ndonjë libër për recension. Asokohe në shtëpinë botuese ishim të paktë: prisnim Pavezen, i cili nuk ishte kthyer ende nga Roma, ku qëndronte prej muajsh. Unë dhe Kalvino folëm goxha gjatë në këmbë përballë sobës, s'dihet përse nuk morëm dy karrige.

E kujtoj shumë mirë sobën dhe dëborën jashtë, por nuk e kujtoj se për çfarë folëm, me shumë gjasë për tregimet. Kalvino kishte shkruar një tregim, *U thirrë në komandë*, të cilin ia kishte nisur Vitorinit për "Politecnico", Vitorini i pat shprehur disa rezerva. Idhulli im asokohe qe Hemingueji dhe mësova që i tillë ishte edhe për Kalvinon; dhe tregimin e Heminguejit, *Kodra si elefantë të bardhë*, si njëra dhe tjetri do të kishim dhënë dhjetë vite nga jeta jonë për ta shkruar.

Kohë më vonë, Paveze u kthye nga Roma. Ai dhe Kalvino u bënë shok. *U thirrë në komandë* u publikua tek "Politecnico". Kalvino, ndoshta i nxitur prej Pavezes, e la punën tek "Unità", për të punuar rregullisht në shtëpinë botuese.

Dy vjet më vonë, Kalvino dhe unë shkuam në Stresa për të gjetur Heminguejin. Shkuam atje në emër të shtëpisë botuese. Ishim të lumtur që po shkonim, por edhe të frikësuar se mos ndoshta nuk na pranonte. Hemingueji na priti në dhomën e tij, në një tavolinë të ndriçuar nga qirinj, nuk e di për ç'arsye, por më në fund mundëm t'i thoshim sesa e kishim pëlqyer *Kodra si elefantë të bardhë*.

Kalvino na sillte mua dhe Pavezes tregimet e veta për lexim. Ishin të shkruar me dorë, me një kaligrafi të imët, të rrumbullakët dhe përplot korrigjime. Na dukeshin shumë të bukura. Atje shpërfaqeshin peizazhe të gjallërueshme, të ndërkallur në një dritë diellore; ndonjëherë ngjarjet ishin ngjarje luftërash, vdekjesh e gjakrash, por asgjë nuk e njolloste dritën e madhe të ditës dhe asnjë hije nuk ra kurrë në ata pyje të verdhemë, gjethedendur, populluar nga të rinj, kafshë dhe zogj. Stili i tij qyshse prej fillimit qe i njëtrajtshëm dhe i pastër, për t'u bërë me kalimin e kohës një kristal i vërtetë. Në atë stil të freskët dhe të tejpashëm, realiteti shfaqej i njollosur, laraman dhe i ngjyrosur me mijëra ngjyra; dukej një mrekulli ajo gjallëri, ajo dritë diellore, në një epokë ku shkrimi ishte zakonisht i ashpër, i vrenjtur dhe i kursyer dhe në vetë botën që tentonim të rrëfenim nuk mbretëronte gjë tjetër veç mjegullës, shiut dhe hirit.

Kur Paveze u vetëvra, Kalvino, Balbo, Xhuljo Einaudi dhe unë e ndamë së bashku atë fatkeqësi. Kjo tragjedi na ka mbajtur të bashkuar përgjatë viteve, qëndronte në rrënjët më të thella të raporteve tona. Dhe kështu na kanë mbajtur të bashkuar edhe humbje të tjera, edhe pse jetonim në qytete të ndryshme dhe përshkonim rrugë të ndryshme gjatë viteve.

Në '56-ën, Kalvino publikoi *Përralla italiane*. Mendoj se pas *Pinoku*-t është libri më i bukur për fëmijë i publikuar në Itali. Duhet të lexohet nëpër shkolla, ndoshta e bëjnë, por për mendimin tim duhet ta bëjnë edhe më shpesh. Stili tek *Përralla italiane* është i shpejtë dhe i tejpashëm. Aty mësohet konkretësia, preciziteti dhe ajo lehtësi puplash; në *Përralla italiane* mbretëron e njëjta dritë hareje dhe diellore që hasim në *Viskonti i përgjysmuar*, po aq sa në tregimet e tij të hershme.

Mes gjithë artikujve që janë shkruar gjatë këtyre ditëve për të rikujtuar Kalvinon, më i bukuri më është dukur ai i Pietro Çitatit, sepse në fjalët e tij më dukej se shihja Kalvinon siç vërtet ishte – si ishte i ri dhe si u bë më vonë.

Nuk ndryshoi kurrë në aspektin fizik, mbeti përherë një djalosh, por në mendje dhe shpirt pësoi, në njëfarë mënyre, një ndryshim të thellë. Këtë e tha Çitatit, dhe mesa di unë ka qenë i vetmi që e ka thënë. Se cilat ishin arsyet dhe rrugët e këtij shndërrimi, nuk dihet. Ai u dallua në mënyrën e tij të të ecurit, të të qeshurit, të të parit. U reflektua po ashtu edhe në shkrimet e tij.

Çitati thotë: "Me një qëndrueshmëri më të madhe, me një shqetësim më të madh, me një aftësi të jashtëzakonshme ecejakesh, Kalvino përndiqte atë pjesë të fshehtë të ekzistencës sonë që qëndron pas ndjenjave dhe mendimeve: gjithçka që tinëzohet në të çarat, në humnerat, në të thellat e shpirtit tonë...". "Mendja e tij u shndërrua. U bë më e komplikuara, më labirintikja, më përfshirësja, më e rrjedhshmja – mendja më arkitektonike që një shkrimtar italian ka zotëruar ndonjëherë...". "Nuk dinte të pohonte më asgjë, nuk dinte të përjashtonte asgjë, sepse çdo pohim gjeneronte mohimin, dhe mohimi një tjetër pohim, e kështu në një lëvizje marramendëse që nganjëherë çonte në pamundësinë e të folurit dhe të shkruarit".

Dalëngadalë u zhdukën nga librat e tij peizazhet e jeshilta dhe fletëplotë, dëbora shndritëse, drita rrezatuese e ditës. Buloi në shkrimet e tij një dritë e tjetërllojtë, një dritë jo më rrezatuese por e bardhë, jo e ftohtë por tejendanë e shkretë. Ironia mbeti, por e padukshme dhe e palume për ekzistencën, e bardhë dhe e pabanuar, si hëna.

Në atë libër brilant, që është *Qytetet e padukshme*, sipas meje libri i tij më i bukur, ky transformim ka ndodhur tashmë. Bota është aty, rrezatuese, shumëformëshe, e larmishme dhe ngjyrashume, e paprekur në shkëlqimin e saj: por duket sikur shikimi që e zhbiron, e dallon dhe e sodit është i vetëdijshëm se po e braktis përgjithmonë. Që prej këtej, ai shikim do të mbështetet gjëkundi, jo më mbi pafundësitë shkëlqyese të qiellit dhe të detit, as në ngatërresat e ngjarjeve të ndryshme njerëzore; që këtej e tutje, atë pafundësi do ta kërkojë gjetkë, në guaskat e insekteve ose në të plasariturat e shkëmbinjve: "Në çarjet, humnerat, në honet e shpirtit tonë". Mbi "qytetet e padukshme" është shtuar dhimbja e kujtesës. Në çdo vepër tjetër të Kalvinos kujtesa mungon, ose më mirë, kur është e pranishme, nuk është kurrë e dhimbshme. Këtu, në "qytetet e padukshme", jo të ëndërruara por të rikujtuara, mbretëron kujtesa e dhimbshme e një kohe që nuk mund të kthehet më. Mbi qytetet e larta gjer në qiell, gëluese dhe vezulluese, mbartëse të gabimeve njerëzore, të tejmbushura me mallra dhe ushqime, përplot trafik – mbretëri të minjve dhe të dallëndysheve – bie dielli. Vështrimi që i përshëndet është një vështrim që i thotë mirupafshim një bote shumë të dashur, duke e ndjekur me shikim prej anijes që largohet.

ELIF SHAFAK MBI ÇFARË DO TË THOTË T'U PËRKASËSH NJËKOHËSISHT SHUMË VENDEVE

"Ky qytet do të të përndjekë gjithmonë," shkroi poeti grek Constantine Cavafy, edhe kur shkon në një shtet tjetër, në një breg tjetër. Qyteti që më përndjek gjithmonë është Stambolli.

Në zemër jam nga *Stambolli*, edhe nëse nuk mund të kthehem më aty. Dashuria dhe përzemërsia ime për këtë qytet është e thellë, dhe besoj se është mjaft e dukshme në romanet e mia. Kudo që shkoj ndihem sikur Stambolli më shoqëron. Ne nuk heqim dorë nga vendet që duam vetëm sepse shkëputemi fizikisht prej tyre.

Mëmëdheu është kështjellë prej xhami. Që të largohesh prej tij, duhet të thyesh diçka – një mur, një traditë shoqërore, një normë kulturore, një kufi psikologjik, një zemër. Ajo që ke thyer do të të përndjekë. Si pasojë, të jesh një emigrant, do të thotë të durosh përgjithmonë copat e xhamit në xhepin tënd. Është e lehtë të harrosh që janë aty, aq të lehta e të vockla sa janë, dhe të vazhdosh me jetën tënde, ambiciet e tua të vogla dhe planet e rëndësishme, por me prekjen më të lehtë copëzat do të të kujtojnë praninë e tyre. Do të të presin thellë.

Mëmëdheu të cilit i jemi larguar u ngjason betimeve që kemi bërë si fëmijë. Mund të mos i besojmë më, mund dhe të mos i mendojmë më aq shumë, por sërish na i lidhin gjuhët. Ato janë të fshehtat e mbajtura, përgjigjet e pathëna, lëndimet e pashprehura, plagët e vjetra të hapura sërish, dashuritë e para të paharruara. Edhe pse mund të jemi të palëkundur për të braktisur mëmëdheun tonë, sepse Zoti e di që jemi të lodhur prej tij, të lodhur nga budallallëqet, absurditetet, armiqësitë dhe mizoritë, e vërteta është se nuk do të na braktisë kurrë. Janë hije që na ndjekin në të katër cepat e tokës, ndonjëherë ecin përpara nesh, ndonjëherë pas, por nuk janë asnjëherë shumë larg. Prandaj, edhe pasi ka kaluar kohë nga migrimet dhe shpërnguljet, nëse dëgjon me kujdes, mund të dallosh ende gjurmë të mëmëdheut në theksin tonë të thyer, në buzëqeshjet gjysmake, në heshtjet e sikletshme.

Kështu pra, po, jam nga *Stambolli*.

Por jam gjithashtu thellësisht e lidhur me Ballkanin. Më tako me një autor grek, bullgar, boshnjak, shqiptar ose rumun, dhe do të habitesh se sa shumë të përbashkëta kemi. Po kështu, mbaj shumë elementë në shpirtin tim nga Lindja e Mesme. Kështu që këtë herë më lër ngjitur me një autor sirian, libanez, jordanez, egjiptian, izraelit, palestinez apo tunizian. Sërish, do të habitesh kur të shohësh se sa të ngjashëm jemi.

Në të njëjtën kohë, unë jam londineze, qytetare britanike dhe ndihem e lidhur thellësisht e me pasion me këtë shtet ku kam gjetur lirinë për të shkruar. Jam europiane – nga lindja, zgjedhja dhe vlerat që unë mbaj. Dhe pavarësisht se çfarë na kanë thënë politikanët së fundmi, unë do të doja ta mendoja veten time si qytetare e botës, qytetare e këtij planeti, një shpirt global.

Kam përkatësi të shumëfishta.

"Epo, ky është luks", thonë populistët. "Jo të gjithë mund të udhëtojnë".

E vërtetë, jo të gjithë mund të udhëtojnë përmes kulturave, dhe jo të gjithë që e bëjnë janë medoemos "elitë". Si pasojë e pandemisë më pak turistë do të kenë mundësi të udhëtojnë jashtë shtetit, më pak studentë ndërkombëtarë do të aplikojnë dhe më pak punonjës emigrantë do të mirëpriten. Më shqetëson pafundësisht, të shoh muret që ngrihen lart e më lart.

Përkatësitë e shumëfishta nxiten nga takime kulturore, por nuk janë vetëm sferë e njerëzve që udhëtojnë. Është një qëndrim, një mënyre të menduari, sesa numri i vulave në pasaportën tënde. Është të mendosh për veten dhe qeniet e tjera njerëzore, në terma më fleksibël se kategori të ngurta.

Ndoshta je lindur dhe rritur, edukuar dhe martuar, të gjitha brenda perimetrit të të njëjtit qytet. Përmes historive të familjes tënde, përkatësive kulturore, preferencave shoqërore, pikëpamjeve politike, lidhjeve me sportet dhe artet, e kështu me radhë, ti përsëri ke përkatësi të shumëfishta.

Ekzistojnë më shumë ngjashmëri, ekzistojnë mundësi më të mëdha për të gjetur pika takimi ndërmjet njerëzve të përkatësive të ndryshme. E megjithatë, pse ndodh që në shkolla, në familje dhe në shoqëri, rrallëherë u mësojmë fëmijëve që ata kanë përkatësi të shumëfishta dhe mund t'i duan shumë të dy shtetet e tyre dhe komunitetet, duke mbajtur mend njëkohësisht se janë qytetarë të njerëzimit.

Shkëputur nga "How to Stay Sane in an Age of Division"

"E megjithatë, pse ndodh që në shkolla, në familje dhe në shoqëri, rrallëherë u mësojmë fëmijëve që ata kanë përkatësi të shumëfishta dhe mund t'i duan shumë të dy shtetet e tyre dhe komunitetet, duke mbajtur mend njëkohësisht se janë qytetarë të njerëzimit.

REFLEKTIME MBI "SI TË RREGULLOSH NJË BIBLIOTEKË" NGA ROBERTO CALASSO

Nga Damian Alia

Të rregullosh apo të rendisësh? Nëse të vendosësh librat në bibliotekën personale "është një temë lartësisht metafizike", siç thotë Calasso në fjalinë e parë të paragrafit të parë të librit, atëherë do të duhet të themi "si renditet një bibliotekë", përsaqë rregullin e kuptojmë si aspekt të rendit, ndërkohë që rendin si esencën e rregullit. Megjithatë, në ujëra të tilla do të shkonim duke qenë se Calasso nëpërmjet sipërmarrjes së rendimit të bibliotekës sjellë përfytyrimin e një aktiviteti që teksa mund të shkojë drejtë ngritjes së pyetjes se ç'është rendi?, thellësisht metafizike, përpiqet t'i përgjigjet në kushtet e kaosit që realiteti dhe aktiviteti në fjalë përfaqësojnë.

Kur vite të shkuara dëgjoja se shumë lexues i vendosnin librat sipas rendit të shtëpive botuese, nëse kopertinat dhe shpinat e tyre ishin përgjithësisht njëlloj, mendoja se kur të kisha një bibliotekë aq të madhe e të pasur do të bëja të kundërtën. Autori me veprat përkatëse duhej të përcaktonte zonën e tij territoriale në raftin e bibliotekës pavarësisht botimeve. Kjo do të ishte një lehtësi, dhe më dukej asokohe, një korrektësi që i bëhej autorit. Sot që kam një bibliotekë të madhe dhe të pasur, një të madhe në dy qytete, sepse biblioteka është vazhdimësi, pavarësisht afërsisë së momentit me njërën gjymtyrë të saj apo me tjetrën, kam bërë të kundërtën e asaj që kisha menduar. Vëllimet, aty ku mundet, sipas gjetjve të rastit në libraritë e dorës së dytë kryesisht, janë të rreshtuar sipas botimit, që do të thotë, sipas ngjashmërisë estetike të cilën u ka caktuar botuesi. Sigurisht, nëse një seri apo *collana* klasikësh ka një prerje, ngjyre dhe stili, atëherë duket më natyrshëm të qëndrojnë bashkë. Ndoshta, në raftet e bibliotekës këto zona uniformiteti heterogjen krijojnë idenë e rendit mes vëllimeve të shumtë e të afërt, por jo të afërm, në raftet e tjerë. Nga një anë, a nuk duket sikur autori, kështu i shpërndarë nëpër trupin e madh prej druri merr trajta sa sociale, në afërsinë me të huajt që e kufizojnë, aq edhe strategjike në rastet kur kemi një numër të madh të veprave të njërit të parapëlqyer, e të shpërndarë gjithandej. Zgjerim territori, imponim autoriteti, bibliopolitikë, apo gjeopolitikë biblioteke?

Calasso e konsideron 'esenciale' blerjen e "shumë librave që nuk lexohen *menjëherë*" Çdo lexues që hyn në kategorinë e grumbulluesve, kur mundësitë e lejojnë, e kupton mirë se për çfarë po flitet. Ndjenja e çuditshme e marrjes në dorë të një libri të blerë kohë më parë, të palexuar, që ndoshta gjendet me vështirësi apo nuk gjendet fare, në momentin kur të duhet, në momentin e vetë librit në fjalë, për Calasson, është me rëndësi të veçantë. Jo vetëm që i jep të drejtë vetes për blerjen e shkuar por përjeton kënaqësinë e të menjëhershmes kur e merrë në dorë në çastin e duhur.

E di mirë se çdo të thotë lexues grumbullues. Urbanet e Tiranës më kanë parë me qeska të mëdha në duar në tempraturat e larta të verës. Dhe vërtetë, një nga sikletet e përhershme të blerjes së librave në numër të madh përnjëherë është lëvizja e tyre kur nuk ke mjet transporti të përshtatshëm. Ashtu si dilet nga Panairi i Librit, edhe pse hyn me parimin "të shikojmë njëherë çfarë ka", të jeni të sigurt që rruga për në shtëpi do të jetë shumë e gjatë nëse jeni në këmbë. Por edhe atë që thotë Calasso e di mirë. A nuk duket vërtetë sikur, i ndikuar nga disa impulse të heshtura, paraprihet gjithë jeta jote kur blen një libër me të cilin nuk të lidh puna, as planet e projektet, përveç një qejfi apo interesi të zbehtë për temën, dhe në çast mendon se 'do t'i vijë dita', dhe gati një dekadë më pas përfundon të studiosh atë disiplinë në universitet. Dhe libri është aty, ka pritur gati dhjetë vite dhe dita i erdhi. Kujtimi i blerjes dhe i gjithë rrjedhës së ngjarjeve t'a bënë edhe më magjepsës leximin *e parë* të tekstit, në momentin e kërkuar, pra, në kohën e vërtetë të librit.

Në këtë pikë yshtemi të reflektojmë pak më thellë për esencën e bibliotëkës. Në qetësi, ndoshta në një kënd atmosferik që krijohet spontanisht nga ndriçimi i ulët dhe i ngrohtë, raftet dhe librat. Ç'është ky entitet që vjen në botë si jetësim i librit dhe raftit në një? Ç'është ky trup i zbrazët në vetvete e që kuptimin e merr nga librat? A krijon identitetin e vetë me organet që mban përmbrenda? Aspak. Librat janë shumëfishësi virtualitetesh të cilat përfaqësojnë shprehje krijimi në paparashikueshmërinë e efekteve të tyre. Qëllimet e autorit nuk shtrihen deri në përjashtimin e pasojave të papritura. Fuqia e tyre mbaron aty, tek ajo që dëshirojnë të gjurmojnë. Biblioteka është kështu një fenomen i çuditshëm që të sjell në mendje sovranin hobbsian në kopertinën origjinale të *Leviatanit*. Trup individual vetëm prej shumfishësisë së popullit që e përbën. Deri ku ngrihet populli në këtë individualitet apo deri ku zbret sovrani në padallueshmërinë e ndërgjegjes kolektive nuk është e qartë. Këtë paqartësi të potencialeve të lira përfaqëson ajo që mbajmë në shtëpi dhe e quajmë bibliotekë. Përqëndrim magjepsjeje dhe bukurie, rreziku dhe frike.

Biblioteka është edhe diçka tjetër e që nuk mund të mos vihet në dukje nëse dëshirojmë që të kuptojmë rëndësinë e vazhdimësisë në kulturën tonë. Përbën vërtetë një interes të madh mënyra se si idetë përhapen dhe ndryshojnë në këtë qarkullim. Sa njerëz kemi njohur të cilët na kanë përmendur një autor kalimthi e që për ne është kthyer në tezë diplome pas njëfarë kohe ndërkohë që është harruar plotësisht nga përmendësi. Si hyn këta njerëz të cilët nuk e gjejnë veten në librat e historisë por që duket sikur janë, pa kuptuar e pa dashur, krijues të saj nëpërmjet këtyre transmetimeve në dukje të pafajshme. Sa nga këta persona përmban në heshtje biblioteka jonë e që ndoshta do të ishte më e varfër nëse nuk do të ishte dhe kjo një nga mënyrat nëpërmjet të cilave idetë gjenerohen dhe rigjenerojnë jetën e tyre. Nëse do të ishte e mundur të ndërtohej një skemë lidhjesh për secilin libër që kemi në bibiliotekë me kryqëzimet e ndikimeve mes tyre apo me ata në mungesë, do të dilte në dritë diçka e përfytyrueshme si labirint. Fijet e lidhjeve prodhojnë plane të mbivendosura por jo përjashtuese të njëra tjetrës. Nuk kuptohet se ku një linjë ndikimi mbaron në njërin plan dhe ngjitet për tek tjetri nëse nuk shihet lëvizja në disa pozicione. Planet nuk janë hierarki por vëllim i prodhuar lirshëm mes veti në përputhje me historinë e teksteve dhe tashmë me atë të bibliotekës. Filli i Arjanës nuk shërben vetëm për të gjetur daljen nga labirinti por edhe për të ndërtuar një skemë të mundshme të tij. Megjithatë, biblioteka si labirint nuk është asnjëherë totale përsaqë lidhjet vazhdojnë të kryen edhe tani që shkruaj, si ndikim i këtij shkrimi. Një fill po lëshohet jashtë nëpër botë nga biblioteka ime. Një reflektim paksa më metafizik e vitalist do ta shprehte thelbin e bibliotekës si *forma jete* gjithmon të prirura drejt aktualizimit të gjendjeve të reja të të qenit. Biblioteka është legjion heterogjen. Parë nga këndvështrimi i saj biblioteka është *shumëfishësia e jetëve* që *Jeta ende mund* të *jetë*.

Mendime të tilla për bibliotekën vijnë si pasojë e konsideratave edhe më të larta për vetë leximin. Të domosdoshëm dhe të vazhdueshëm si frymëmarrja.e quan Calasso. Kam dëgjuar në disa raste të thuhet se shtëpia e dikujt u kthye, nga një me bibliotekë, në bibliotekë me një shtëpi brenda. Përmbysje e banesës në bibliotekë. Apo transformim i fjetores në banesë? Fundja, kur thuhet se shtëpia pa bibliotekë është si trupi pa shpirt, pse të mos themi se një bibliotekë me një shtëpi është shpirtëzimi i trupit. Gjithsesi, në këtë linjë logjike, dhe në vazhdimësi të paralelizimit të leximit dhe frymëmarrjes, mund të themi se lexues i vërtetë, e ndoshta lexuesi i vërtetë është edhe ai radikali që përmbush metamorfozën e mësipërme në veten e vetë, është ai që leximin e ka jetë, dhe përditshmëritë, thjesht ndërprerje të leximit. Jeta e identifikuar me leximin dhe jo thjesht e paralelizuar me frymëmarrjen. Jeta si një lexim i vetëm, me ulje ngritjet e veta në cilësitë dhe zhgënjimet e librave, me pengesat dhe ndihmesat e mendjeve komplekse e të urta, me nuancat dhe përthyerjet, tonalitetet dhe rezonimet. Një lexim i vetëm, nga fillimi në fund, dhe në mes, ndërprerjet e rastit: të shkuarit në punë, të larit e enëve, të takuarit miqtë apo të afërmit, martesa, fëmijët, dokumentat e pensionit, deri ditën e fundit, që është edhe faqja e fundit.

E nëse "çdo lexues i vërtetë ndjek një fill" për Calasson, atëherë një jetë-lexim, një fill që herë pas herë ndërpritet, por që në leximin e radhës rimerret në dorë e që e "ngatërron, mashtron, zgjidh, nyjëzon, zgjat", është rikthim në udhën e duhur sepse filli gjithmonë do të orientojë në udhëkryqet e labirintit, i cili, si filli, apo prej fillit?, është gjithnjë vazhdim dhe fillim.

Një histori emocionuese krimi dhe misteri, por njëkohësisht edhe
një farsë tallëse dhe një satirë morale e shoqërore.

Eduardo Mendoza

MISTERI I KRIPTIT TË MAGJEPSUR



Onufri